



# **INTERKULTURA**

## **Komunikimi interkulturore**

# 2

**TRASHËGIMIA KULTURORE DHE INTERKULTURA SI  
UDHËRRËFYES TË INTEGRIMEVE DHE KOHEZIONIT SOCIAL**



<b>INTERKULTURA</b>	<b>NR.2</b>	<b>Fq.1-130</b>	<b>Shkup</b>	<b>2019</b>
---------------------	-------------	-----------------	--------------	-------------



# INTERKULTURA

Komunikimi interkulturo

# 2

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

Shkup, 2019



## INTERKULTURA

# 2

### **Botues**

Universiteti "Nënë Tereza" Shkup  
Aziz POLLOZHANI - rektor

### **Editor**

Mother Teresa University , Skopje  
Aziz POLLOZHANI - rector

### **Redaktori përgjegjës**

Mustafa IBRAHIMI

### **Editor in chief**

Mustafa IBRAHIMI

### **Këshilli botues:**

Rizvan SULEJMANI  
Sunaj RAIMI  
Agron KURTISHI  
Zeqirja NEZIRI  
Mirjana MALEVSKA  
Rubin ZEMON

### **Editorial board:**

Rizvan SULEJMANI  
Sunaj RAIMI  
Agron KURTISHI  
Zeqirja NEZIRI  
Mirjana MALEVSKA  
Rubin ZEMON

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
FJALA PËRSHËNDETËSE .....	5
<b>AZIS POLLOZHANI</b> .....	6
RESPEKTI I NDËRSJELL - BAZAMENT I NJË KOHEZIONI SOCIAL NË SHOQËRI MUTUAL RESPECT – BASIS OF SOCIAL COHESION IN SOCIETY	
<b>ZEQIRJA NEZIRI</b> .....	9
PJETËR BOGADNI, AFIRMUES I TEOZOFISË BAROKE PJETËR BOGADNI, AFFIRMATIVE OF BAROQUE THEOSOPHY	
<b>VEBI BEXHETI</b> .....	27
PËRMASA UNIVERSALE NË POEZINË E MIGJENIT UNIVERSAL SIZE IN THE POETRY OF MIGJENI	
<b>MUSTAFA IBRAHIMI</b> .....	33
ELEMENTE ETNOGRAFIKE DHE ARTI SHQIPTAR NË MURET E KISHAVE TË PRILEPIT DHE BALLKANIT NGA PIKTORI MESJETAR ONUFRI ETHNOGRAPHIC ELEMENTS AND ALBANIAN ART ON THE WALLS OF PRILEP AND BALKAN CHURCHES OF MEDIEVAL PAINTER ONUFRI	
<b>SUNAJ RAIMI</b> .....	47
JAN KUKUZELI – KOMPOZITORI SHQIPTAR MESJETAR ME DIMENSIONE BOTËRORE JAN KUKUZELI - MEDIEVAL ALBANIAN COMPOSER WITH WORLD DIMENSIONS	



---

<b>AVZI MUSTAFA</b> .....	61
GRIGOR PËRLIÇEVI DHE KONTRIBUTI I TIJ INTERKULTUROR GRIGOR PARLICHEV AND HIS INTERCULTURAL CONTRIBUTION	
<b>ASLLAN HAMITI</b> .....	73
RËNDËSIA E “FJALORIT TRIGJUHËSH” TË GJORGJI PULEVSKIT IMPORTANCE OF GEORGE PULEVSKI'S "TRUTH GLOSSARY"	
<b>NEBI DERVISHI</b> .....	89
KONTRIBUTI I JOSIF BAGERRIT PËR GJUHËN DHE KULTURËN SHQIPE NË REKËN E EPËRME CONTRIBUTION OF JUSUF BAGERI FOR THE ALBANIAN CULTURE AND LANGUAGE AT THE SO CALLED PLACE "REKA E EPERME"	
<b>MIXHAIT POLLOZHANI</b> .....	99
TRADITA JONË INTERKULTURORE NË ARTET PAMORE OUR INTERCULTURAL TRADITION IN THE VISUAL ARTS	
<b>RIZVAN SULEJMANI</b> .....	113
SA KANË NDIKUAR DALLIMET FETARE DHE KULTURORE NË FORMIMIN E KOMBIT “MODULAR” SHQIPTARË? HOW HAVE RELIGIOUS AND CULTURAL DIFFERENCES INFLUENCED THE FORMATION OF THE “MODULAR” ALBANIAN NATION?	

## Fjala përshëndetëse

### **RESPEKTI I NDËRSJELL - BAZAMENT I NJË KOHEZIONI SOCIAL NË SHOQËRI**

Multikulturalizmi dhe interkultura në shoqëritë heterogjene, kanë qenë dukuri spontane që ka mundur bashkëjetesën dhe harmonizimin e raporteve mes popujve. Duke qenë numerikisht të vegjël, ata në mënyrë spontane kanë dhënë dhe kanë marrë nga vlerat specifike të njëri - tjetrit. Me një fjalë ato kanë qenë në një „dialog ndërkulturor„ të përhershëm që në fakt rezulton në një interkulturalizëm që në bazamentin e vet e ka respektin ndërmjet popujve që kanë jetuar dhe jetojnë pranë njëri-tjetrit.

Shfaqja e gjuhës së shkruar në faza të ndryshme, i detyroi popujt e vegjël që të përdorin shkrime dhe gjuhë tjera duke hapur kështu mundësinë e zhvillimit dhe të afirmimit të specifikave të veta edhe nëpërmjet gjuhëve dhe shkrimeve të tjera më të afirmuar të kohës.

Paraqitja dhe zhvillimi i kulturave vetanake nuk e eliminojnë këtë dukuri, përkundrazi, nën ndikimin e rrjedhave të reja integruese, globalizuese dhe teknologjike, atë e pasurojnë dhe e orientojnë drejt gjuhëve të mëdha me çka rriti gjasat e popujve të vegjël për kyçje në rrjedhat moderne civilizuese.

Me qenë se interkulturalizmi dhe multilingualizmi paraqesin relacionet e ndërsjella mes kulturave të ndryshme, popujt duhet të jene të gatshëm që në këtë proces të hyjnë me veçoritë sa më të konsoliduara të tyre. Ky relacion respektivisht , dialog mes kulturave të popujve do të jetë aq më cilësor sa me e avancuar dhe e kultivuar të jetë gjuha dhe kultura e secilit prej tyre veç e veç.

Në seminarin, të dytin me radhë në Universitetin „ Nënë Tereza„ nëpërmjet kontributeve të shkencëtarëve eminent, do të përpiqemi të hedhim dritë mbi disa aspekte të kësaj dukurie duke prezantuar shembuj nga tradita kulturore respektivisht nga jeta dhe veprat e rilindësve të cilët kanë trajtuar dhe kultivuar frymën e



respektit të ndërsjellë dhe interkulturalizmin, duke qenë të vetëdijshëm për vlerat e saj për afirmimin sa më të gjerë të kulturës veta-nake dhe rëndësinë e saj për krijimin e një raporti miqësor me fqinjët mbi bazën e respektit të ndërsjellë si parakusht për liri , paqe dhe mirëqenie për popujt e Ballkanit.

Nga ky këndvështrim nuk është e vështirë të përfundojmë se kjo traditë, kjo frymë për respekt të ndërsjellë që është bazamenti i një kohezioni social në shoqëri, mbetet aktuale edhe në kohën që ne jetojmë. Ajo do të vazhdojë të jetë e tillë duke u pajisur edhe me përmbajtje tjera që do të imponohen nga rrjedhat e pashmangshme integrale dhe globalizuese. Jemi të bindur që gjeneratat që vijnë më lehtë do të përballen me këto sfida nëse i referohen traditës sonë të pasur me këto vlera.

Universiteti ynë, ka kënaqësinë që në kuadër të aktiviteteve të veta programore e ka paraparë këtë Seminar për të dhënë kontributin e vet në këtë drejtim si një dimension themelor të misionit të vet.

**Azis POLLOZHANI**

Rektor i UNT-së

## Opening remarks

### **MUTUAL RESPECT – BASIS OF SOCIAL COHESION IN SOCIETY**

Multiculturalism and interculturalism in heterogeneous societies have been spontaneous phenomena that have enabled the coexistence and harmonization of relations between nations. They have spontaneously given and taken from each other's specific values, even though they were small in number. In a word, they have been in a permanent 'intercultural dialogue' that has actually resulted in interculturalism, in the foundation of which we can find the respect among nations who lived and live next to each other.

The emergence of written languages forced smaller nations use other scripts and languages in different phases, thus paving the way to the development and affirmation of their own specifications through other more affirmed languages and scripts of the time.

The emergence and development of individual cultures did not eliminate this phenomenon; on the contrary, it enriched and oriented it towards major languages under the influence of new integration, globalization and technological flows, thereby by increasing the likelihood of smaller nations join modern civilization flows.

Since interculturalism and multilingualism represent mutual relations between different cultures, nations must be ready to enter this process with their consolidated features. This relation, namely dialogue, between the culture of nations is more advanced, as it is the cultivated and advanced language of each of them separately.

In this seminar, the second in a row at 'Mother Teresa' University, through the contribution of eminent scientists we will try to clarify some aspects of this phenomenon by presenting examples from cultural traditions, namely, life and works of Renaissance figures who had treated and cultivated the spirit of mutual respect and interculturalism, while being aware of the values for a broader



affirmation of their individual culture and importance for establishing a friendly relationship with neighbours based on mutual respect as a prerequisite for freedom, peace and welfare for the people of the Balkans.

From this point of view, it is not difficult to come to the conclusion that this tradition, this spirit of mutual respect that represents the basis of social cohesion in society, remains present even for the time being. It will remain so by adding additional content imposed by inevitable integration and globalization flows. We are convinced that future generations will face these challenges more easily if they refer to the values of our rich tradition.

Our university is pleased to have this seminar foreseen within its program activities in order to make contribution on this matter, as a fundamental dimension of its own mission.

**Azis POLLOZHANI**  
Rector of MTU

UDC929Bogdani, P.  
UDC 821.18.09  
Punim studimor

## **Zeqirja NEZIRI**

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi'  
Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni  
zeqirjaneziri@gmail.com

### **PJETËR BOGADNI, AFIRMUES I TEOZOFISË BAROKE** **PJETËR BOGADNI, AFFIRMATIVE OF BAROQUE THEOSOPHY**

#### **Hyrje**

Në 6 dhjetor të vitit 2019 mbushen *treqind e tridhjetë vjet nga vdekja e Pjetër Bogdanit* (1630 – 1689). Në këtë përvjetor dëshirojmë t'i riaktualizojmë disa çështje të nisura nga studiuesit e veprës së këtij shkrimtari të madh të traditës sonë letrare që lidhen me veprën e tij *Çeta e profetëve*..

Vepra e Pjetër Bogdanit *Cuneus Prophetarum* shënon një hap të rëndësishëm përpara drejt konsolidimit dhe stabilizimit të traditës letrare shqiptare si në poezi, ashtu edhe në prozë. Me këtë vepër, ai qëndron midis traditës së trashëguar paraprake dhe në krye të fillimit të një tradite të re të historisë së mendimit dhe të letërsisë shqiptare. Në këtë kontekst, ajo paraqet një urë ndërlidhëse midis traditës së hershme dhe të resë në lindje.

Autori i këtyre radhëve duke dëshiruar ta çojë më tej vlerësimin e veprës së Pjetër Bogdanit është përqendruar në aktualizimin e studimit të prozës rrëfimore të përfshirë në këtë vepër, e cila është studiuar sipërfaqësisht ose nuk ka tërhequr fare vëmendjen e studiuesve.

## Koha dhe tradita ndërkombëtare evropiane

Pjetër Bogdani jetoi në fund të gjysmës së parë dhe në tridhjetë vjetët e parë të gjysmës së dytë të shekullit XVII. Intelektualisht u formua nëpër qendra të rëndësishme kulturore dhe arsimore ballkanike (në vendlindje dhe në Ciprovec të Bullgarisë) dhe evropiane (në Kolegjin e Loretos dhe në Kolegjin e Propagandës Fide në Romë).

Në kohën kur jetoi dhe veproi Pjetër Bogdani në letërsinë evropiane akoma ishin aktuale përvoja dhe idetë e *Humanizmit* e të *Rilindjes* evropiane. Nën ndikimin e tyre shfaqen lëvizje të reja letrare e filosofike që lidhen me emrin e *Reformës* e të *Barokut*. Në planin filosofik katolik, përveç traditës filosofike teologjike mesjetare, që u reformua në *Kundërreformë* vepronte edhe filozofia e kthjellët e *Humanizmit*, *Rilindjes*, *Reformës*, *Protestanizmit*, *Manirizmit* e të tjera, të cilat ndihmuan dhe kushtëzuan historikisht zhvillimin e mendimit filosofik të shekullit XVIII, të njohur me emrin e *Iluminizmit Francez*.

## Përthekimi kohor dhe gjeneza e veprës

Në këtë kontekst filozofia kishtarë, që në shekujt XV-XVI qe e tronditur me paraqitjen e pikëpamjeve filozofike të këtyre lëvizjeve në shekullin XVII nis të konsolidohet dhe të stabilizohet, kur kalon në një sistem të reformuar kishtar. Riorganizimi kishtar u quajt *Kundërreformë*, *Reaksion Katolik* ose *Përtëritje Katolike* dhe, për nevojat e arsimit të klerit hapi *Kolegjin e Propagandës Fide* (1622) që krijoi kushte për lindjen e një letërsie të re kishtarë me karakter hyjnor, moralizues dhe didaktik (Šicel 1982: 35). Për t'u siguruar një bazë e shëndoshë e religjionit kërkohet përtëritja e traditës kishtarë në formë të reja, që i kërkonte koha. Në këtë mënyrë, me anë të veprave teologjike-filozofike e letrare, si të epeve e poemave ose edhe të prozës rrëfimorë synohej të ruhet edhe më tej autoriteti, pozita dhe pushteti kishtar.

Në veprat letrare kërkohet theksueshëm të përdoret tematika zakonore kishtare. Zgjidhjet teorike mbështeten në traditën mesjetare. Krahas kësaj do të futen edhe detaje të jetës së përditshme bashkëkohore. Kjo letërsi, për t'i përhapur kërkesat e Përtëritjes e të forcimit të katolicizmit me veprat letrare kërkohet të shprehet te besimtari botëkuptimi religjioz – shpirtëror i jetës si fazë kalimtare. Për këtë arsye nga njeriu kërkohet që, mbi të gjitha të mendojë për pendesën dhe vdekjen (Šicel 1982: 35). Motivet më të preferuara të kësaj letërsie janë: vuajtjet e Krishtit, vajtimi i nënës së tij, lindja e zhvendosja e tij nga kryqi dhe përpunimi i legjendave kishtare. Shkruhen libra për jetën e shenjtorëve, mesha, udhëzime për ceremoni të ndryshme fetare e të tjera (Šicel 1982: 32-33). Përtërirja Katolike e udhëhequr nga jezuitët riorganizohet. Mirëpo, në esencë ajo kultivon arritjet e Rilindjes dhe, në këtë drejtim ndërton Barokun letrar (shekulli XVII), duke theksuar mbi të gjitha rolin e kishës dhe të mësimëve të saj. Në këtë mënyrë, arsyetohej edhe vizioni epikal i Virgjilit, i cili mbetet edhe teologjik edhe teleologjik (Frangëš 1987: 88).

### **Në vazhden e traditës kombëtare**

Shekulli XVII është shekull i konsolidimit të letërsisë shqiptare të periudhës prej fillimit të saj e deri në prag të mbarimit të këtij shekulli. Në shekujt XV – XVI u dalluan: (a) disa autorë që krijuan në gjuhën latine dhe me veprat e tyre u afirmuan në qarqet evropiane; dhe (b) dy autorë që shkruan librat e parë në gjuhën shqipe (njëri në të folmen verilindore të shqipes dhe tjetri në të folmen e arbëreshëve të Italisë). Këta të fundit, me këto vepra gjuhën dhe kulturën kombëtare e ngritën në nivel të atyre evropiane. Në shekullin XVII dalin një numër autorësh që vazhdojnë traditën e të parëve dhe kështu ndihmojnë konsolidimin dhe rrumbullakësimin e një periudhe të caktuar letrare.

Gjykuar nga ky aspekt, historia e letërsisë së çdo populli brenda një periudhe të shkurtër ose të gjatë kohore shënon fazat e brendshme të ecurisë së saj letrare. Edhe historia e letërsisë shqiptare

re që nismën e vet të mirëfilltë e shënon në shekullin XVI, pas një shekulli, në të shtatëmbëdhjetin shënon fazën e vet më të ngritur e më të pasur.

Veprat e shekullit XVI (*Meshari* i Gjon Buzukut dhe *E mbësuar e krishterë* e Matrëngës), si dhe përkthimet e Pjetër Budit të fillimit të shekullit XVII shënojnë fazën e përkthimeve të veprave teologjike didaktike dhe moralizuese. Njëkohësisht me ta nis edhe faza e prozës rrëfimore origjinale, në formë të prozës biografike. Ndërkaq, poezia e Budit dhe veprat e Bardhit shënojnë nismën e fazës së veprave letrare origjinale. Në këtë mënyrë, natyrshëm shënohet ecuria e brendshme e letërsisë shqiptare të kësaj periudhe historike.

Pjetër Bogdani, duke njohur këtë traditë të shkrimit të shqipes do t'i rreket një problemi tjetër, më të lartë të shprehshmërisë – popullarizimit dhe afirmimit ndër shqiptarë të mendimtarisë kishtarë e greke-romake, si dhe kultivimit e afirmimit të prozës rrëfimore e të poezisë me temë biblike. Këtë preokupim krijues ai do ta shtjellojë në veprën *Çeta e profetëve*, e cilësuar nga studiuesit (shqiptarë e të huaj) si vepra e vetme e këtij lloji në një gjuhë kombëtare dhe ndër të rrallat në gjuhë të tjera të kësaj kohe. Vepra është e shkruar në dy shtylla (në italisht dhe në shqip) dhe është botuar në Padovë në vitin 1685.

Pjetër Bogdani jetoi dhe u shkollua në një kohë tronditjesh e trazirash kombëtare e ndërkombëtare dhe u formua si intelektual i madh në rrethana të vështira e të rënda kulturore dhe letrare e filozofike kombëtare dhe evropiane e ndërkombëtare. Ai, duke ndjerë veten intelektualisht të përgatitur për një ndërmarrje të këtillë të përthekimit të problemeve kishtarë, si dhe të arsimimit kombëtar (sepse pat doktoruar në filozofi e teologji, më 1658) deshti ta plotësojë një zbrastirë të madhe që ndjehej në literaturën kishtarë katolike shqiptare.

Një pjesë e veprës së tij mund të konsiderohet si një lloj traktati filozofik teologjik, sepse përmban të gjitha kriteret vlerësuese të veprave të kohës, siç praktikohesh atëherë. Në të rrah probleme aktuale filozofike që lidheshin me botëkuptimin filozofik

teologjik të kohës dhe këto në mënyrë të jashtëzakonshme i zbatoi praktikisht në librin e tij *Cuneus Prophetarum*. Në këtë mënyrë, ajo ka rëndësi të madhe e të veçantë historike, sepse mjediset intelektuale italiane e shqiptare, si dhe evropiane i njoftoi me fuqinë e intelektit të tij për t'i përthekuar e gërshetuar njohuritë filozofike e teologjike greke-romake e mesjetare kishare, sidomos të shën Augustinit e të Toma Akuinit. Me çka promovoi aftësinë e vet rezonuese të mendimtarisë bashkëkohëse evropiane.

### **Struktura kompozicionale e Cuneus Prophetarum**

Për të pasur një përfytyrim më të plotë për brendinë e *Cuneusit* po e përshkruajmë shkurtimisht përmbajtjen e këtij libri, ashtu siç e ka bërë vetë Bogdani. Subjekti kronologjikisht ndërtohet sipas përmbajtjeve të *Biblës*. Mirëpo, dallon shumë prej saj, sepse Bogdani me përpikmëri nuk i përmbahet strukturës kompozicionale të saj. Ai për zgjedh dhe afirmon vetëm ato pjesë, të cilat konsideron se janë të domosdoshme. Pra, libri vetëm si ndërtim i jashtëm përafrohet me përmbajtjen e *Biblës* dhe jo me strukturimin e subjektit, që domethënë ndërtimi i subjektit dhe seleksionimi i njohurive ka radhitje të veten, bogdaniene.

Studiuesit janë të mendimit se sipas konceptit të *Biblës*, libri ndahet në dy pjesë (Rugova 1982: 75), në të cilat përshkruhet krijimi i kozmosit, i botës, njerëzimit, veprat dhe profecitë e shenjtorëve dhe profetëve, këngët paralajmëruese të sibilave mbi ardhjen Krishtit (pjesa e parë) dhe lindja, rrita, misioni dhe vdekja e ringjallja e Krishtit (pjesa e dytë). Në një farë mënyre, si tërësi, vepra ndahet sipas *Biblës*, që është e ndarë në *Besëlidhje të vjetër*, e që i përgjigjet pjesa e parë e librit dhe në *Besëlidhje të re*, që i përgjigjet pjesa e dytë e librit të Bogdanit.

Mirëpo, kjo përafri është vetëm në fushën e strukturimit të lëndës, përkatësisht në rrafshin e ndarjes së saj në dy pjesë, që nuk është e domosdoshme të lidhet patjetër edhe me ndarjen në të njëjtën mënyrë, sikurse edhe Bibla, sepse siç do të shohim edhe më poshtë Bogdani nuk përmbahet me përpikëri strukturës kompozicionale të saj. Kështu ai arriti të krijojë një vepër madhore.

Mandej ai nuk i përmbahet me përpikëri as edhe ngjarjeve që përshkruan Bibla, por bën një përzgjedhje dhe një radhitje të veten që ia nënshtron kërkesave të liturgjisë kalendarike kishtarë (Sedaj 19-1989: 129-130).

Secila pjesë e librit ndahet në *shkallë*, shkallët në *ligjërata* dhe ligjëratat në *paragrafe*. Të dyja pjesët kanë nga katër shkallë, kurse numri i ligjëratave nuk është i njëjtë. Përveç kësaj, secila shkallë përcillet me një nëntitull të veçantë dhe pastaj vijojnë ligjëratat, numri i të cilave sillet prej katër deri në njëzetënjë. Shkalla më e gjatë, e treta e pjesës së parë të librit ka njëzetënjë ligjërata, kurse të tjerat kanë: *njëmbëdhjetë* (shkalla e katërtë e pjesës së parë); *nëntë* (shkalla e parë e pjesës së dytë), nga *shtatë* (shkalla e parë e pjesës së parë dhe shkalla e dytë e pjesës së dytë), ndërkaq nga *katër* ligjërata (kanë shkalla e dytë e pjesës së parë dhe shkalla e tretë dhe e katërtë e pjesës së dytë).

### **Gjeniu njerëzor dhe askeza hyjnzuese**

Në studimet shqiptare janë thënë mendime se Bogdani bëri përpjekje edhe në poezi dhe në prozën origjinale rrëfimore, por pa talent dhe pa sukses (Historia 1968: 183). Interpretimi dhe studimi i këtillë i tërësisë së brendisë së veprës së tij, përkundër rezultateve të kënaqshme e të padiskutueshme, siç shihet, është i njëanshëm, sepse nuk përfshin totalitetin e veprës bogdaniene.

Në të vërtetë, totaliteti i veprës së Bogdanit lihet anash, nuk i jepet vendi i merituar, nënçmohet krejtësisht, me qëllim ose pa të përmbajtja dhe synimi letrar i kësaj vepre madhore, sepse regjistrohen sipërfaqësisht vetëm disa veçori të saj. Në këtë aspekt vepra e Pjetër Bogdanit është parë vetëm si totalitet filosofik, kurse totaliteti letrar i kërkesave të kohës, sidomos i pjesës së dytë, është lënë pasdore.

### **Vepra e Bogdanit dhe bashkëkohësia teorike - letrare**

Interpretimet bashkëkohore të teksteve të letërsisë të shekujve të kaluar, sidomos të atyreve të largët nga koha jonë duke

kaluar kufijtë e interpretimit tekstologjik-kritik dhe filosofik përpiqen, nga pozita të ndryshme të depërtojnë në strukturën e botës së veprës letrare, të realizuar në forma të ndryshme. Teksti i Bogdanit i dedikohet një rrethi të gjerë lexuesish specialistë, ndaj edhe përvoja e tij për këtë kolektiv të caktuar marrësisht të porosisë poetike është nivelizuar me afinitetin, arsimimin, shkallën e ngritjes intelektuale, reaksionet, këndvërtimin e fenomeneve, që sigurisht nuk prapambesin pa ndikuar edhe në formësimin dhe nuancimin interpretativ të brendisë së njohur. Nuk duhet harruar edhe faktin se shkrimtari i Mesjetës së vonë, parasheh një rreth më të gjerë e më të madh lexuesish poetencialë, ngaqë ky rreth praktikohet në Mesjetën e hershme, sidomos në kohën e shën Augustinit.

Bogdani në planin filozofik – teologjik - retorik është bashkëkohës i Dekartit, Melbranshit, Spinozës, Lajbnicit, Makiavelit e të tjerëve. Ai nuk krijoi ndonjë traktat teorik-letrar apo filozofik me përmasa evropiane, siç asokohe ishte praktikë, por, sa i përket pjesës së parë, në përmasa kombëtare shqiptare, krijoi më tepër se një traktat. Në veprën e tij, në mënyrë të përmbledhur e përcolli mendimtarinë filozofike-teologjike të kohës dhe me të e informoi lexuesin shqiptar. Ai këtë lexues e porosit: *“E madhe dobij anshtë praa me ndërequnë këtë shkallë t’urtijsë, e me shkruem bukurë me shqyrëtuem e me dijtunë se si duhetë nierit temelitunë me u përcjellë sa anshtë mbë këtë jetë, me frujtit të shpirtit vet ende të popullit, të mos lanë dijenë e gjuhen’ e dheut me u dvarunë; po si lëfton gjithë dheu e shekulli për të vet, po tue u nalcuem prej urtishit, andej ta ketë udob të fluturuemitë mbi qiellt e ndë parrijsit”* (Zajmi 1968: 77).

Në historinë tonë të letërsisë këtij mendimi teorik letrar të Bogdanit nuk i kushtohet ndonjë rëndësi për të qenë. Në tekstet universitare dhe të shkollave të mesme të historisë së letërsisë (*Shkrimtrët shqiptarë I*, Tiranë 1941; *Historia e letërsisë shqipe I*, Tiranë 1959; I – II, Prishtinë 1968; *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1983; Prishtinë 1989), në aspektin ideor i jepet njëfarë merite, kurse në aspektin letrar jo gjithë. Ibrahim Rugova në studimin e tij monografik kryesisht analizon aspektin filozofik, retorik dhe deridiku estetik të Bogdanit, që do të përmbledhet brenda

tërësisë së dy shkallëve të para të librit, kurse nga pjesët e tjera inicon disa çështje teorike-letrare që dalin nga vepra e që lidhen me përfshirjen e kësaj vepre, sidomos të pjesës së dytë me ndonjërin nga llojet e prozës rrëfimore. Është i mendimit se pjesa e dytë i përket zhanrit të *biografisë së romanësuar*, edhe pse shpreh edhe mendimin se mund të konsiderohet *roman biografik* (Rugova 1985: 189-196).

Sabri Hamiti, pas tij, mendon se vepra e Bogdanit është krijuar mbi bazën e një vepre tjetër të këtij lloji (Hamiti 1983: 170-171; 1989, 7: 1, 6, 7), që anon kah *Bibla* dhe, në këtë rast, studuesve i mbetet obligim të vërtetojnë, në këtë vepër, atë që është e Bogdanit dhe atë që është e huajtur prej të tjerëve. Pasi të jetë bërë një analizë e këtillë, atëherë do të vërtetohej çështja e origjinalitetit dhe e imitimit të autorëve vendës dhe të huaj.

Edhe studimet e mëpasme si ato të E. Sedajt (Sedaj 1983: 13; 1984, 1: 53-59; 1989:10) e ndonjë tjetri pak a shumë sillen rreth këtyre problemeve, duke përpunuar dhe plotësuar mendimin e njëri-tjetrit dhe duke u përpjekur t'i veçojnë elementet poetike të shkruara, pastaj të përafrimit me ato gojore shqiptare. Ndërkaq mendimet e studuesve të tjerë të veprës së Bogdanit mbesin brenda përsëritjes së mendimeve filozofike, të shtruar që në vitet e tridhjeta të shekullit të njëzetë.

Kështu, para lexuesit të sotëm, çështja e vrojtimit dhe e interpretimit të veprës së Bogdanit mbetet të bëhet brenda pikëpamjes së studimit të saj si një vepër letrare thellësisht e angazhuar mbi afirmimin e krishterimit, theksueshmërinë religjioze-utilitare-moralizuese dhe tendencën e institucionalizimit të artit letrar. Mbështetur në traditën kishtare letrare, ai hartoi një vepër vetjake e të përsëritshme letrare në traditën shqiptare.

### **Funksionaliteti i poezisë dhe i prozës rrëfimore**

Tekstet poetike në vargje që Bogdani i vendos në *Cuneusin* e tij vihen në funksion ilustrativ të idesë dhe në funksion të medias së pavarur shprehimore. Në to flet për krijimin e kozmosit dhe për lindjen, jetën dhe vdekjen e Krishtit. Parë nga ky aspekt, poezitë origjinale të Bogdanit paraqesin brendinë prozaike të *Cuneusit* në miniaturë dhe të poetizuar.

Në librin e Bogdanit botohen trembëdhjetë poezi origjinale, dhjetë prej të cilave përbëjnë një cikël më vete dhe janë formuluar në sistem të poemave mesjetare të shekujve XIV-XVI. Në to nëpërmjet Sibilave (profeteshave) dhe në frymën himnike i këndon paralajmërimin të ardhjes së Krishtit. Në ligjëratën e katërt të pjesës së parë të librit jepen dymbëdhjetë vjersha origjinale të Bogdanit me afro 150 vargje njëmbëdhjetërokëshe. Këtyre vjershave i prin vjersha “*Krijimi i rruzullimit*” me 16 vargje në njëmbëdhjetërokësh. Përveç këtyre poezive origjinale të Bogdanit, në vepër jepen edhe fragmente të përkthyer të vjershave të Homerit, Virgjilit, Juvenalit, Plinit (Sedaj 1991: 132-133). Në *Cuneus* jepet edhe një poezi ditirambike, himnizuese kushtuar Andreja Zmajevičit dhe vjersha të autorëve të tjerë kushtuar Bogdanit, si ajo e kushëririt Lukë Bogdani apo e Lukë Sumës, apo ajo e poetit bashkëkohës kroat Pavao Riter Vitezoviçit.

Në vjershat e Bogdanit përdoret struktura metrikore klasike, sidomos ajo mesjetare e kohës. Përdoret vargu njëmbëdhjetërokësh me strukturë ritmike 6+5 dhe 7+4, kurse në planin silabik tonik përdori jambin dhe trokeun. Me numrin e rrokjeve në varg dhe të këtyre në strofë sjell risi në historinë e poetikës shqiptare, sepse, siç e dijmë, pararendësi i tij Petër Budi përdori tetërokëshin simetrik me strukturë silabike jambike dhe trokeike.

Karakteristikë e vargut të tij e trashëguar nga pararendësi është edhe kapërcimi i idesë prej njërit në vargun tjetër dhe sistemi i rimimit të brendshëm të kryeqëzuar. Por do vërejtur se, në ndërtimin dhe krehjen e vargut nuk u tregua gjithaq i kujdesshëm, në krahasim me Budin. Te Budi është vështirë të gjejmë një varg që të ketë më pak ose më shumë se tetë rrokje, kurse vargjet e Bogdanit herë i dalin dhjetë – e herë dymbëdhjetë rrokëshe, por më i theksuar është njëmbëdhjetë rrokëshi, të cilin më të përdorshëm e gjejmë edhe te Jul Variboba, gati një shekull më vonë.

### **Formësimi i porosisë poetike**

Mbështetur në studimet e sotme të artit letrar, në qoftë se tekstin letrar e kuptojnë si sistem shenjash gjuhësore, me të cilat

përcaktohet dhe zbulohet formësimi i botës poetike (Katičić 1971: 226) dhe në qoftë se me *stil* nënkuptojmë jo vetëm shenjat e caktuara të gjuhës, por edhe unitetin dhe harmoninë e të gjithë faktorëve përbërës të botës poetike të veprës letrare (Žmegač 1969: 501), atëherë do të bindemi se elementet letrare të veprës së Bogdanit duhet studiuar brenda pikëpamjeve të letërsisë së kohës dhe kërkohet të analizohen në funksion të ndërtimit të një bote të caktuar poetike. Nëse pranojmë mendimin e Kajzerit (Kayser 1973: 417) se në krijimin e botës poetike të ndonjë vepre letrare marrin pjesë tre faktorë: *figura*, *hapësira* dhe *veprimi* do të bindemi se vepra e Bogdanit i posedon këta tre faktorë.

Pjesa e dytë e *Cuneusit*, që përshkruan jetën e Krishtit nga lindja deri në vdekje dhe përfundon me ringjallje, me shenjat e riparazitjes së tij, ka zgjuar interesimin e studiuesve për përfshirjen e kësaj pjese të librit në ndonjërin nga llojet letrare të prozës rrëfimore. Siç u tha më sipër janë dhënë mendime se i përket gjinisë së *jetëshkrimit*, *biografisë së romanësuar* apo *romanit biografik*.

Në *pjesën e dytë* të librit, siç është theksuar, përshkruhet jeta e Krishtit nga lindja e deri në ringjallje. Në *shkallën e parë* të titulluar "*Jeta e Jesu Krishtit shëlbues' i vertetit Mesi*", të ndarë në *nëntë ligjërata* përshkruhet: (1) jeta e shën Mërisë Virgjër, (2) mbetja shtatzanë, (3) paralajmërimi për lindjen e Krishtit, (4) lindja e tij, (5) ceremonitë pas lindjes, (6) devotshmëria, (7) shmangia nga prindërit në Jerusalem, (8) pagëzimi nga Gjon Pagëzuesi, (9) zgjedhja e apostujve.

Në *shkallën e dytë*, të titulluar "*Mrekullitë e Jesu Krishtit*" në *shtatë ligjërata* përshkruhen mrekullitë e Krishtit: (1) mrekullia e verës dhe mrekulli të tjera, (2) predikimi dhe përfitimi i besimtarëve me anë të mrekullive, (3) mrekullia e shumimit të bukëve, (4) vurja e gurthemelit të kishës, (5) ngjallja e Lazrit, (6) hyrja triumfale në Jerusalem dhe (7) darka e fundit e Krishtit me apostujt.

Në *shkallën e tretë*, të titulluar "*Pësimi e mortja e Zotit tinë Jesu*" flitet për sakrificën e Krishtit dhe esencën e besimit të Krishterë - jetës me anë të vetëflimijit. Në të *katër ligjëratat* përshkruhen momente të fundit të jetës së Krishtit: (1) derdhja e gjakut të Krishtit

dhe tradhtia e Judës, (2) shpurja e Krishtit te Pilati, pastaj te Herodi; (3) gjykimi e kryqëzimi dhe heqja e tij nga kryqi; si dhe (4) dorëzimi shën Mërisë. Në vazhdim të kësaj shkalle jepet një pjesë e legjendës së Danielit për paralajmërimin e ardhjes së Krishtit në tetë gjuhë.

Në *shkallën e katërtë*, të titulluar “*Të ngjallunit e së ardhunit së dyti të Krishtit shelbyes*” në *katër ligjëratat* përshkruhet jeta, veprimet dhe funksioni i Krishtit pas vdekjes së tij fizike. Pra, në ligjëratën *e parë* (I) përshkruhet mënyra e ngjalljes ditën e tretë pas kryqëzimit, në *të dytën* (II) ngritja në qiell, në *të tretën* (III) mënyra e zbritjes së “shpirtit shenjtë ditën e rshiavet” dhe në *të katërtën* (IV) riardhja e Krishtit në tokë Ditën e Gjyqit.

Vepra e Bogdanit, sidomos pjesa e dytë, e parë sipas këtyre kërkesave teorike-letrare, imponon nevojën e analizës së faktorëve e kategorive përbërëse të veprës letrare. Fillimisht kërkohet nevoja e shkoqitjes së *përmbajtjes* dhe *e formës* së kësaj vepre. Pastaj vijnë elementet e tjerë, si janë (a) analiza e fabulës: mënyra e ndërtimit, tipat e zhvillimit dhe mënyra e organizimit të lëndës rrëfimore; (b) formësimi i *fillimit* dhe i *përfundimit* të ndërtimit të veprimit: *topika* dhe *formulat* nismëtare, mënyra e depërtimit në rrëfim; (c) *ndërtimi i figurave* letrare; (ç) *roli* dhe *vendi* i rrëfimitarit; (d) *formulat rrëfimore*: përshkrimi, informimi, dialogu; (dh) *retorika e formave rrëfimore*: përsëritja stilore, gradacioni stilor, antiteza, metafora, hiperbola, alegoria, simboli – forma të njohura të shprehjes figurative të barokut religjioz; (e) koncepti *i kohës* dhe *i hapësirës*; (ë) *strukturimi kompozicional*; (f) *ritmi* dhe *stili poetik*.

Analiza e këtyre faktorëve qenësorë të zbërthimit të veprës letrare të Bogdanit do të vërtetonte se sa Bogdani i shmanget traditës biblike dhe sa i jep vetes liri të krijojë model të ri rrëfimor. Njohuritë e deritanishme vërtetojnë se ai traditën biblike e përdor vetëm si temë dhe motiv, kurse personazhet sillen lirshëm dhe formojnë tipa letrarë. Madje edhe teknika e rrëfimit largohet shumë prej mënyrës biblike të mbarështimit të veprimit.

Është konstatuar nga studiuesit se me jetën e Krishtit dhe të Shën Mërisë ai shtiu në letërsinë tonë llojin e jetëshkrimit. Figura e Krishtit është vizatuar me realizëm. Ajo realizohet përmes rrëfimit

artistik nga veta të ndryshme. Vend të rëndësishëm zë përshkrimi i viseve e i personazheve. Përdoret dialogu biblik në formë të ligjëratës së zhdrejtë, ndonjëherë edhe dialogu i drejtpërdrejtë, por edhe monologu.

Shembull konkretizimi për këtë të fundit po japim monologun e brendshëm mjaft emocional, të ndjeshëm dhe efektiv të vajtimit të Shën Mërisë, i cili konsiderohet ndër përshkrimet më të bukura të gjendjes së brendshme shpirtërore të personazhit:

*“Aty mbeti Vetemë e Lumeja Virgjinë fort çkushëlluem me shoqënitë të vet, e tue soditunë shëlbuesinë thoj, oh e mjera unë qi vetemë po jes, e nder të vetemet, ma e vetëmëja. Perse o bir gjithë të miretë tem ti mua ma lae kështu? Ma mirë pat me kjanë të jeshe unë dekunë perpara, ti të mbëshilne syt e mi: unë ma e motçime, e dekunë ma mirë mot tand’: Perse deshe kështu i ri me dekunë e mue me më lanë? E nde të pelqej kështu i ri me dekunë, perse nukë me more me vetëhe? Njiherë të dvora, e desh dvora kryetë të dhimptunin djerë te gjetander Dotorë. Deh pra o gjithë të dashunitë tem, perse më lae kështu? Kan’ mujtë ti me marrë, me vetëhe qi të doj aqan’ fort sa te due unë ty? Si pra muite me më lanë kështu? Si nukë tu dhimpti posi vetë mortja eme? Ah i ambli biri em, perse më lae, e shkove? Te pelqej me të pam kështu posi po të shof mbë ket Kryq? Kuitove se tue të pam gozhduem: kam meu ngushëlluem, nuk besonj o bir se ti kujton atë dorë puneje, perse tue pam mbë ketë mendyrë qi je, mundetë me bam me dekunë nji mijë vet, e ma fort mue qi tjetër herë ndryshej te kam pam n’grykë mue kerthi, gjithë të bukurë“.*

Në këtë përshkrim, si dhe në të ngjashëm Bogdani largohet shumë nga tradita e përshkrimit biblik, i cili është më informativ dhe më i tkurrur, se sa i Bogdanit që është më i ngjeshur, më emocional dhe më efektiv.

Në bazë të zbatimit praktik të këtyre elementeve përshkrimore të veprës së Bogdanit, mund të flitet për vetitë dhe vlerën estetike të poezive dhe, sidomos të prozës së tij rrëfimore.

Gjykuar nga struktura kompozicionale, vepra ka formë romani me një figurë qendrore Jezu Krishtin, që shoqërohet prej personazheve të tjerë dytësorë: Shën Mëria, Apostujt, personazhet

kundërshtarë. Ideja qendrore e motivacionit është afirmimi i idesë së re. Konflikti filosofik i të resë me të vjetrën, sanksionimi dhe gozhdimi i Krishtit janë rrafshet e zhvillimit të veprimit. Në rrafsh të llojit letrar, po kështu janë sjellë argumente se i përmbush kërkesat e kuptimit bashkëkohor të romanit: realizimi përmes rrëfimit artistik, evokimi i natyrës dhe i pamjes fizike të personazheve, dialogu biblik, dialogu i drejtpërdrejtë, monologu, sidomos monologu i brendshëm që paraqitet te vaji i Shën Mërisë.

Androkli Kostallari (Kostallari 1991: 41-44) lidhur me stilin e Bogdanit ka veçuar pjesët e portretizimit “fizik e moral të vashës Mari” dhe vajtimet e Krishtit, sipas shembullit të vajeve popullore; portretin e Krishtit të dhënë me gjallëri e “me tipare fizike e morale të një djaloshi” shqiptar. “Ai e lidh hijeshinë e krenarinë e vashave shqiptare e të djelmohave shqiptarë me bardhësinë e madhështinë marramendëse të majave të Lubotenit, /.../ që të mahnit në çdo stinë e që ai e do si qenien më të shtrenjtë të zemrës. Kjo shkrirje, /.../ ky njëjtësim i njeriut me vendlindjen, i gjuhës amtare me Atdheun, si një ide e madhe poetike e Bogdanit”, shton prof. Kostallari përvijohet edhe te Naimi e De Rada.

## **Përfundim**

Në goftë se më thellësisht depërtohet në këtë problematikë të letërsisë shqiptare kishtarë, do të shohim se Bogdani ndjek një traditë më të hershme, traditën mesjetare letrare. Personazhi është një figurë kulti, historikisht e determinuar, përshkrimi i së cilës kur i nënshtrohet kërkesave poetike të Mesjetës dhe pikëpamjeve që ka mbrojtur Bogdani, është vështirë të kërkohet prej krijuesit të largohet nga elementi biografik që sjell historiografia. Ashtu sikurse Pjetër Budi në vjershat e tij, edhe Bogdani nuk bën përjashtim. Ai përshkruan momentet më të rëndësishme të jetëshkrimit të Krishtit, sidomos ato të cilat kanë vërtetësi më të madhe historike.

Prova e Bogdanit nuk bën përjashtim në traditën letrare kishtarë. Përveç kësaj, në Mesjetë, pastaj edhe në letërsinë kishtarë të

Përtërirjes është kërkuar që shkrimtari me përpikmëri t'i përmbahet faktografisë historike. Vepra poetike, me Krishtin kryepersonazh, janë shkruar edhe para edhe pas Bogdanit. Mjafton të përmendet Torkvato Taso, apo Ludoviko Ariosto, poetë të letërsisë italiane, që janë të njohur me *Christiadën* e njohur (Sedaj 1991: 128-134; Neziri 1995: 59). Një përpjekje të ngjashme poetike mbi Krishtin, por nga një këndvështrim tjetër, sidomos duke pasur pikënisje *lutjen* si formë letrare, do të bëjë edhe Jul Variboba.

Pavarësisht parantezës së përkatësisë ndonjë zhanri të veprës së Bogdanit, vlera e saj dhe rëndësia historike letrare nuk zvogëlohet, përkundrazi rritet. Bogdani, duke çuar më tej traditën letrare në gjuhën kombëtare dhe duke sjellë forma të reja shprehëse, sidomos prozën rrëfimore mbetet njëri prej autorëve të parë që lavroi këtë formë letrare dhe me të zë njërin ndër vendet më të rëndësishme të historisë së letërsisë shqiptare të shekujve XVI-XVII.

## Përmbledhje

Në përvjetorin e 330-të të vdekjes së Pjetër Bogdanit riaktualizojmë disa çështje të nisura nga studiuesit e veprës së këtij shkrimtari të madh të traditës sonë letrare, si dhe të nisim një rrugë parë sipërfaqësisht nga studiuesit e deritanishëm.

Pjetër Bogdani jetoi në fund të gjysmës së parë dhe në tridhjetë vjetët e parë të gjysmës së dytë të shekullit XVII. Intelektualisht u formua nëpër qendra të rëndësishme kulturore dhe arsimore ballkanike (në vendlindje dhe në Ciprovec të Bullgarisë) dhe evropiane (në Kolegjin e Loretos dhe në Kolegjin e Propagandës Fide në Romë).

Shekulli XVII është shekull i konsolidimit të letërsisë shqiptare të periudhës prej fillimit të saj e deri në prag të mbarimit të këtij shekulli. Derisa në shekullin XVI u dalluan disa autorë që krijuan në gjuhën latine dhe në sajë të saj me veprat e veta u afirmuan në qarqet evropiane dhe dy autorë që shkruan librat e parë në gjuhën shqipe (njëri në të folmen veriperëndimore të shqipes dhe tjetri në të folmen e arbëreshëve të Italisë). Me këto, gjuhën dhe kulturën

kombëtare ata e ngritën në nivel të atyre evropiane. Në shekullin XVII dalin një numër autorësh që vazhdojnë traditën e të parëve dhe kështu ndihmojnë konsolidimin dhe rrumbullakësimin e një periudhe të caktuar letrare.

Vepra e Pjetër Bogdanit *Cuneus Prophetarum* shënon një hap të rëndësishëm përpara drejt konsolidimit dhe stabilizimit të traditës letrare shqiptare si në poezi, ashtu dhe në prozë. Me këtë veprimtari, ai qëndron midis traditës së trashëguar nga shkrimtarët para tij dhe në krye të fillimit të një tradite të re të historisë së mendimit dhe të letërsisë shqiptare. Vepra e tij, kështu paraqet një urë ndërlidhëse midis traditës së hershme dhe të resë në lindje. Me veprën e tij Pjetër Bogdani vazhdon traditën e poezisë shqipe, të themeluar nga Pjetër Budi dhe është themelues i prozës letrare shqiptare, në pjesën e dytë të librit të tij.

Studimet e derisotme të veprës së Bogdanit nuk janë marrë, në mënyrë të veçantë me vlerën letrare dhe poetike, përveçse dhënies së vërejtjeve dhe pikësnyimeve të veprës së tij poetike në vjersha dhe në prozë. Brenda e *Cuneusit* përgjithësisht lidhet me legendat dhe rrëfimet biblike, që është përpunim i tyre në vargje ose në prozë. Kështu, vlerësimi i mirëfilltë i veprës së tij kërkon të shtrihet në dy aspekte: letrar (poezi e prozë) dhe filosofik.

Autori dëshiron ta çojë më tej dhe ta zhvillojë diskutimin rreth një problematike të kësaj vepre, e cila ose është shqyrtuar shkarazi ose edhe fare nuk ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, si një tërësi brenda kompleksitetit dhe totalitetit të vetë veprës së Bogdanit dhe të veprës letrare, në përgjithësi, si fenomen poetik. Në këtë punim synojmë të ndriçojmë vetëm disa aspekte nga të shumtët të veprës poetike *Çeta e profetëve* të Pjetër Bogdanit, të botuar në Padovë më 1685.

Në këtë studim jepet një pasqyrë e plotë e intersimit shkencor për vlerësimin e punës intelektuale të kërrij autori të traditës. Do të preken disa çështje teorike të hartimi të këtij libri liturgjik. Njohja dhe studimi i plotë i veprës së Pjetër Bogdanit është me rëndësi të madhe si për historinë e kulturës së shkrimit shqip, ashtu edhe për historinë dhe teorinë e letërsisë, si dhe për teosofinë shqiptare.

## Summary

On the 330-th anniversary of Pjeter Bogdanis death we would like to reactualize some issues initiated by researches of the work of this Great writer of our literary tradition, and to initiate an aspect superficially reviewed by contemporary researchers.

Pjetër Bogdani lived at the end of the first half and in the first thirty years of the second half of the 17th century. Intellectually was formed across important Balkan cultural and educational centres (in his homeland and in Ciprovec, Bulgaria) and European (at the College of Loreto and the Fide Propagande College in Rome).

The 17<sup>th</sup> century is the century of consolidation of Albanian literature from the beginning until the end of this century. While in the 16<sup>th</sup> century were distinguished several authors that wrote in Latin, after two authors who wrote the first books in Albanian were affirmed in the European regions (one in the Northwestern Albanian dialect and the other in the Arbëresh Italian dialect). As a result the language and national culture was raised to European level. In the 17<sup>th</sup> century many authors continue the tradition of the ancients and thus help to consolidate and finalize a certain period of literature.

Pjeter Bogdani's work "Cuneus Prophetarum" marks an important step towards the consolidation and stabilization Albanian literary tradition in both poetry and prose. With this work, he stands between the inherited tradition from writers before him and at the beginning of a new tradition of the history of Albanian thought and literature. Thus his work represents a connecting bridge between the early and the new tradition in east. With his work Pjeter Bogdani continues the tradition of albanian poetry, established by Pjeter Budi and is the founder of albanian narrative prose, with the second part of this book. To date studies of Bogdani's work have not been obtained, in particular with literary and poetic value, besides giving remarks and goals of his poetic work in poems and prose. The plot of Cuneus is generally associated with biblical legends and narrative, which is their processing in verse or in prose. From this aspect of

authentic appreciation of his work seeks to extend in two aspects: literary (poetry and prose) and philosophical.

The author wants to continue to extend the discussion around an issue of this work, which is reviewed marginally or even at all has not drawn researchers attention, as whole inside the complexity and totality of Bogdani's work and generally the literary work, as poetic fenomen. In this paper we intend to illuminate only some of many aspects of the poetic work *Çeta e profetëve* by Pjetër Bogdani, published in Padua 1685.

This study provides a comprehensive overview of the scientific interest for evaluation of the intellectual work of this author of tradition. Some theoretical issues of drafting of this liturgical book will be reviewed. The recognition and comprehensive study of the work of Pjetër Bogdani is of great importance for the history of Albanian writing, as well as for the history and theory of literature, as well as the Albanian theosophy.

(Translated by: Kaltrina Qerimi)

### Bibliografi

- BOGDANI, Pjetër (1989), *Çeta e profetëve (Cuneus prophetarum)*. Translimerimin në gjuhën e sotme, përkthimet dhe parathënien Dr. Engjëll Sedaj. Rilindja, Prishtinë.
- BOGDANI, Pjetër (2005), *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve)*. Botim kritik me një studim hyrës, faksimile të originalit, transkriptim e shënime. Përgatitur nga Anila Omari. ASHSH, IGJL. Tiranë.
- CURTIUS, Ernst Robert (1971), *Evropska književnost i latinsko srednjovjekovlje*, Zagreb.
- FRANGEŠ, Ivo (1987), *Povijest hrvatske knjiženosti*, Zagreb.
- HAMITI, Sabri (1983), *Arti i leximit*, Prishtinë.
- HAMITI, Sabri (1989), *Poezia e Pjetër Bogdanit: »Fjala«*, Prishtinë XXII, 7 (1 prill), 1, 6, 7.
- JAUSS, Hans Robert (1970), *Teorija rodova i književnost srednjega vijeka: »Umjetnost riječi«*, Zagreb XIV, 3.
- KATIČIĆ, Radoslav (1971), *Jezikoslovni ogledi*, Zagreb.
- KAYSER, W. (1973), *Jezičko umetničko delo*, Beograd.
- KOSTALLARI, Androkli (1991), *Pjetër Bogdani dhe gjuha letrare shqipe: Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, Tiranë: 17-52.
- NEZIRI, Zeqirja (1995), *Poezia e Budit*, Ekoritmi, Shkup.
- RUGOVA, Ibrahim (1982), *Vepra e Bogdanit 1675 – 1685*, Prishtinë.

- SEDAJ, Engjëll (1983), Parathëniet dhe përkushtimet e *Çetës së profetëve* të P. Bogdanit: »*Rilindja*«, Prishtinë, 3. XII. 1983, f. 13 dhe »*Jeta e re*«, Prishtinë, XXXV/1984, 1, 53 – 79.
- SEDAJ, Engjëll (1988), Filozofia e natyrës dhe poezia në veprën e Pjetër Bogdanit: »*Jeta e re*«, Prishtinë, XXXIX, 8, 1069 – 1097;
- SEDAJ, Engjëll (1989), Korife i shkencës dhe i letërsisë shqiptare: »*Rilindja*«, Prishtinë, 7. I. 1989, 11;
- SEDAJ, Engjëll (1990), Aspekte homilike, etnologjike dhe filozofike të *Çetës së profetëve* të Pjetër Bogdanit: *Gjurmime albanologjike – folklore etnologji 19-1989*, Prishtinë 1990: 129-141.
- SEDAJ, Engjëll (1991), Poezitë origjinale dhe të përkthyer të Pjetër Bogdanit: *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, Tiranë: 127-144.
- SHITA, Vehap (1984), Pjetër Bogdani: »*Rilindja*«, Prishtinë, 29. IX. 1984, 15.
- ŠICEL, Miroslav (1982), *Hrvatska književnost*, Zagreb.
- X x x x x *Historia e letërsisë shqipe* I, Tiranë 1959; I – II, Prishtinë 1968.
- X x x x x *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1983.
- X x x x x *Shkrimtrët shqiptarë I*, Tiranë 1941.
- ZAJMI, Yll (1968), *Antologji e letërsisë së vjetër shqipe*, Prishtinë.
- ŽMEGAČ, Viktor (1969), *Stil: Uvod u književnost*, Zagreb.

UDC 821.18-1.09  
Punim studimor

**Vebi BEXHETI**

Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë

E-mail: v.bexheti@seeu.edu.mk

## **PËRMASA UNIVERSALE NË POEZINË E MIGJENIT**

### **UNIVERSAL SIZE IN THE POETRY OF MIGJENI**

Për këtë rast u përcaktova për Migjenin, me bindjen se kjo figurë e ndritur e letërsisë sonë, meriton një prezentim edhe në këtë takim shkencor me përmasa të mëdha për shkencën shqiptare. Migjeni, me jetë aq të shkurtër dhe vepër aq të madhe, e nxiti aq shumë mendimin kritik duke provokuar numër të madh studiuesish, që nga koha kur u botua vepra e tij e deri në ditët e sotme.

Vlerësimet për veprën e tij ishin nga më të ndryshmet, nga ata që këtë krijues e vlerësonin vetëm si poet mjerimi, e deri te ata që hiqnin dorë nga ndonjë përfundim, që do ta shteronte mendimin e mëtejshëm të vlerësimit, nga ata që e quajtën paralajmëruesin më të madh të komunizmit, e të cilët “zbuluan” se disa poezi, siç janë: *Të lindet njeriu* dhe *Trajtat e mbinjeriut* ia paska kushtuar udhëheqjes së komunizmit që po lindte, deri te poeti pesimist, për të cilin jeta nuk kishte asnjë kuptim, përveç vuajtjes dhe mjerimit.

Sidoqoftë, në këtë moment nuk e kemi temë shqyrtimi mendimin kritik, por disa nga vlerësimet që dalin nga shkolla e ideologjizuar e kësaj kritike letrare, nuk na lë indiferent dhe mendoj se çdo kontribut që lidhet me këtë problematikë, është në shërbim të një rivlerësimi të ndonjë segmenti të veprës që sot është jashtë kohe, e kjo nuk do të thotë se aq lehtë mund të mbyllet dosja e studimit të mëtejshëm, përkundrazi edhe sot njohësit më të mirë të Migjenit

besojnë me plot bindje se as afërsisht nuk është thënë ajo që mund dhe duhet të thuhet lidhur me këtë vepër.<sup>1</sup>

Studiuesit e shumtë të letërsisë shqipe që merren edhe me veprën e Migjenit, e që e veçojnë dhe e theksojnë më tepër këtë vepër nga autorët pararendës dhe ata që vijnë pas tij, e kanë ndriçuar në masë të madhe ate, por sikur i janë shmangur trajtimit të temave dhe motiveve universale të cilat zënë, ndoshta jo në shtrirje por me siguri, në vështrim të peshës, një pozicion qendror.

Vepra e Migjenit, në këtë rast poezia e tij, është edhe e përmasave universale. Ajo nuk mund të konsumohet për një kohë të shkurtër, përkundrazi, është poezi që çon peshë e që kërkon studime më të gjithanshme. Edhe pse kjo poezi mund të duket si shumë personale dhe e kufizuar në kohë dhe hapësirë, fuqia e saj poetike në vete ngërthen vlera të gjithanshme dhe ka kuptim më të thellë se sa duket. Është e vërtetë se kjo u ndërtua në një periudhë kohore shumë të shkurtër dhe në një hapësirë të ngushtë, që është rezultat i vet jetës së përqendruar në mjedise të caktuara, e që u ngrit brenda revoltës së urrejtjes kundër regjimit të një momenti po ashtu të caktuar historik dhe dëshpërimit nga vetë jeta fatzezë e tij, por nëse kjo poezi lexohet kujdesshëm dhe depërtohet në mendimin filozofik të tij, mund të konstatohet lehtë edhe karakteri mbipersonal dhe mbikahor. Vetë fakti se në brendinë e veprës së Migjenit shihet, para së gjithash, njeriu, dhe ndonjëherë edhe mbinjeriu trajtash të ndryshme, flet edhe për individualen dhe gjithënjëzoren, për kombëtarën dhe universalen. Migjeni me filozofinë e re të tij poetike, njeriun dhe njerëzoren, për mjerimin dhe dëshpërimin, e ngrit në një model të pakapërcyeshëm për vizionin universal të mendimit të tij poetik.<sup>2</sup>

Dhembja personale e Migjenit dhe ambienti politiko-shoqëror i padurueshëm e rebelojnë atë duke e nxitur të tentojë t'i bijë ndonjëherë me grusht edhe malit. Edhe kjo revoltë që e nxit ate t'i qërojë hesapet me diçka që fare se ndijën atë grusht, e sidomos kur është fjala për shtetin dhe regjimin e tij, flet mjaftë për të kuptuar se Migjeni nuk rebelohet vetëm nga shkaku se është i lënduar

<sup>1</sup> Ali Aliu, Migjeni 4, Prishtinë, 1978, fq. 6

<sup>2</sup> shih te Jorgo Bullo, Magjia dhe magjistarët e fjalës, Tiranë 1998, fq. 154

shpirtërisht, por edhe për diçka më të madhe, të përgjithshme, kombëtare dhe më tepër se kaq, e kjo do të thotë se fati i individit është brenda kontekstit të bashkësisë dhe këtyre të dyjave në atë të përgjithshëm. Kjo krizë e moralit shoqëror dhe njerëzor do të thojë, Migjenin e provokon vazhdimisht, atë e bën poet që në shumëçka ndryshon nga të tjerët, ndryshon edhe në karakterin e përmasës universale që është e pranishme në krijimtarinë poetike të tij.

Migjeni si prijës i ideve përparimtare në mesin e shkrimtarëve të viteve të tridhjeta, me veprën e vet, solli një freski në letërsinë shqiptare dhe e theu atë monotoni poetike. Në poezinë shqipe ai solli vargje të lira me mendime të lira. Ai ishte thellë i bindur se këto ndryshime duhet të jenë radikale, të përfshinë totalitetin shoqëror dhe të sjellin një botë të re me moral të ri njerëzor<sup>3</sup> Këto risi, përveç tjerash, kanë edhe karakter të përgjithshëm. Metoda e tij krijuese dhe ballafaqimi me realitetin e shëmtuar që karakterizohej edhe me varfëri të skajshme, e dallonin gjithashtu këtë poet nga të tjerët. Ai edhe kur shkruan për mjerimin, nuk përqendrohet vetëm në atë të njeriut shqiptar. Këtë plagë shoqërore e sheh si një të keqe për mbarë njerëzimin. Me vargun e parë të „Poemës së mjerimit”: *Kafshatë që s'kapërdihet ash or vlla mjerimi*, ai i drejtohet vëllait të vet, pra, shqiptarit, por poemën e mbyll me vargjet: *Mjerimi asht një njollë e pashlyeshme/ në ballë të njerëzimit që kalon nëpër shekuj/ Dhe këtë njollë, kurr nuk është e mundëshme/ ta shlyejnë paçavrat që zunë myk ndër tempuj*. Është e vërtetë se Migjeni shpreh revolt kundër varfërisë që e kishte ngulfatur popullin e tij, duke ia ulur dinjitetin dhe moralin, në nivelin më të poshtëruar, por ai me të drejtë konstaton edhe një të vërtetë tjetër, se kjo njollë e zezë e kishte kapluar tërë njerëzimin që është e pamundur të shlyhet njëherë e përgjithmonë. Nga shumë vlerësime dhe analiza që i janë bërë kësaj vepre, si duket, nuk është shprehur edhe ky segment, pra karakteri universal i poemës. Është e vërtetë se këtu tema themelore është e mjerimit, me tërë pasojat që la te njerëzit, por shihet dukshëm edhe shtrirja e saj në përmasa të njerëzimit, në të gjitha kohërat. Varfëria edhe sot është fatkeqësia globale dhe si problem përmasash kaq të

---

<sup>3</sup> Rexhep Qosja, Migjeni 4, Prishtinë, 1978, fq. 129

mëdha, vështirë se do të zhduket ndonjëherë nga faqja e dheut. Pikërisht këtu, Migjeni edhe dallohet nga krijues të tjerë që e rrahën këtë temë duke e konsideruar vetëm si fatkeqësi ekskluzive e kombit të tyre.

Një poezi tjetër ku konstatohet ngadhënjimi i vlerës universale është ajo me titull „Shkëndija”: *Nga zjarri i shtëpisë u shkëput një shkëndijë/ dhe nëpër oxhak u vërsul në liri,/ nëpërmes t'errësinës/ muer udhën e qiellës/ dhe në mes hyjve të natës zu vendin e hanës*, thot poeti. Ai në vargjet e kësaj poezie përmend hënën, yjet dhe qiellin, dmth. Gjithësinë. Kjo shkëndijë që e la vatrën shkretë dhe e zuri vendin e hënës, do të bëjë dritë për të gjithë: *të mjeruemit në botë, që vuajnë e derdhin lot*. Drita e saj do të jetë në shërbim të njerëzimit dhe të gjithësisë, anipse një plak i vetmuar mbeti nëpër terr dhe më kot mundohet të: *ngre shkopin në hyje shkëndin për me gjetë,/ rebelin, që votrën e shtëpisë e la të shkretë...* Migjeni në këtë poezi, nëpërmjet një shkëndije që bënte vetëm pak dritë në vatrën e një shtëpie, kalon në terrenin e galaksisë për t'i bërë më tepër dritë tërë tokës arbërore dhe të gjithë të mjeruarve në botë. Me këtë vizion origjinal të lirisë së mendimit dhe të veprimit, ai me gjuhë të pasur poetike me figura të shumta, i prish kufijtë midis njerëzisë dhe hyjnores, reales dhe imagjinares, midis individit dhe gjithë njerëzimit.<sup>4</sup>

Te poezia „Të lindet njeriu”, poeti pret të lindet një njeri, që do ta ndihmojë kombin dhe tërë njerëzimin nga e keqja që sillte vetëm vuajtje e mjerim. Ky njeri do të duket i zakonshëm: *Pa yll në ballë, por që me fjalë të pushton*, dmth. ky njeri të bën për vete: *me fjalë të pushton*. Ky njeri i ri të cilin e pret Migjeni do ta sjell shpëtimin dhe do të: *krijojë një epope*, pra njeriu i ardhshëm i Migjenit, do ta zhdukë mënyrën tradicionale të jetës së vështirë që këndohej përmes lahutës. Edhe këtu poeti nuk ndalet me kaq, por është i brengosur edhe me fatin e kombeve tjera: *Të gjithë kombet po dehen në epope t'veta*. Si duket, të gjithëve u ka munguar një vështrim dhe qasje reale ndaj jetës, pra, ai do ta kthejë këtë njeri nga jeta e fantazisë së dehur e epopeve të lavdishme, në atë reale të kohës së re.

---

<sup>4</sup> Floresha Dado, Poetika, Tiranë 2003, fq. 295

„Të birtë e shekullit të ri” është po ashtu një poezi që bën pjesë në grupin e poezive të tij që janë shkruar nën ethet e rebelimit poetik. Migjeni, bashkë me shokët e gjeneratës së vet, që janë bijtë e një shekullit të ri, nuk i duan humbjet më. Për këtë ai është më tepër se optimist dhe i vendosur në ngadhënjimin mbi të keqen. Kjo e keqe, siç e konstaton poeti, nuk vjen nga një rreth i ngushtë njerëzish, që jetojnë në një vend e në një kohë të caktuar, por nga lojëra të fliqura që i kurdisin të tjerët, këto humbje vijnë nga: *Loja e përgjaktë e historisë njerzore*. Edhe këtu, siç vërehet, është i pranishëm dimension i autorit. Ky poet që i paraprin gjeneratës së këtij brezi, bashkë me to, do ngadhënjim, ndërgjegje dhe mendim të lirë. Të gjitha këto kategori termesh e kanë kuptimin e përgjithshëm, përveç atij individual. Ky njeri i ri me shokët e vet, pra Migjeni, dëshiron të jetë i pranishëm kudo në botë, në çdo mjedis, te çdo njeri dhe kështu duke i kaluar kufijtë e lokales dhe kombëtares, do të bëhet: *një thumb i ngulur ndër trutë e njerzisë*, për t'i ngacmuar vazhdimisht ata që të mos zhyten përsëri në pellgun e mjerimit dhe ta *vajtojnë prapë kangën e trishtimit*.

Në poezinë *Rezignata* që e trajton po ashtu mjerimin dhe kuptimin e jetës së kësaj qenie me: *vullnet të ndridhun*, për jetën që s'ka asnjëfarë kuptimi, e këtë jetë, vazhdon poeti, nuk e dëshiron askush në botë: *...se kjo botë e mbarrë / ndër gji t'Univerzumit është varr*.

Poezia, „Parathania e parathanieve” që e hap përmbledhjen poetike të Migjenit, në masë të madhe është e karakterit universal. Në temën që përmban dilemën e njeriut për ekzistimin e zotit dhe trajtën e tij: *mbi vjet dhe shekuj*, vërehet edhe dilema: *a asht zoti pjella e tij, / apo ai vetë pjella e zotit*. Megjithatë, Migjeni është i bindur se në këtë kohë të gjithë: *... njerëzit po kuptohen fare mire / për me ndërtue Kullën e Babilonit, / dhe në maje të Kullës, në majë të majës së fronit / ka me hyp njeriu / dhe ka me thirrë: / Perëndi! Ku je? Si duket, edhe këtu nuk mugeon përmasa globale e filozofisë së jetës dhe e ekzistimit në raport me perëndinë*.

Edhe tema e flamurit që në letërsinë tonë simbolizon kombin dhe vazhdimisht përshkruhej pamja e tij me fushën e kuqe dhe

shkabën e zezë dykrenore në mes, te Migjeni, është simbol i përgjithshëm që e udhëheq njerëzimin në luftë për jetë a vdekje. Te poezia „Vuajtja”, autori e parandjen se së shpejti do të bëhet si: *flamur i vjetruem / i rreckuem/ ndër luftat e jetës*, e kjo vërehet edhe te poezia „ Nën flamujt e melankolisë” , ku nën këtë simbol: *mund të shifet / një mund, një përpyekje / e madhe për mbi vdekje*.

### Përmbledhje

Migjeni, me jetë aq të shkurtër dhe vepër aq të madhe, e nxiti aq shumë mendimin kritik duke provokuar numër të madh studiuesish, që nga koha kur u botua vepra e tij e deri në ditët e sotme. Vlerësimet për veprën e tij ishin nga më të ndryshmet, nga ata që këtë krijues e vlerësonin vetëm si poet mjerimi, e deri te ata që hiqnin dorë nga ndonjë përfundim, që do ta shteronte mendimin e mëtejshëm të vlerësimit, nga ata që e quajtën paralajmëruesin më të madh të komunizmit, e të cilët “zbuluan”se disa poezi, siç janë: *Të lindet njeriu dhe Trajtat e mbinjeriut* ia paska kushtuar udhëheqjes së komunizmit që po lindte, deri te poeti pesimist, për të cilin jeta nuk kishte asnjë kuptim, përveç vuajtjes dhe mjerimit.

### Summary

Migjeni, with such a short life and such a great work, so much stimulated critical thinking, motivating a large number of researchers, from the time his work was published to this day. Appreciation for his work was varied, from those who regarded this creator only as a poet of misery, to those who abstained from any conclusion that would exhaust the further thought of appreciation by those who called him the propaganda maker of the Communists, who "discovered" that in some poems, such as: *Man's Birth and the Treats of him* were dedicated to the leadership of the emerging Communism to the pessimistic poet, for whom life had no meaning, besides suffering and misery.

### Literatura:

MIGJENI. Komplet i veprës së tij me studime nga shumë autorë.

QOSJA, Rexhep. Migjeni 4, Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni

BULO, Jorgo. Magjia dhe magjistarët,

ALIU, Ali. Migjeni 4, Rreh kritikës mbi veprën e Migjenit

DADO, Floresha. Teoria e veprës letrare

KADARE, Ismail. Migjeni ose Uragani i ndërprerë

**Mustafa IBRAHIMI**

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

Fakulteti i Shkencave Sociale

E-mail: [mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk](mailto:mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk)**ELEMENTE ETNOGRAFIKE DHE ARTI SHQIPTAR NË MURET E  
KISHAVE TË PRILEPIT DHE BALLKANIT NGA PIKTORI MESJETAR  
ONUFRI****ETHNOGRAPHIC ELEMENTS AND ALBANIAN ART ON THE WALLS  
OF PRILEP AND BALKAN CHURCHES OF MEDIEVAL PAINTER  
ONUFRI****Hyrje**

Arti i Onufrit shkëlqen në një kohë kur Evropa përjetonte epokën e shkëlqyer të Rilindjes. Trojet shqiptare nuk mbeten jashtë kësaj rilindjeje. Tradita e pikturimit të fasadës vazhdon dhe në monumentet e shekujve XVI-XVII. Edhe pse shumë mjeshtër shqiptarë, ishin të mbuluar me misteret e kohës, megjithatë ikonografia e shek. XVI arriti maja të papara artistike. Kur flitet për këtë shekull nënkuptojmë Onufrin, i cili shfaqet në trevat shqiptare si një meteor i rrallë e duke bërë më pas figura të shquar të ikonografisë bizantine, duke shënuar një kulminacion të vlerave artistike e fetare në të gjithë historinë e këtij vendi. Ndër më të shquarit ishin: Onufri, Nikolla i Onufrit, David Selenicasi, Konstatin Shpataraku, Konstatin e Athan Zografi, Joan e Gjergj Katro etj., veprat e të cilëve një kohë të gjatë kanë qenë anonime e me të edhe vetë autorët. Piktori i shquar shqiptar Onufri, ka jetuar në shekullin e XVI rreth viteve 1500-1570.

## Të dhënat për jetën e Onufrit

Të dhënat për jetën e Onufrit, janë shumë të pakta. Deri tash, asnjë burim i dokumentuar nuk jep të dhëna për vendin dhe datën e lindjes e të vdekjes së tij. Gjithashtu nuk kemi të dhëna për atë se ku dhe te cili mjeshtër, Onufri e ka fituar teknikën e pikturimit të afreskave dhe ikonave.

Të dhëna të rëndomta për biografinë e tij fitojmë nga disa mbishkrime autobiografike, të cilat i realizoi në disa kisha të Shqipërisë, Greqisë, si dhe në hapësirën e Maqedonisë. Këtu duhet të shtohen edhe mbishkrimet, gjegjësisht edhe pikturat ikonografike të gjetura edhe në rrethin e Prilepit.

Emri i Onufrit për herë të parë përmendet në mbishkrimin e kishës së Shën Kollit në Shelçan në Shpat të Elbasanit, ku thuhet: *“Kur të ngresh duart e tua ke Perëndia o meshtar i Perëndisë, më përmend edhe mua mëkatarin e të paditurin piktor Onufri”*. Në këtë mënyrë ai ka shprehur edhe modestinë e tij. Në një mbishkrim tjetër në Kishën e Paraskevi në Valsh të Elbasanit, gjejmë të njëjtin tekst, por me një shtesë *“më përmend edhe mua mëkatarin Onufri, kishtarin, piktorin dhe protopapa nga Neokastra (Elbasani)”*. Shkrimi tjetër nga kjo kishë, ka datën e pikturimit nga viti 1554. Ndërsa nga 6 afreskat e zbuluara në Kishën Shën Todori në Berat, mësojmë se ai ka qenë i martuar, se ka pasur fëmijë, ka qenë kishtar dhe se ka pasur titullin protopapë i Neokastrit (kryepriest – titull klerik që u jepej klerikëve me merita të mëdha intelektuale). Për një kohë të gjatë mendohej se Onufri ka prejardhje nga Neokastra (Elbasan), por nga një mbishkrim të tij, mësojmë se ai është i lindur në Berat. Së pari Onufri nënshkruhet si piktor pa titull dhe aspak nuk përmend se vjen nga Neokastra. Emrin e tij e përmend vetëm në Valsh, ku duhej të tregonte përkatësinë e tij si protopapë. Po ashtu nga shkrimet e shumta në Shpat, është edhe një ku shkruan *“Ju nga Neokastra, të gjithë sa jeni, luteni...”*. Nga këtu nënkuptojmë se ai nuk ka qenë elbasanas.

## Rreth prejardhjes së emrit

Emri i Onufrit rrjedh nga një emër i shenjtë me burim nga Lindja, që në veti përmban më shumë kuptime. Me fjalën Nofir, egjiptasit e vjetër kanë nënkuptuar *të mirën, ajo që është e rëndësishme, duke mos patur fjalë të veçanta*. Kisha Shën Onufri (emër i një eremiti egjiptas nga shek. IV) e feston datën 12 qershor. Datë kjo, që sipas traditës, krishterët i kanë pagëzuar fëmijët e tyre me emra të shenjtë sipas muajve të lindjes. Mund të konkludojmë se piktori Onufri mund të jetë i lindur në muajin maj ose qershor, diku në fund të shek. XV dhe fillim të shek. XVI.

## Opusi krijues i Onufrit

Për herë të parë emri i Onufrit do të përmendet nga studiuesja Vitori Puzanova (me origjine ruse e cila punonte e studionte në Shqipëri), në artikullin e saj *“Piktori shqiptar i shek te XVI, Onufri nga Neokastra (Elbasan)”*, të shkruar në vitin 1953, Mbishkrimi u zbulua nga ekspedita e Muzeumit Arkelogjik –Etnografik në tetor të vitit 1951. Për aktivitetin e Onufrit do të shkruajnë edhe studiues tjerë, si: Popa, Drakoupulo, Jakumis, Arapi, Babiç, Garidhis, Gounaris, Buschausen, Valentini etj.).

Deri para botimit të përmbledhjes me studime: *“Prilep i Prilepsko niz istorijata I*, Prilep 1971, (188-192), ishte i panjohur programi ikonografik i kishës së “Shën Shpërfytyrimit” dhe i kishës së Shën Nikollës në manastirin e Zërzës të Prilepit. Me këtë botim për herë të parë do të dalin nga anonimiteti afreskat dhe ikonat mirë të ruajtura të piktorit shqiptar Onufër Neokastritit, i cili për 5 vjet rresht (1535-1540) do të ndodhet në Prilep, saktësisht në dy objektet fetare kishtarë në fshatin Zërzë. Kjo periudhë është momenti jetësor i tij, sepse brenda një harku kohor prej 19 vjetësh (1535-1554), pra në gjysmën e dytë të shek. XVI, piktura shqiptare përtërihet dhe arrin një nivel të shkëlqyer si në ikonografi ashtu edhe afreskografi, falë opusit madhështor të Onufër Neokastritit.

Veprimtarinë e tij artistike, Onufri e zhvilloi kryesisht në këto kisha dhe manastire: Më 1535 Onufri pikturoi muret e manastirit “Shën Shpërfytyrimi” dhe kishës “Shën Nikolla” në fshatin e Zërzes të Prilepit (1535, Maqedoni). Mendohet se në kishën Shën Teodori në Berat, ka pikturuar para vitit 1547. Në vitin 1547 ka pikturuar edhe në kishën Shën Apostoli në Kastori të Greqisë Veriore. Pas Kastorisë pikturoi edhe në kishën Shën Kolli në Shelçan (Shqipëria e Mesme). Në vitin 1554, pikturoi në kishën e Anargjirëve në Kostur, afresket e kishës së “Shën Koll” në Shelçan të Elbasanit, afresket e kishës së “Shën Todhrit” në kalanë e Beratit, afresket e kishës së “Shën Premtes” në Valësh të Elbasanit. Gjatë kësaj periudhe ka pikturuar edhe dy ikonat “Mëria me Krishtin fëmijë” dhe “Krishti, në kishën e fshatit Toplicë të Manastirit, pastaj në Kërçovë, në manastirin Moldovitsa në Moldavi, si dhe shumë ikona për ikonostaset e kishave, të cilat i atribuohen atij.


### **Pikturat në fshatin Zërze të Prilepit**

Rreth 35 km në veriperëndim të Prilepit, vetëm 2 km larg fshatit shqiptar Cërnilishtë, ndodhet fshati Zërze, ku gjenden dy objekte fetare kishtarë: manastiri mesjetar “Shën Shpërfytyrimi” (Свѣти Преображение) dhe kisha “Shën Koll (Свѣти Никола). Këto dy objekte, me pozicionin e ndërtuar, lashtësinë dhe pasurinë ikonografike, ku dominojnë afreskat mesjetare, paraqesin një pasuri të rrallë, jo vetëm për artin shqiptar por edhe atë ballkanik. Themi kështu sepse, gjatë periudhës bizantine 1100 vjeçare, një numër i madh piktorësh afreskografë dhe ikonografë shqiptarë, kanë ushtruar një veprimtari vëllimore dhe të rëndësishme në shumë faltore dhe manastire, jo vetëm të viseve shqiptare por edhe ballkanike.

Vite të tëra, edhe afreskat e Onufrit në manastirin dhe kishën e fshatit Zërze, kishin qenë larg këtij përkujdesi të rëndësishëm. Ikonografët maqedonas nuk kanë ditur për kohën dhe autorin e këtyre tërësive pikturale. Por, duke iu falemnderuar studimeve ikonografike nga historianët shqiptarë të arteve, sot jemi në gjendje

të mësojmë shumë më tepër për këto afreska që i posedojnë këta dy objekte kishtarë, ku si autor i disa prej tyre na del edhe Onufri shqiptar, piktor mesjetar dhe person kishtar mjaft i zgjuar në atë kohë, i cili pikturën me siguri e ka mësuar në Venedik. Këtë e dëshmojnë edhe disa piktura në pjesën lindore të manastirit, që janë krijuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XV, e që përmbajnë të gjitha karakteristikat e një kombinimi modern të elementeve italo-bizantine, përgatitur në Itali.

### **Programi ikonografik i manastirit mesjetar “Shën**



### **Shpërftyrimi” në Zërze të Prilepit**

Manastiri gjendet në anën perëndimore përmbi fshatin Zërze, dhe për të arritur deri aty duhet të udhëtosh 30 minuta në këmbë. Vetë objekti është i vendosur në një pozitë të tillë, që pothuaj dominon në rrethin e tij, dhe ofron pejsazhe të rralla dhe të bukura malore. Në të hyrë të bie në sy konaku dhe disa objekte të vogla, që janë ngritur diku më vonë. Dikur ky objekt ka pasur një hapësirë të

madhe, duke përfshirë 8 mijë metra katrorë. Siç bëjnë të ditur disa shkrime, në shekullin e mesëm ky objekt ka qenë i mbuluar me një kompleks interesant ndërtimor. Sot, nga ai kompleks, gjurmë shihen vetëm në themelet.

Historiku i manastirit dhe vlerat e tij të tashme, nismën e kanë diku në mesin e shekullit XIV, saktësisht i ndërtuar në vitin 1400 nga igumeni Germanoi, është pikturuar nga Onufri dhe përfaqëson një kundërvënie të vendosur teologjike nëpërmjet subjekteve dhe temave ikonografike kundër herezive në kishën lindore, madje ky manastir përfaqëson një pozitë zotëruese të ortodoksisë bizantine dhe pasbizantine ndaj herezisë së bogomilizmit, që është e ka zanafillën nga fshati Bogomil, jo shumë larg nga fshati Zërze, në kretj Ballkanin. (Zeqo 2019)

Sipas disa traditave të kultit, ky vend daton që nga shek.V ose VI i erës sonë. Shkatërrimet e shumta që janë bërë gjatë kohës, kanë mundësuar që të merren disa rindërtime. Sipas disa shkrimeve rreth viteve 1400, njihemi me disa të dhëna interesante për historikun e këtij manastiri. Në to theksohet se pikturat e vitit 1369 janë përfshirë në tri zona: atë veriore, jugore dhe lindore, që edhe sot rruhen. Në zonën e parë të murit verior, nga perëndimi kah lindja përfshihen figurat e shenjtarëve, si: Shën Merkuri, Shën Dimitri, Shën Gjergji etj., afër ikonostasit gjendet kompozicioni i Deizisit.

Në zonën e dytë përfshihen personat e shenjtorëve në medaljone, si: Shën Anastasi Persiku, Shën Aleksi, Shën Viktori, Shën Viktia etj. Ndërsa në zonën e tretë përfshihen skenat e festave të mëdha, nga Dhiata e Vjetër dhe të Re, si: Vajtimi për Krishtin, Zbritja në Ad, Noli me tangere, Skena e Pagëzimit etj.

Përhapja e ikonografisë së Trinisë e tipologjisë me një portret me tri fytyra, e cila gjeti vend në Firencen humaniste, rrezatoi tek arti dhe krijimtaria e Onufrit, ndonëse ishte një zbatues i përpiktë i ikonografisë kishtarë të lindjes. Ai ndikohet nga fryma e re artistike perëndimore, gjë që reflektohet më pas në korpusin artistik të të gjithë ateliesë së Beratit. Gjatë shekujve që do të pasonin, arti i Onufrit do të kthehej në model për t'u ndjekur nga ikonografët pasardhës.

Onufri ka ndjekur në idenë e konceptin artistik e Trinisë, mjeshtrit fiorentinë të shekujve XV-XVI, gjë që tregon ndikimin e tij nga arti i Firences rilindëse. Kjo shihet te afreska *“Trinia e Shenjtë me tri fytyra”* e pikturuar nga Onufri në murin verior të Kishës së Shpërfytyrimit, në manastirin Zërze (1535, Prilep), shkruhet te medaljonet “ΗΑΥΙΑ” dhe “ΤΡΙΆΣ” – Trinia e Shenjtë), kurse rreth portretit me tri fytyra kemi “ΟΩΝ” – Ai që është”.

Në afresket e manastirit “Shën Shpërfytyrimi” në fshatin Zërzës të Prilepit, gjejmë datimin e parë për datëlindjen, lënë prej tij në murin jugor midis skenës “Kostandini dhe Elena dhe strategëve Tironi dhe Stratillati”. Mendohet se Onufri mund të këtë lindur në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të XVI. Kur realizoi këtë pikturë Onufri mund të ketë qene rreth të dyzetave, në një moshë të favorshme për një formim profesional artistik. Fatkeqësisht leximi i këtij mbishkrimi , pothuajse është i palexueshëm.

### **Afreskat në kishën “Shën Koll” të Zërzës së Prilepit**

Kisha fshatare “Shën Nikolla” në fshatin Zërze është një ndërtim i vogël, hapësira e brendshme e të cilit është rreth 4 metra dhe gjerësia 2,47 m. Kjo kishë për herë të parë përmendet në dokumentet turke të vitit 1481/1482.

Rëndësi më të madhe për pikturat afreskografike në këtë kishë, në kompleksin e parë ka Zografi Jovan, ndërsa Onufri në kompleksin e dytë. Në këtë kompleks, Onufri ka pikturuar në vitin 1535, ku pas vetes ka lënë afreskat: Afreska Dezis, detaj nga Shën Mëria, Shën Nikolla, Shën Merkuri dhe Shën Dimitri, detaj nga akti i Deizisit etj. Vlen të përmendet se të gjitha signaturat nga këto afreksa janë të shënuara në gjuhën greke. Po në Prilep, pranë kishës “Shpërfytyrimi” , pikturoi për ikonostasin e kishës “ Shen Nikolla”, baldakinin (pano e madhe me skenën “Deisis” (lutja ) dhe me 12 shenjtorët). Poshtë mbrapa këmbëve të Shën Mërisë është vënë mbishkrimi që mban vitin 1535.

Në këtë hark kohor, që nga viti 1535 (datë e lënë në afreskët e kishës në Prilep) e deri në 1554 ( e lënë në kishën e Valshit) është një

periudhë veprimtarie e shkurtër por më prodhimtare të bollshme e me shumë vlera . Gjatë kësaj periudhe , prej dorës së tij , sot trashëgojmë një seri të madhe ikonash të cilat ai i realizoi për ikonostaset e kishave. Pra Onufri ishte mjeshtër i pikturës së teknikes së afreskut , por edhe mjeshtër i madh i pikturës së kavaletit dhe atë të ikonave.

Dike u nisur nga mbishkrimet, përjashtuar atë të Prilepit ku ne sot nuk mund të lexojmë mbishkrimin , për arsye se duhet pune restauruese dhe për te marre informacion mbi statusin dhe emrin e tij , përveç vitit 1535 qe e ka lene ne baldakinin e kishes se Shen Kollit, Prilep. Nga mbishkrimi i parë, ku Onufri e shënon veten prift e protopapë të Elbasanit, në kishën e Shën Apostujve në Kostur, e duke marrë për bazë studimin e Bosko Babiç për kishat e Onufrit në Prilep, mund të jetë një hipotezë se kisha e Shën Kollit në Shelcan të jetë pikturuar gjatë periudhës 1535-1547 (Babiç 1980).

Sipas Garidhit, në skenën “Vajtimi” në kishën e Shën Apostujve, në Prilep, Shën Mëria në ndryshim nga skena ikonografike bizantine nuk ulet të vajtojë pranë varrit të Krishtit, por e mban në duar trupin e djalit të saj, gjë e cila vjen si një ndikim nga piktorët italianë. (shih: Γαριδης Μ. Μεταβυζαντινη Ζωγραφικη (1450-1600). “Ο ζωγραφος Ονουφριος και η σχολη του Βερατιου”, 2007.) Kjo skenë ngjason me skenat e piktorëve të rilindjes së hershme, si Giotto apo dhe me piktorë të tjerë të vonë të rilindjes italiane dhe asaj të Europës veriore.

### **Elemente etnografikë dhe arti shqiptar në afreskat e Onufrit**

Risi e rëndësishme në opusin e Onufrit janë motivet e frymëzimeve të tij për afreska dhe ikona, të cilat i merrte nga ambienti dhe njerëzit që e rrethonin, duke u veshur rroba të hierarkisë kishtarë. Pra, ai bën një kthesë drejt artit me nota realiste, siç janë p.sh. portreti i Profetit David, që sipas studiuesve shqiptarë, frymëzimin për këtë portret duhet ta ketë mbështetur në personalitetin e kryetrimit shqiptar Gjergj Kastriot-Skënderbeu.



Një risi tjetër më reale paraqitet edhe në ikonën “Lindja e Krishtit” pikturuar në muret e “Kishës së Beratit, ku figurën e bariut e merr nga bota reale. Janë këta barinj, të cilët Onufri i pikturon me veshje karakteristike vendase, të përbëra prej lëkure dhensh, me çorapë apo çizme shajaku deri në nyje të këmbës, të mbështetur mbi kërrabë. Në brez mbajnë kungull uji. Flokët e mjekrën i kanë të gjata me kapelë karakteristike (të bardhë e të kuqe) në kokë.

Kjo kapelë, një lloj kësule për burra, shumë e lartë dhe me strehë rretheqark, është përdorur në Shqipëri nga shtresa të ndryshme shoqërore. Në shek. XVI-XVII, kjo kapelë u bë e njohur dhe modë në Francë dhe Evropën Perëndimore, e cila thirrej “*chapeau albanois*”, apo thjesht “*albanois*”. Shkrimtari frëng F.Rabelais, në veprën e tij “*Gargantua et Pantagruel*”, përdor termin “*Chapeau albanois*” (kapelë shqiptare). Këtë kapelë e shohim edhe te figura e bariut në disa vepra të Onufrit, si p.sh.: në afreskën “Lindja e Krishtit” në kishën e Ungjillëzimit të Beratit, me përmasa 50-30 cm, si dhe në kishën e Valëshit, ku këtë figurë e pikturon në teknikun e afreskut.

Me anë të stratiotëve shqiptarë, të cilët i përmend edhe Engelsi për vetitë e tyre luftarak në tërë Evropën, u ruajtën në dhe të huaj për një kohë edhe veshjet shqiptare. Në veshjet e stratiotëve dominonte e kuqja, aq sa historiani francez Filip De Komini, i shekullit XVI-të, në linin e tij “*Memories*”, e krahason fushën e betejës me stratiotët shqiptarë “si fushë e mbushur me lulëkuqe”. Natyrisht, se është kuptimplotë të mendohet, se nga tërë detajet e atmosfera e

mësipërme Onufri ynë ka huazuar diçka, që ka reflektuar në spektrin e ngjyrave të tij.

Pra, Onufri pikturon gjithnjë i frymëzuar, me tendencë evidente që porosive të tij puikturale biblike t'u japë një ngjyrë me veçori



autentike. Këto i dëshmojnë elementet e kulturës popullore si shamitë, kësulatat, enët për ngrënie, ibrikët apo shportat, kërrabat, sëpatat, kostumet popullore të kohës, pastaj arkitektura vendase, shkëmbinjtë e thepisur shqiptarë.

### **Misteri i termit “e kuqja e Onufrit”**

Në etnografinë shqiptare, qoftë mesjetare, qoftë më të hershme e kuqja është ngjyra e preferuar, kryesore. Në pikturën bizantine të stilit të paleologëve e kuqja vihej në dukje, mes gamës koloristike në përgjithësi, po tek Onufri e kuqja, pa u bërë qëllim në vetvete e spekulim pikturim, luan rol të dukshëm e harmonizim të veçantë, duke e bërë atë një nga koloristët e mëdhenj shqiptarë të shekujve.

Përdorimi i termit “e kuqja e Onufrit” u përdor për herë të parë nga studiuesi famshëm Andrea Grabar, i cili u gjend përballë veprave të Onufrit në një pavijon të artit shqiptar, të ekspozuar në Paris më 1976. Ai ishte sekreti teknologjik, sekreti i bukurisë impresionuese. Sa do të çuditëni po të mësoni se e gjitha kjo ishte një truk. Analizat treguan se e kuqja e Onufrit është sulfuri i zhivës, i përdorur nga të gjithë piktorët evropiane të asaj kohe”. Por Onufri

dhe shumë piktorë të tjerë , shkëlqimin e të kuqes e kanë realizuar duke e vendosur të kuqen mbi një shtresë të lyer me të bardhë ose mbi shtresën e arit.

Në kolorit është mjaft i matur dhe subtil. Për realizimin e fytyrave të inkarnuara shfrytëzon ngjyrën e okerit, e cila në momente paraqitet si ngjyrë e ndritshme. Shenjtorët e tij janë mjaft elegantë, shumica prej tyre, sipas pamjes, gjestit dhe qëndrimit janë mjaft të feminizuar. Kuptohet aty janë edhe personazhet nga rrethi i tij. Ata persona nuk janë të mbartur vetëm në mënyrë rutinore, por në një mënyrë edhe përjetohen, ndërsa në personazhet femërore, sensualiteti është më se i pranishëm.

### **Përfundimi**

Onufri është piktori dhe ikonografi më i shquar dhe gjenial shqiptar i shekullit XVI dhe njëri nga më të mëdhenjtë në përgjithësi. Veprat e tij u bënë të njohura diku nga mesi i viteve 50, deri më atëherë nuk kishin ditur se në të kaluarën patëm një piktor të tillë të madh, të cilin e cilësuan si “të kuq shqiptar”, duke i kaluar kufijtë e sotshëm kombëtarë.

Mjeshtërinë e tij ikonografike dhe freskografike e ka mësuar në qendrën e madhe, atje ku përzihen kulturat e Lindjes dhe Perëndimit. Megjithatë stili i Onufrit dallohet shumë nga stile e deriatëherëshme, dhe sa dimë ne, ai ka mbetur piktori më origjinal i kohës së tij.

Piktori Onufër, në shekullin XVI zgjodhi lëvizshmërinë, odiseadën e tij të pikturimit të kishave në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe në kisha tjera të Ballkanit, duke pikturuar sipas stilit paleolog bizantin, ndonëse me një art dhe mjeshtëri të habitshme.

Në përgjithësi të gjitha pikturat ikonografike, të mjeshtër Onufri në manastirin dhe kishën e Zërzes, janë vizatime solide, të prira për përshkrime nga jeta e përditshme, ndërtimi minucioz i detajeve, nënvizimi elegant dhe përjetimi i brendshëm i pikturave afreskografike.

Madhështia e këtij autori s’do koment, pasi ai në të vërtetë ishte aq i madh, sa që mund të krahasohet në krah edhe me një

Rublov e Theofan. Onufri ishte dhe ngeli piktori i rrallë të cilit i shkonte për dore që vizionet e veta pikturale t'i realizonte me sukses të njëjtë si në teknikën e pikturës murale, ashtu edhe në atë të tablove ikonografike.

### Summary

*In the half of the 16-th century, the Albanian painting renovates and reaches a high scale in the aspect of fresco iconography, which is very noticeable at the great Onufri's opus. His artistic activities he mainly performed in these monasteries: in 1535 he painted in the monastery and in the church of the village Zërze, at the same time he realized the act of Deizis in the church of Shën Koll (St. Nicole). It is thought that before 1547 he painted in the church of Shën Teodor (St. Theodore) in Berat. Equally, in the same years he made portrayals in the Kastorian church of Shën Apostolic in northern Greece. Hereafter, the maestro of the Albanian art made some pictures in Shelqan's church Shën Koll (central Albania). And in 1554 performed his very best skills in the church of Shën Paraskevi in Vallsh- (central Albania as well).*

*Not only this, Onufri was well known of his great other similar performances of art. Many of the icons he painted, today are safeguarded and placed in the church of Berat and in the ethnologic and archeological museum of Tirana.*

*With years, the frescoes of Onufri in the monastery and in the church of the village Zërze had not been safeguarded, as they deserve to be. The Macedonian iconographers have not known about the time and about the author of these paintings. But, thanks to the iconographic studies made by the Albanian historians of arts, today we are able to learn much more about these frescoes possessed by the two ecclesiastical buildings, where as an author of some of the frescoes appears to be the Albanian Onufri.*

## LITERATURA

- ANDREA, Fotaq. (2009). *Le haut chapeau albanois du Moyen Âge*. Studia Albanica 2009 - 1,2
- ARAPI, Mustafa (2018). *Onufri dhe misteret e tij*. <https://www.shqiperia.com/blog/onufri-dhe-misteret-e-tij/> 15 dhjetor 2018
- БАБИЋ, Бошко. (1980). *Фреско - живопис сликара онурфија на зидовима цркава прилепског краја*. Матица српска. Београд 1980)
- DHAMO, Dhorka. (1976). "*Elementet etnografike në pikturën mesjetare të Onufrit e Nikollës*" Tiranë 1976.
- DHAMO, Dhorka. (1980). "*Onufri figure e shquar e artit mesjetar shqiptar*" Tiranë 1980,
- IBRAHIMI, Mustafa. (1998). *Afreskat e Onufrit në muret e kishave të f.Zërze të rrethit të Prilepit*. Në gazetën "FAKTI" 31.12.1998. f. 14-15.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2002). *Onufri – mjeshtër i madh ballkanas*. Në revistën "Zëri i Pelagonisë", nr.7-8/ nëntor-dhjetor, Shkup 2002, f.14-17.
- POPA, Theofan. (1966). *Të dhënat e reja rreth piktorit Onufri*. "Studime historike", Tiranë 1966. "*Onufri, ikonograf i shquar shqiptar*" dhe "*Onufri, piktor i madh shqiptar i shekullit të XVI*".
- PUZANOVA, Vitori (1953). "*Piktori shqiptar i shek te XVI, Onufri nga Neokastra (Elbasan)*".
- POPA, Theofan, *Piktorët mesjetarë shqiptarë*, Tirana 1961, 37-62; Ibid., *Onufre une figure éminente de la peinture medieval albanaise*, Studia Albanica 1 (1966) 291-303;
- PUZANOVA B. - Damo, Dh. *O tvorestve albanskogo srednevekovogo hudoznika Onufrie*, Studia Albanica 1 (1996) 281-290;
- Прилеп и Прилепско низ историјата I. Прилеп 1971, (188-192),
- ROÇI, Holta & ARAPI, Dorina (2016). *Onufri, Firenze dhe tema ikonografike e Trinisë së Shenjtë me tri fytyra*/ <https://www.gazeta-shqip.com/13 Shkurt 2016>
- SARAÇI, Alvin (2009). *Famous Albanians in Venice: Karl Gega, Architect of the Austro-Hungarian Empire*. Studia Albanica 2009 - 1,2.
- STAMATI, Frederik. (2009). *E kuqja e Onufrit*. Në "Gazeten Shqiptare" e dates 13 dhjetor 2009.
- ZEQO, Moikom, *Hulumtimet e fundit mbi Opusin onufrian*. [Kurt Farka](https://www.gazeta-shqip.com/13 Shkurt 2016), 22,04. 2019.
- НИКОЛОВСКИ Д., *Царските двери од црквата Св. Никола Св. Никола во село Зрзе – Прилеп, Патримониум.мкЗ-4*, 5-6 (2008=2009) Скопје, 2009, 139 – 150;



**Sunaj RAIMI**

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup  
Fakulteti i Shkencave Sociale  
E-mail: [sunaj.raimi@unt.edu.mk](mailto:sunaj.raimi@unt.edu.mk)

**JAN KUKUZELI – KOMPOZITORI SHQIPTAR MESJETAR ME  
DIMENSIONE BOTËRORE****JAN KUKUZELI - MEDIEVAL ALBANIAN COMPOSER WITH WORLD  
DIMENSIONS**

Kur flitet për Jan Kukuzelin, gjithmonë duhet patur parasysh faktin se lindja, jeta dhe veprimtaria e tij është e lidhur me Perandorinë Romake Lindore – Bizantin. E për ta kuptuar mirë e drejtë jetën dhe veprimtarinë e Jan Kukuzelit, me doemos duhet të merren parasysh edhe rrethanat shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore të asaj kohe në këtë Perandori të lavdishme. Bazuar në burimet e ndryshme historiografike, Perandoria Romake Lindore – Bizanti (Byzantium) u krijua si pasojë e kontradiktave, përçarjeve dhe problemeve të shumta që ekzistonin në Perandorinë Romake të atëhershme, të cilat lidheshin me dyndjet e fiseve barbare, vizigote dhe vandale, që vazhdimisht i sulmonin territoret e atëhershme romake. Duke u munduar t’i ikë këtyre kontradiktave dhe telasheve, Perandori (Vasileus) i atëhershëm Konstantini i Madh, që siç dihet kishte prejardhje ilire, rreth vitit 330 në themelet e qytetit të vjetër Byzantion, fillon ta ndërtojë një qytet të ri të cilin e quajti Konstantinopolis, që d.t.thoshte ‘Qyteti i Konstantinit’. Disa shekuj më vonë (v.1453) ky qytet do të pushtohet nga osmanët, duke u quajtur Istanbul. Konstantinopolisi, i cili si qytet u ndërtua në brigjet

e dy kontinenteve: atij europian dhe aziatik, përveç se u bë kryeqendër e një Perandorie të fuqishme, ajo shumë shpejtë u bë edhe epiqendër botërore e tregëtisë, kulturës, filozofisë, shkencës, artit, letërsisë e teologjisë. Në këtë qytet atëbotë prodhoheshin enët më të bukura nga qelqi, stolitë e rralla nga ari, mëndafshi dhe pëlhurat më luksoze si dhe mëlmesat më ekzotike të sjellura nga lindja e mesme dhe e largët. Vetë Bizanti si Perandori, themelet e civilizimit të tij i kishte vendosur në tri shtylla kryesore: rregullimin qytetar romak, trashëgiminë kulturore helene dhe monoteizmin krishter. Por, në këtë qytet u zhvillua edhe një muzikë e veçantë shpirtërore a capella, e cila i dedikohet jetës kishtare ortodokse. Njeriu që dha kontributin më të madh për kompozimin, zhvillimin dhe popullarizimin e kësaj muzike kishtare, padyshim ishte durrësaku Jan Kukuzeli, i cili mu për këto arsye më vonë do të shpallet si i Shenjtë!

Të dhënat biografike më të hershme për Jan Kukuzelin, megjithëse jo fortë të sistemuara, janë të paraqitura në fragmente të ndryshme në Kodikun nr. 46, në Manastirin e Vladhatonit, në Selanik, shkruar nga një autor anonim, jo shumë i arsimuar, me prejardhje sllave. Ky njeri entuziast kishte arritur të mbledhte shumë gojëdhëna dhe kujtime të kohës së tij për Shën Jan Kukuzelin. Në këtë dokument, përshkruhet jeta e tij fëmijërore, vitet e shkollës në vendlindje, jeta në Pallatin Mbretëror në Kostantinopojë. Më pastaj përmendet edhe largimi i tij misterioz prej Pallatit dhe përqaftimi i jetës oshënare në Manastirin e “Lavrës së Madhe”, në Malin e Shenjtë, ku në mënyrë eksplicite theksohet atdheu i Kukuzelit - Durrësi (*Kodiku Vladhaton, Sinaksari 2, nr. 46, Lavra e Madhe L-146, 1550*). Më vonë, për shkak të kontributit të jashtëzakonshëm të Jan Kukuzelit për muzikën psalmike bizantine, Kisha Ortodokse atë e shpall ‘Shenjtor’ (‘Agjios’), me çka sipas traditave kanonike krishtere është dashur t’i thurret edhe biografia zyrtare (‘Vita’), e cila do të ruhej në Arkivin klerikal të Manastirit.

Për sa i përket vendlindjes së Jan Kukuzelit, këtij personaliteti të spikatur të kulturës muzikore mesjetare, përveç librave të shumtë, flasin edhe burime tjera kredibile shkencore si Enciklopedia

Britanica, Enciklopedia e Larousse, Wikipedia etj. Tek të gjitha këto qartazi nënvizohet se ai kishte lindur në Durrës, apo se rridhte nga një familje qytetare durrsake, e cila jetonte dhe punonte në Durrës. Megjithëse datëlindja e Janit nuk dihet sigurtë, disa autorë mendojnë se ai ka lindur diku rreth viteve 1075. Mendim të ngjashëm ka edhe muzikologu shqiptar Ramadan Sokoli, i cili duke folur për figurën e Jan Kukuzelit, shkruan se ditëlindja e tij duhet të jetë diku në mes të viteve 1070-1075, (*Sokoli, 1963 : 5*). Mirëpo, pjesa më e madhe e studimeve të bazuara në burimet kishtare, por edhe në disa Enciklopedi me renome shkencore, periudhën e jetës së Kukuzelit e kanë përcaktuar rreth viteve 1280 – 1370 (*Shih te Wikipedia: Shën Jan Kukuzeli*).

Sipas burimeve kishtare, Jan Kukuzeli në moshën e tij të vogël kishte mbetur pa baba, andaj dhe përkujdesjen dhe edukimin e tij përsipër e mori nëna e tij, e cila njëherit u kujdes edhe për arsimimin e tij, duke e dërguar për mësim tek disa mësues të njohur të asaj kohe. Derisa Jani ndiqte shkollën në Durrës, mësuesit e tij ia hetuan prirjen e rrallë për muzikë dhe zërin e bukur tingëllues, andaj dhe e dërguan atë për studime në Shkollën imperiale të Konstantinopojës, me harxhime të kishës bizantine. Pas kësaj, merret vesh se si Jan Kukuzeli në Shkollën e oborrit mbretëror të Kostantinopojës do të shquhet me zgjuarsinë për mësim dhe talentin e tij për këndim dhe kompozim. Duke marr pjesë në mesha dhe korrin fetar të kishës bizantine, oborrtarët mbretëror menjëherë e dalluan zërin e tij të mëndafshhtë, duke i sugjeruar autoritetet perandorake që këtë rinosh menjëherë ta vendosin në rolin e korifeut të Korrit Perandorak. Pas vetëm disa prezantimeve që pati në publik, Jan Kukuzeli arriti ta fitojë nofkën ‘zëngjullori, angelofonos’, të cilin kualifikim e mbajti gjatë tërë jetës së tij. Sipas disa gojëdhënave, derisa Jan Kukuzeli jetonte dhe vepronte në Konstantinopolis, shumë herë kishte kënduar këngë liturgjike edhe në Kishën e famshme Shën Sofia (Aya Sofia), me ç’rast nga dridhjet magjepsëse të zërit të tij engjëllor, njerëzit që e dëgjonin fillonin të qanin nga kënaqësia dhe mahnitja.

Me kalimin e kohës, Jani u emërua si ‘Magister Musica’, apo Mjeshtër muzike në Pallatin bizantin, duke u ngarkuar me detyrën e

mbajtjes së ligjëratave dhe mësimi praktik për të gjithë ata entuziastë që dëshironin ta studionin muzikën bizantine, e në veçanti për ata që adhuronin të këndonin këngë kishtare. Më vonë, pas disa vitesh pune dhe studim të palodhur, Jan Kukuzeli arrin ta përpilojë sistemin e një shkrimi muzikor të quajtur ‘notacioni kukuzelik’, i cili nënkuptonte një alfabet muzikor më të pasur se ai që ekzistonte deri në atë kohë. Vlen të theksohet se ky sistem i notacionit muzikor të Kukuzelit, me shekuj ishte bërë standard për muzikën kishtare të mbarë krishterimit ortodoks. Me këto vepra, Jan Kukuzeli kishte arritur të realizonte një reformë të vërtetë në shkencën muzikore, sepse përveç që i përcaktoi dallimet në mes të zërave autentik dhe atyre plagalik, ky melurg (kompozitor) kishte mundësuar edhe reduktimin e semiografisë muzikore, me çka i kishte eliminuar gabimet eventuale në leximin e pentagrameve muzikore të atëhershme. Përveç kësaj, Kukuzeli kishte krijuar “sistemin e rrathëve muzikorë”, me anën e të cilit ishte stabilizuar raporti ndërmjet katër tingujve kryesorë të muzikës bizantine. Kukuzeli ka kompozuar shumë hymne bizantine, polieleje, qeruvikë etj, duke vënë në përdorim ison e këngës paqadike. Nga këto arsye, emri i Jan Kukuzelit në analet e historisë së muzikës mbeti i shkruar si reformator, kompozitor, pedagog, poet dhe himnograf, sepse gjatë karrierës së tij ai arriti të shkruante disa vepra muzikore të rëndësishme për esencën e artit muzikor, leximin notal dhe rolin e muzikës në jetën sociale e religjioze të njeriut. Siç përmendëm edhe më herët, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e artit muzikor bizantin, Patriarku Kukuzelin e shpall si “Agjios”, që d.t.thotë ‘Shenjtör’. Ndërkaq, sipas rregullave klerikale të Kishës Ortodokse, për çdo “të shenjtëruar” doemos duhet të përpilohet një Biografi që ndryshe quhet “Vita”, e cila nënkupton përmbledhjen në vargje të tërë jetës dhe veprimtarisë të atij njeriu të shenjtëruar.

Në opusin e veprimtarisë muzikore të Kukuzelit, si më të njohura konsiderohen këto vepra: a) *Shërbesa të përditshme*: - Mbrëmësore: “Me të hapur dorën...” (tek Psalmi 103 [104]; “Lum njeriu...” (Ps. 1, 2, 3); Vargje kalifonike; Tinguj që psalen në Hyrjen e Mbrëmësores; Paravargje tingullit Tërthor II, Tërthor IV. - Mëngjesore: Polieleje

“Shërbëtorë të Zotit...”, “Lavdëroni Zotin...”; Vargje kalifonike; Andifone; “Çdo frymë le të lavdërojë Zotin...” tingulli I dhe Tërthor IV; Madhështime, tingulli IV; Psalmi 118 [119]. - Liturgji Hyjnore: Himnin Trishenjtor “Shenjt Perëndi...” tingull II; “Alilua” tingulli Tërthor I, “Alilua” të kremteve të mëdha; Himne Qeruvike: “Ne që simbolizojmë...” tingulli Tërthor II, “Tani fuqitë...” tingulli Tërthor II; “Të meriton me të vërtetë...” tingulli Tërthor II; Madhështime në të kremte të mëdha; Kungatore: “Lavdëroni Zotin...” tingulli Tërthor I, “Shijoni dhe shihni...” tingulli Tërthor I.

b) *Shtëpitë e himnit akathist (gjatë pashkës)*: “Përlufteshës gjenerale...”, “Fuqia e të Lartit...”, “Engjëlli u dërgua...” etj.

c) *Mësime muzikore*: “Që lartazi profetët...” tingulli i Rëndë dhe Tërthor II; Mësime vargësh; Fjalët e para të tropareve Përshëmbëllta dhe të Njzëshme; Mbi 40 mësime në vargje 15-rrokëshe etj.

ç) *Mbajtja iso (shoqërimi me iso)*: Mbajtje iso në 8 tinguj, ku disa kanë edhe emërtime karakteristike.

d) *Metoda të të psalurit (mënyrës së të kënduarit)*: Metoda e vendosjes së shenjave muzikore bizantine: Mega Ison, Ison, Oligon, Oksia; Metoda e Mbajtjes iso; Këndimi i shenjave muzikore, pa tekst, që quhet “Këndimi i urtë i shenjave” njihet si “Sistemi rrethor i Kukuzelit (Trohója)”. Vlen të ceket se veprat e tij muzikore dhe dorëshkrimet e ndryshme, gjenden të shkruara në greqisht diku deri në shek. XVI, mirëpo ka edhe disa kodikë të mëvonshëm jo të plotë, të cilat janë të shkruara edhe në bullgarisht.

Pas një periudhe të caktuar të veprimtarisë së tij të bujshme, Kukuzeli bie në një gjendje shpirtërore apatike, andaj dhe në mënyrë misterioze i braktis pozitën dhe privilegjet që i gëzonte, duke u larguar nga Konstantinopoja drejtë Malit të Shenjtë - Atos. Për shumicën e nxënësve dhe adhuruesve të tij të asaj kohe, ishte i pakuptueshëm ky vendim i çuditshëm i Kukuzelit për t’u larguar nga Selia e Perandorisë Bizantine, në Manastirin e Lavrës së Madhe në Atos. Por, edhe përsëri të lutjeve të të gjithë miqëve dhe nxënësve të tij, përfshirë këtu edhe vetë Perandorin Bizantin, që ai të vazhdonte të qëndronte në Konstantinopojë, Jani nuk qëndroi më, sepse thellë në zemrën e tij ndjente një boshllëk. Ishte ky boshllëku për një jetë

asketike që i nevojitej, ku ai do të mundej në qetësi dhe vetmi t'i përkushtohet vetëm Zotit. Madje thuhet se Kukuzeli nuk e pranoi as sugjerimin e Perandorit që ai të martohej me vajzën e një oborrtari fisnik, edhe pse jeta e tij do të kishte mundur të merrte një vijë tjetër cilësore e aristokratike.

Megjithëse Kukuzeli i kishte parasysh të gjitha këto insistime të miqëve, nxënësve dhe vet Perandorit, ai vendosi të largohej pa e ditur askush se ku do të shkonte. Kështu, i veshur si një çoban, Kukuzeli u vendos në Manastirin e Lavrës së Shenjtë në Atos. Dhe sapo arriti atje, Jani menjëherë kërkoi të pranohej në Vëllazërinë e Murgjëve të atjeshëm, për çka mori leje nga Kryepriifti dhe u sistemua për një kohë në Konaqet e Manastirit. Në fillim atij iu dha detyra që të bëhej çoban për t'i kullotur dhitë e Manastirit, pa e kuptuar asnjëri se ky çoban i thjeshtë ishte këngëtar i madh zëngjell - angelofonos, kompozitori i shquar Jan Kukuzeli, emrin e të cilit e njihte dhe respektonte e tërë Perandoria Bizantine.

Një ditë, kur kulloste dhitë në një vend të shkretëtë, duke menduar se ishte vetëm, Jani filloi të këndonte një himn kushtuar Hyjlindëses Mari, me një zë të bukur dhe drithërues. Por, kur këtë këndim e dëgjoi një asket vendas që banonte aty pranë, i fascinuar nga interpretimi mbresëlënës i tij, shpejtë e njoftoi Kryepriiftin e Kishës së Lavrës së Madhe, i cili menjëherë e thirri bariun dhe e detyroi t'i tregonte të vërtetën. Jan Kukuzeli, pasi u detyrua t'ia tregonte identitetin e tij të mirëfilltë, iu lut Kryepriiftit që ta linte të qëndrojë në Manastir, sepse lumturinë e tij e kishte gjetur pikërisht këtu, në qetësinë dhe thjeshtësinë e jetës oshënare, e jo në oborrin perandorak përplotë begati e glamur.

Mirëpo, Kryepriifti i Manastirit, duke mos dashur që akomodimi i Kukuzelit në Lavrën e Madhe të kalonte pa dijeninë e Monarkut, ishte nisur në Konstandinopojë për t'ia sqaruar Perandorit këtë ndodhi. Atëherë Perandori i tha që vendimi i tillë i Kukuzelit ishte vendim i Perëndisë, andaj e sugjeroi Kryepriiftin dhe gjithë të tjerët që ta linin Janin të vendoste lirshëm për mënyrën e jetës atje. Kryepriifti u kthye i gëzuar në Manastir, duke ua kumtuar të gjithëve lajmin e bukur se kush ishte çobani i dhive dhe çfarë ishte mendimi i Perandorit për

këtë mysafir të paftuar. Atëherë Kryeprifti i Manastirit i kërkoi Janit që ta linte punën e bariut dhe të merrte drejtimin e Korrit të Kishës Qendrore të Manastirit. Jani pa asnjë hezitim e pranoi këtë detyrë respektabile. Kështu, Jan Kukuzeli vazhdoi jetën e tij asketike, të ndërthurrur me kontemplacione ortodokse dhe kompozime muzikore, duke praktikuar agjrimin, pendimin dhe bashkimin me Perëndinë e tij të adhuruar. Nga kjo kohë janë të shquara këngët e dedikuara për Krishtin dhe Hyjlindësen Mari, të cilat kanë mbetur thesare shpirtërore të Kishës Ortodokse Bizantine. Të gjitha këto dorëshkrime muzikore, kompozime dhe pentagrame të tij, janë të ruajtura në dy ditarët (imerologjitë) të cilët mendohet se janë shkruar diku mes viteve 1302 – 1309 dhe gjenden nëpër Arkivat dhe Bibliotekat e Malit të Shenjtë, të radhitura në raftin e veprave të personaliteteve më të shquara të asaj kohe. Ndër veprat e kësaj periudhe që u shkruan nga dora e Jan Kukuzelit veçohen këto: 1."Libër që me dëshirën e Perëndisë së shenjtë i përmban tërë shërbesat e Kishës". 2."Arti i të kënduarit dhe shenjat e këngës bashkë me himrominë 141 dhe kompozimin". 3."Tropare për Hyjlindësen". 4."Kondaqe për gjithë vitin".

Thuhet se në ditën e vdekjes, Jan Kukuzeli kishte ndjerë afrimin e vdekjes, andaj dhe i mblodhi të gjithë vëllezërit murgj të besimit, duke iu kërkuar ndjesë e falje. Porosia e tij e fundit ishte që ta varrosnin në Shtëpinë e Kryeengjëjve të Shenjtë, aty ku e kaloi pjesën më të madhe të jetës. Data e vdekjes së tij nuk dihet sigurtë, por sipas disa përllogaritjeve të bëra, Shën Jan Kukuzeli ndërroi jetë diku rreth vitit 1380. Data 1 Tetor shenohet si ditë kushtuar këtij Shenjtori. Vlen të përmendet vizioni mrekullues të cilën ai ua kishte transmetuar vëllezërve të tij të besimit pak kohë para se të vdiste, me ç'rast iu shpjegonte se si një natë i ishte shfaqur Shën Maria Hyjlindëse, e cila për himnet e tij fetare që i kishte kompozuar, atij i kishte dhuruar një monedhë ari. Sot në Kishën e Vogël, edhe pas kaq shekujsh, akoma qëndron në mur ikona "Shën Maria e Kukuzelit", që në nderë të tij quhet Kukuzelisa.

Të dhënat më të përmbledhura biografike për Kukuzelin, megjithëse jo fortë të sistemuara, gjenden në fragmente të ndryshme në Kodikun nr. 46, në Manastirin e Vladhatonit, në Selanik, shkruar nga një autor anonim, jo shumë i arsimuar, me prejardhje sllave. Mendohet se ky njeri kishte arritur që t'i mbledhte të gjitha gojëdhënat dhe kujtimet për Kukuzelin që ekzistonin në kohën e tij. Ky jetëshkrim ka shumë të dhëna konfuze, të cilat duhen studiohen nga filologë dhe historianët tanë! Në këtë dokument, në mes tjerash flitet edhe për atdheun e Jan Kukuzelit, ku në mënyrë eksplicite përmendet Durrësi (*Kodiku Vladhaton, Sinaksari 2, nr. 46, Lavra L-146, 1550*).

Shikuar përgjithësisht, që nga viti 1550 kur përpilohet jetëshkrimi i parë për atë, shumica e autorëve ndajnë mendimin se vendlindja e Kukuzelit është pikërisht qyteti i Durrësit (*Tardo, 1938: 70*). Këtë konstatim e gjejmë edhe tek disa Enciklopedi prestigjioze si Enciklopedia Britannica (Mc Milan, London, Vol. 10, fq. 218, ku thuhet se "*Jan Kukuzeli lindi në Durrachium, tani Durrës - Shqipëri*"), Enciklopedia e Madhe e Larousse (Paris, 1984, fq. 6032, ku thuhet: "*Koujouzeles ou Kukuzeles, Jean, compositeur et reformateur byzantin (Durrës v.1300)*", apo në Wikipedia (ku shkruhet: "*Jan Kukuzeli ishte një murg ortodoks nga Durrësi, shenjtor, himnograf, mjeshtër dhe teoricien i muzikës kishtare bizantine*") etj. Mirëpo, siç dihet, tek popujt e Ballkanit sikur është bërë e zakonshme që personalitetet historike të shquara me përmasa botërore (si Priam Dardani, Aristoteli, Leka i Madh, Skenderbeu, Nënë Tereza etj) të përvetësohen, ashtu që secili i ofron 'argumentet e veta' për ta dëshmuar autoktonësinë nacionale të personalitetit! Një gjë të këtillë për përvetësimin e nacionalitetit të Kukuzelit e bëjnë edhe disa popuj ballkanik, si për shembull grekët, bullgarët, maqedonët, serbët, rumunët etj. Muzikologët grek Jan Kukuzelin (Johan Kukuzellos) mundohen ta paraqesin si me origjinë greke, duke u bazuar në qëndrimin, shërbimin e tij në Malin e Shenjtë Atos dhe në shkrimin e veprave të tij në gjuhën e atëhershme greke (*Kodikët e Bibliotekës Kombëtare të Greqisë, nr. 889, Shek XIV, fl.71, 47 r*). Por, ata sikur 'harrojnë' se në Perandoritë e mëdha, përfshi këtu edhe Perandorinë Bizantinase, kishte një

konglomerat të vërtetë të popujve, gjuhëve, kulturave, feve etj, andaj kohezioni social-politik i tyre mund të mbahej vetëm përmes një gjuhe zyrtare, që në Bizant fillimisht ishte latinishtja, e pastaj gjuha greke. Mirëpo, përdorimi i atëhershëm i gjuhës greke në të folur dhe të shkruar, asesi nuk dëshmon se të gjithë shkrimtarët, arkitektët, muzikantët e Perandorisë Bizantine ishin me origjinë greke! Situatë e ngjashme ka qenë edhe në Perandorinë osmane, ku megjithëse gjuha zyrtare - administrative e Perandorisë ishte osmanishtja (turqishtja e vjetër), të gjitha krijimet kulturore materiale dhe shpirtërore nuk kanë qenë ekskluzivisht të turqëve, sepse kjo Perandori e Madhe kishte shkencëtarë, filozofë, arkitektë, oficerë, artistë, poet etj, të cilët vinin nga viset e ndryshme dhe u takonin popujve dhe kulturave të ndryshme që jetonin dhe vepronin në atë Perandori multietnike, multikulturore dhe multikonfesionale!

Një orvatje identike për 'shkombëzimin' e Jan Kukuzelit nga prejardhja e tij iliriko-shqiptare e bëjnë edhe studiuesit bullgar S. Petrov dhe L. Stançeva. Këta Kukuzelin (Jovan Kukuzov) e nxjerrin me prejardhje bullgare, duke u bazuar në hipotezën se polielei i quajtur "Bullgarja" (Bullgarica), dëshmon mjaftueshëm jovetëm prejardhjen e nënës së Kukuzelit, por edhe të vetë atij! Sipas këtyre autorëve, kur Perandori Bizantin i propozoi Kukuzelit të martohej me vajzën e një aristokrati mbretëror, ai e luti Perandorin që t'i jepte mundësinë të shkonte ta takonte nënën e tij në vendlindje, në Durrës, për ta marr bekimin e saj. Por kur Jani arriti pranë shtëpisë së tij të lindjes, e takoi nënën e tij të mallëngjyer e cila e kishte pritur me fjalët "Moe dhete mило, gdhemisi oho", që në bullgarisht d.t.th. "Djali im i dashur, ku m'ke humbur ti!". Pas këtij takimi emotiv, kur Jani u kthye në Konstantinopojë, i kapluar nga malli për nënën kompozoi polielein e quajtur "Bullgarica" (*Dinev, 1938 : 24*). Por, edhe kjo storje nuk është dëshmi e qëndrueshme për argumentimin e origjinës së tij bullgare, sepse edhe sikur të ishte kështu, e gjithë bota e civilizuar Jan Kukuzelin e njeh si Jan Durrësaku dhe jo si Jan Bullgari! Dhe tek e fundja, siç dihet përgjithësisht për popujt e Ballkanit, si atëherë ashtu edhe sot, ata vazhdimisht kanë patur martesë të përziera, por kjo gjë jo gjithmonë e ka zbehur identitetin nacional të një individi!

Në këtë vrap të nacionalizimit të personazheve të shquara, janë angazhuar edhe disa 'studiues' maqedonë (J.Koxhabashija etj), të cilët, Kukuzelin (Jovan Kukuzev) mundohen ta nxjerrin me rrënjë maqedone! Insistimin e tyre këta e bazojnë në disa dokumente tjera, ku shkruhet se vendlindja e Kukuzelit është Justiniana Prima, për të cilin pretendojnë se është qyteti i Shkupit apo Ohrit. Por, studimet e ndryshme historike dhe arkeologjike kanë sqaruar se qyteti Justiniana Prima më shumë ka nënkuptuar Durrësin (Dyrrahum) e Ilirisë si një qytet bregdetar antik, se sa Shkupin apo Ohrin e Maqedonisë!

Edhe në fushën e muzikologjisë shqiptare janë bërë disa studime mbi origjinën etnike të Jan Kukuzelit, por sipas meje këto studime janë të pamjaftueshme, prandaj ato duhet të vazhdojnë me intensitet edhe më të madh. Ndër studiuesit tanë që janë marr me këtë problematikë janë Sokol Shupo, Ramadan Sokoli, Irakli Koçollari, Theodor Peci, Sabaudin Zhuta, Mihal Ekonomi, Dhimitër Beduli.

Është shumë interesante të ceket se tendenca sistematike e këtyre popujve të Ballkanit për ta përvetësuar Jan Kukuzelin si të tyrin, jorrallëherë lidhet me mbiemrin e tij karakteristik 'Kukuzeli' dhe përpjekjet për ta shpjeguar domethënien e kësaj fjale me ndonjë shprehje të gjuhës së tyre. Kështu për shembull, sipas disa dokumenteve kur Kukuzeli akoma shkonte në Shkollën Perandorake në Konstantinopolis, moshatarët e tij njëherë e kishin pyetur: 'Çka ngrëne sot, o Jan?', me ç'rast ai duke mos e ditur mirë as greqishtën, e as bullgarishten (me që s'ishte as grek, e as bullgar, por shqiptar!), iu ishte përgjigjur 'kuka dhe ze', prej ku dhe e mori nofkën, apo mbiemrin Kukuzeli! Përndryshe, sipas të gjitha gjasave, Jani shokëve të tij deshi t'iu thoshte se për drekë kishte ngrënë groshë (gr. kukia-groshë) dhe lakër (bull. zele-lakër). Nuk është gjë e panjohur nëse themi se nëpër Shkollat dhe Manastiret Ortodokse të Konstantinopojës, numri më i madh i nxënësve ishin nga vendet fqinje të Konstantinopojës, e sidomos nga Greqia e Bullgaria, andaj dhe Kukuzeli si duket këtë mbiemër të tij e fitoi duke u munduar të fliste me shokët e Shkollës në gjuhën të cilën nuk e njihje mirë, sepse ishte shqiptar! Ndërsa sa i përket emrit të tij, që sipas shumë burimeve ishte Jan (*te Wikipedia është Jan Kukuzeli*), pavarësisht se grekët në gjuhën e tyre atë e quajnë Joanis, Johan; bullgarët, maqedonët e serbët Jovan, ndërsa rumunët Joan. Në këtë

kontekst duhet kujtuar se shumë personalitete nga e kaluara historike, nga ana e popujve të ndryshëm janë quajtur me emra të ndryshëm, të bazuar në natyrën e gjuhës së tyre. Sa për ilustrim: mjafton ta përmendim njërin prej kryengritësve të Kryengritjes së lindenit (1903), Pjetër Gurin, i cili sipas historiografisë shqiptare ishte shqiptar ortodoks, kurse sipas asaj maqedone ai quhej Pitu Guli dhe ishte maqedonas me prejardhje vllehe! Kësisoj pra kishte ndodhur edhe me emërtimin e vetë Jan Kukuzelit.

Muzikologët shqiptarë Ramadan Sokoli (*Sokoli, 1963 : 3-4*), Sokol Shupo (*Shupo, 1997 : 4, 56-71*), Shyqiri Nimani etj, ofrojnë argumente vërtetë të qëndrueshme lidhur me origjinën shqiptare të Jan Kukuzelit. Gjatë hulumtimit të veprave të tij, ata kanë veneruar se në Sistemin rrethor të Kukuzelit, mbiemri i kompozitorit të madh nuk është shkruar as greqisht (Kukuzelis), as bullgarisht Kukuzov, e as maqedonisht (Kukuzev), por pikërisht në shqip – pra Kukuzeli! Kuptohet se ky mbiemër është shkruajtur me shkronja greke, meqenëse siç u përmend edhe më herët, gjuha greke ishte gjuha zyrtare e folur dhe e shkruar në kretë Perandorinë Bizantine. Këta hulumtues kanë gjetur edhe disa tinguj dhe ritme që akoma përdoren në folklorin e Shqipërisë së Mesme. Është shumë interesante të nënvizohet se në shkrimet kritike të disa muzikologëve grek, bashkëkohas të Kukuzelit, gjejmë ‘vërejtje kritike’ ku Kukuzeli akuzohet se në veprat muzikore të tij kishte ‘importuar disa vija melodike jobizantine, jogreke’, që në fakt tregon për prezencën e melosit me të cilin si fëmijë ishte frymëzuar Kukuzeli, e ai ishte melosi popullor i zonës së Durrësit!

Duke u bazuar në këto fakte, Shqipëria dhe veçanërisht Durrësi, këtij personaliteti të rrallë i ka dhënë një vend të merituar, duke e emërtuar Shkollën artistike në Durrës me emrin emrin “Jan Kukuzeli”. Por, sot emrin Jan Kukuzeli e mbajnë edhe shumë ansamble korale apo grupe a capella anëmbanë trojeve shqiptare, gjë që dëshmon se populli ynë është një popull fisnik që gjithmonë i ka dashur dhe çmuar njerëzit e shkencës, kulturës dhe artit! Në vazhdim, mbetet një detyrë dhe mision i pambaruar i institucioneve tona akademike, shkencore e kulturore, që edhe më shumë ta

gjurmojnë origjinën dhe veprimtarinë e Jan Kukuzelit, sepse këtë gjë shqiptarët, këtij Orfeu të muzikës vërtetë ia kanë borxh!

### Përmbledhje

Kumtesa ime me temë *“Jan Kukuzeli – kompozitori shqiptar mesjetar me dimensione botërore”*, për qëllim parësor ka rindriçimin e figurës markante të artit muzikor mesjetar – durrësakut Jan Kukuzeli. Ndër aspektet e ndryshme që do të futen në fokus të këtij studimi janë: origjina e Jan Kukuzelit, jeta e tij në Pallatin Mbretëror dhe në Manastirin e Atosit, veprimtaria muzikore e bujshme e tij, tendencat e disa popujve ballkanik për ta përvetësuar figurën e tij, faktet që argumentojnë kombësinë e tij iliro-shqiptare etj. Një vend i posaçëm në studim do t’i rezervohet rolit dhe rëndësisë së reformave të Jan Kukuzelit në notacionin muzikor, që në fakt ka të bëjë me zbulimin e njohur si ‘Shkrim muzikor kukuzelik’. Gjatë elaborimit shkencor të të gjithë këtyre çështjeve, do t’ishfaqim edhe arsyetimet e disa studiuesve ballkanik (grekë, bullgarë, maqedonë etj), të cilët pretendojnë se Kukuzeli është i tyre. Në këtë konstelacion argumentimesh, orvatja ime do të jetë argumentimi i rrënjëve etnike të Kukuzelit si dhe të kulturës muzikore të tij, të cilën ky në Oborrin Perandorak të Bizantit e kishte sjellur nga zona e vendlindjes së tij, Durrësi. Kuptohet se të gjitha këto premisa ne do t’i bazojmë në Dokumentet e ndryshme të ruajtura në Muzeume dhe Arkiva të Manastirit, por edhe nëburimet tjera europiane kredibile, të botuara nëpër libra apo web faqe.

Fjalët kyçe: Jan Kukuzeli, Bizanti, origjina iliro-shqiptare, muzika mesjetare, kompozimet ortodokse, shkrimi muzikor kukuzelik etj.

### Summary

My paper entitled *“Jan Kukuzeli – medieval albanian composer with world dimensions”*, aims primarily to re-enlighten the most influential figure in the medieval music - Jan Kukuzeli from Durrës. Among the various aspects that will be the focus of this study are: the origins of Jan Kukuzeli, his life in the Royal Palace and the Monastery of Athos, his astonishing music work, the tendencies of some Balkan

populations to adopt his figure, facts that argue for his Illyrian – Albanian nationality etc. A special part in this study will be reserved for the role and importance of Jan Kukuzel's reforms in music notation, which is in fact related to the music innovation known as "Koukouzelis Music Writing". In the scientific elaboration of all these issues, furthermore we will be presenting some Balkan scholars' (Greek, Bulgarian, Macedonian, etc.) reasoning on claims that *Kukuzeli* is theirs. In this constellation of arguments, my attempt will be to argue for Kukuzel's ethnic roots as well as his music culture, which he brought to the Byzantine Imperial court from his hometown Durrës. All these premises will be based on the various documents stored in the Museums and Archives of the Monastery, as well as on other credible European sources published in books or web pages.

Key words: Jan Kukuzeli, Byzantium, Illyrian- Albanian origin, medieval music, orthodox compositions, Koukouzelis music writing

#### Bibliografia:

1. Mihal, Ekonomi, *Jan Kukuzeli*, Vegim Drite, Nr 4, fq. 18-20, qershor, 1997.
2. Dhimitër, Beduli, *Jan Kukuzeli nga Durrësi*, Ngjallja, fq. 15, nëntor, 1992.
3. Marisa & Petrika Trako, *Joan Kukuzeli – Mjeshtër i madh i artit muzikor*, Tema, 2 gusht 2007
4. Giuseppe, Ferrari, *L'Albania e la musica bizantina*, Revista "Oriente Cristiano", anno XVIII, nr. 4, p.122-132, 1978, Palermo.
5. Lorenzo, Tardo, *L'antika melurgia bizantina. Nell'interpretazione della scuola manastica di Grottaferrata*, Grottaferrata MCMXXXVIII, fq.70, 1938.
6. Ramadan, Sokoli, *Figura të ndritura*, Tiranë, 1963.
7. Sokol, Shupo, *Shkrimi muzikor dhe sistemi modal në muzikën bizantine*, Tiranë 1997.

8. P. Sarafov, *Manuel d'études pratiques et théoriques de la musique religieuse orientale*, Sofia, 1912.
9. P. Dinev, *Duchovni muzikalni tvorbi na sv. Joan Kukuzel*, Sofia, 1938.
10. Miloš, Velimirovic, "The 'Bullgarian' musical pieces in byzantine musical manuscripts", Copenhagen, 1972.
11. R. Palikarova-Verdeil, *La musique byzantine chez les Bulgares et les Russes (du IXe au XIVe siècle)*, Paris.
12. Edward V. Williams, *A byzantine Ars Nova: The 14th-century reforms of John Koukouzeles in the chating of Great Vespers*, Paris, 1972.
13. Kodikët e Bibliotekës Kombëtare të Greqisë nr. 889 (EBE 889) (fundi i shek. XIV), fl. 71r, nr. 2456 (shek. XIV), fl. 47 r.
14. Kodikët e Bibliotekës Kombëtare të Greqisë nr. 2406 (EBE 2406), i vitit 1453, fl. 101v; nr. 906 (EBE 906), fl. 72v.
15. Kodiku Iviron 1223, i fundit të shek. XVI, fl. 75r.
16. Kodiku i Bibliotekës Kombëtare të Greqisë nr. 928 (EBE 928), shek. XV, fl. 6 r, 19r.
17. Kodiku i Bibliotekës Kombëtare të Greqisë nr. 2401 (EBE 240), i shek. XV, fl. 108v.
18. Kodiku Iviron 951, fl. 30 v, prej autografit të Gjermanit Neon Patron nga një rishkrim i dhjetëvjeçarit 1670-1680, që përmendet dhe tek Kodikë e tjerë të mëvonshëm.
19. Kodiku Iviron 1250, fl. 96 v, prej Kodikut të rishkruar nga autograf Balash Prifti, i vitit 1670.
20. [www](http://www.wikipedia.org), Wikipedia, John Koukozelis, or Jan Kukuzeli.

**Avzi MUSTAFA**

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi

Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni

E-mail: avzimustafa@yahoo.com

**GRIGOR PËRLIÇEVI DHE KONTRIBUTI I TIJ INTERKULTUROR  
GRIGOR PARLICHEV AND HIS INTERCULTURAL CONTRIBUTION**

Grigor Përliçevi, ndonëse konsiderohet si "baba i poezisë maqedonase", veprat i ka shkruar e botuar në greqisht. Për këtë arsye grekët e konsiderojnë poet të tyre, si "Homerin e kohëve të reja", bullgarët si themelues të letërsisë së rilindjes kombëtare bullgare, vllahët thonëse ai është me origjinë vllahe, ndërsa shqiptarët e trajtojnë fluturimthi për shkaktë poemës "Skënderbeu". Ky shkrimtar e ka vetëm një emër– Njeri dhe një mbiemër – Ballkan. Prandaj shkrimtarët e tillë çdoherë mbeten të mëdhenj në historinë e njerëzimit.

Për këtë shkrimtar të përmasave ballkanike lexuesi shqiptar, përveç ndonjë fragmenti nga poema "Skënderbeu", ka një rezervë gjatë të lexuarit, kjo për shkak të interpretimeve të ndryshme të veprave të tij, siç pohon Gane Todorovski se "është shkruar diçka dhe gjithçka"<sup>5</sup>, por ende mbeten pa u thënë mbi atë që ka shkruar<sup>6</sup>. Në vitet 1990-të të shekullit të kaluar Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare e Fakultetit të Filologjisë në Shkup mbajti një simpozium me titull "Kontinuiteti gjuhësor dhe letrar", ku morën pjesë një numër i madh i studiuesve shqiptarë dhe të huaj. Të gjitha kumtesat ishin interesante, por një nga kumtesat që ngjalli interes ishte kumtesa e akademikut Olivera Jashar –Nastevës, e cila foli mbi një lexim të ri të Grigor Përliçevit, gjegjësisht u ndal mbi tezën se shkrimtarët

---

<sup>5</sup>Гане Тодоровски, За потребата од едно ново читање на Прличевата poema „Сердарот“, Зборник на трудови, Живот и дело на Григор Прличев, Скопје, 1996, fq.22

<sup>6</sup> Edhe pse pas viteve 2005 e këndeje kemi një përpjekje nga disa autorë që të bëjnë një interpretim të ri, ata përsëri mbeten në kornizat nacionale.

janë të përbotshëm dhe se ata shkruajnë për fatet e njerëzve pa dallim etnie, ndonëse te ne çdoherë – duke pasur parasysh labirintin e mentalitet ballkanik – shumë gjëra edhe nuk thuhën.

Akademikja foli edhe më shumë, por meqenëse referatet do të botoheshin, disi nuk u sëmëllidisa. Por, kur ia kërkua referatet për botim, referati kushtuar kësaj teme nuk erdhi. Meqenëse isha një nga ish studentët më të dashur të saj dhe, më vonë, edhe koleg, gjithsesi isha edhe më i privilegjuari, andaj iu drejtova disa herë që ta dorëzojë referatin, por çdoherë merrja përgjigjen se ende nuk e ka mbaruar. Edhe kryeredaktori atëherëshëm i gazetës “Flaka”, z. Rexhep Zllatku, sa herë që takoheshim më pyeste për atë referat, sepse ishte tepër i interesuar që ta botojë për lexuesit e Flakës, por punimi nuk u pa asnjëherë më. Kështu kaluan disa vite, por unë – në takimet e mia me Akademiken – nuk hiqja dorë nga kjo kërkesë. Më vonë ajo u sëmur dhe pas një kohe të shkurtër kaloi në amshim.

Derisa akademikja ende ishte në gjendje të komunikojë, në një bisedë me familjen e vet, ekishte lënë edhe një amanet: që të gjitha librat shqip të m’i fali mua. Pas disamuajsh erdhi një nga komshinjtë e lagjes së Bit Pazarit, ku e kishin pasur shtëpinë Jasharajt, dhe m’i dorëzoi librat. Për mua ky ishte gëzimi më i madh dhe, në të njëjtën kohë, më i habitshëm. Fillova pastaj t’i shikoj librat dhe më ra në sy një libërme tri afishe të shpërndara, të shkruara me dorë. Ishte një analizë e një shkencëtareje gjermane me emrin Doroteja Kadah, e cila kishte diskutuar për tri shënime: *Alfa*, *Vitadhe Sigmatë* Grigor Përliçevit.

Te një skedë e shkruar me titullin *Alfa* ishte ky shënim: “Se G. Përliçevi, në poemën ‘Serdari’ bën fjalë për shqiptarët e fshatrave të Rekës së Epërme. Aty lexova për shqiptarët ortodoksë, që janë të vetmit që e kanë ruajtur pastër dhe të paprekur fenë lindore ortodokse të trashëguar nga gjyshërit”. Në margjina kishte edhe shumë të dhëna, por të pasistemuara. Atë që munda ta deshifroj ishte edhe ky citat i shkruar: “*Kot ti ma lavdëron si hero, por djall më je sipas fesë*”. Nga kjo skedë mësova për studiuesen gjermane, e cila kishte botuar një punim mbi poemën “Serdari” të G. Përliçevit. Kaloi shumë kohë, por kureshtja ime nuk pushoi. Fillova të mbledh shënime e ta lexoj e rilexoj “Serdarin” nga autorë të përkthimeve të ndryshëm, si atë të bullgarit Topallov, të maqedonasve, si Kiril Kamilov, Kiselinov, Krum Toshev, Stalev, Mihailo Petrushevski e shumë të tjerë, por edhe shumë punime shkencore e artikuj që kanë të bëjnë me Grigor Përliçevin.

Punimit të gjermanes Kadah i rashë në gjurmë nëpërmjet kolegut tim, gjermanologut tashmë të ndjerë Dimitar Gacov, i cili kishte studiuar në Gjermani dhe udhëtonte shpesh në atë shtet. Ai një ditë më solli disa punime të Doroteja Kadahut, të cilat ajo i kishte botuar në revistat e Mynihut. Mes tjerash, ma solli edhestudimin mbi Grigor Përliçevin. Punimi ishte shkruar në gjuhën gjermane në kumtesat e botuara të simpoziumit ballkanik në Athinë (1970)<sup>7</sup>. Me ndihmën e prof. Gacov e përkthevadhe kuptova se ajo në simpoziumin mbajtur në Athinë në vitin 1970 kishte deklaruar se “ka ardhurkoha për paraqitjen e dy versioneve: në greqisht dhe në maqedonisht, për njëinterpretim të ri të poemës ‘Serdar’, si në aspektin e metrikës, ashtu edhe për nga vëllimi, si dhe në frymën fakteve të reja”<sup>8</sup>. Në të vërtetë, të gjitha botimet në gjuhën maqedonase jo që nuk janë përkthyer, por edhe janë hequr simiozat (shënimet) e Përliçevit, madje janë hequr edhe strofa të tëra: Alfa, Vita dhe Sigma. Ajo pohon se ka dallime ndërmjet origjinalit në gjuhën greke të vitit 1860 dhe atij të vitit 1870, kur peshkopi i Gjakovës në Kroaci, Juraj Shtrosmajer, e shkurtoi për 145 vargje, duke i dhënë karakter sllav, kjo në bazë të emrave që i përdor Prliçevi, si: Kuzman, Neda, Stojko, Dimko, Savo, Kote, Kico etj.

Në studimin e Z. Kadah thuhet se në origjinalin në gjuhën greke të poemës “Serdar” përshkruhet lufta ndërmjet dy grupeve shqiptare, ku njeri është i krishterë e tjetri mysliman. (Shih shënimin: Alfa)

Siç dihet, shkrimtarët para së gjithash janë “njerëz që kanë një ide për të gjitha dukuritë e jetës. Ata janë një artistë, që nga pjesët e shpërndara dhe të ndara në mendjen e tyre, mund të formojë një tërësi organike<sup>9</sup>. Megjithatë kritikët konformistë dhe nacionalistë sikur nuk duan ta shikojnë opusin letrar të një shkrimtari si nevojë letrare estetike, por si nevojë konfrontimi në krijimin artistik të

---

<sup>7</sup> . Dorothea Kadach: “*Armatolos* und “*Serdarot*” zurgrichischen und slavischen Fassung von Grigor S. Priličev sepischen Gedicht” In: Beitragezur Sudosteuropa-Forschung, Analablichdes II Internacionalen Balkanologen Kongresses in Athen, (7.V.1970, Munchen, 1970, p. 83-105)

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Antun Vegas, Naša književnost u njezinih istorici u Problemi književnosti, Beograd, Prosveta, 1964, fq. 56.

personazheve. Ata sikur dëshirojnë t'i kapin ato si realitet historik dhe faktor ekzistence të popullit të vet nga një popull tjetër, që është në bashkëjetesë meshekuj, e t'i japin interpretime jo duhura dhe me kahje negative, që kështu më vonë të lexuesit të formohen mekanizma psikologjike për t'u mbrojtur me stereotipat e paragjykimet.

Për veprimtarinë letrare të Grigor Pëlliçevit janë shkruar shumë libra e artikuj, si dhe janë mbajtur shumë simpoziume që nga viti 1946 e deri më ditët sotme, por asnjëri nga ata që janë marrë me veprimtarinë e tij, nuk i kanë pasur parasysh tekstet e plota, por janë mbështetur nga botimigjuhës serbo-kroate. Përkthyesit, si ata që janë marrë merikëndimet e kësaj vepre, si: Kiselinov, Toshev, Stalev, Petrushevski, Sazdov, Dimitrievski etj., nuk e kanë parë asnjëherë të udhës që në përkthimet e tyre t'i inkorporojnë vërejtjet e autorit, që janë tekstet Alfa, Vita dhe Gama, edhe pse që nga viti 1970 ata janë ditur.

Po çka përmbajnë këto shënime, që i ka shkruar vet Pëlliçevi, e që janë hequr me qëllim, me ç'rastsë pari janë hequr vargjet, e pastaj edhe shënimet e tij sqaruese?

Në shënimin *Alfa* janë këto shënime: "Se me emrin Rekë kuptojmë afër 20 fshatra në veriperëndim të Dibrës, të populluar me shqiptarë krenarë, që janë të vetmit që e kanë ruajtur të pastër dhe të paprekur fenë lindore ortodokse të trashëguar nga gjyshërit. Të rrethuar nga të gjitha anët me turq, si dhenë mes të ujqve, ata jetojnë një jetë të keqe, sepse çdoherë janë nën presion nga gegët e Dibrës dhe rrethinës. Në të vërtetë, ata shpeshherë marrin leje nga qeveria për t'u mbrojtur me armë nga kaçakët (hajdutët), por çka mund të bëjnë bujqit e shumë para burrave të egër, të cilët që në fëmijëri rriten me armë në dorë? Dhe, pastaj nuk është e habitshme pse shumë shqiptarë largohen nga feja" (konvertohen në islam – shënimi im).

Në shënimin *Vita* Pëlliçevishkruan: "Shumica e shqiptarëve, kur është në pyetje tati, paraqiten si turq, ndërsa kur duhet ta kryejnë shërbimin ushtarak, paraqiten si të krishterë. Te shumica e emrave vetjakë janë emra otomanë, ndërsa prindërit (nofkat) i kanë të krishterë. Kjo dëshmon për atë kohë kur gjyshëritë e tyre rebeloheshin. Ndërkaq të tretët jo se janë më të zgjuar, por fshehtas

janë pastër krishterë, ndërsapublikisht janë turq të pastër. Ata kanë dy lloj emrash: njeri emër i jepet fëmijës nga imami në solemnitet edhe parada dhe me të shërbehet në jetën shoqërore, ndërsa tjetri i vihet nga prifti, i cili, pazhurmë, në natën e dytë, e kryen pagëzimin fshehtazi. Kjo shërben edhe për jetën familjare. Kjo babiloni mbretëron edhe mbi disarituale religjioze. Këto rituale, nëpër vende dhe fshatra, diku janë të plotae diku të pjesshme.”

Në shënimin *Gamathuhet* se: “Të gjithë qytetarët e Shqipërisë, në bazë të mendimeve, pamjes, veshjes, dokeve dhe zakoneve, është e qartë senuk janë asgjë tjetër, përveçsehelenë. Të gjithë janë talentuar dhe me zemërgjerësi (me krenari) të kthjellët dhe falënderues. Janë bujarë dhe besnikë si asnjë popull tjetër. Përnëmën e shenjtë e kanë kripën e huaj, janë të ndershëm, liridashës dhe të patrembur në lufta; nëse nuk merret me kujdes barbaria dhe paligjshmëria, të njëjtën karakteristikë e kanë edhe turqit, të cilët nuk janë asgjë tjetër, përveçse të krishterë, të cilët janë nënshtruar para kamxhikut dhe tiranisë, që del nga ajo që u tha në shënimin “Vita”. A e kanë pranuar muhamedanizmin (myslimanizmin) me të vetmin qëllim, që t’ia lehtësojnë jetën këtij populli liridashës, i cili vuan nga pesha e rëndë e nënshtrimit okupues. Gjuha turke edhe sot e kësaj dite mbetet e panjohur në Shqipëri. Turqit (shqiptarët myslimanë – shënimi ynë) dhe të krishterët flasin të njëjtën gjuhë –gjuhën shqipe, gjuhën e luftës, përveç fiseve të civilizuar të toskëve, që shumë shpesh e përdorin gjuhën greke dhe shkrimin e saj. Është e mirë që njohësit e gjuhës shqipe të merren me çështjet filologjike për gjenezën e gjuhës shqipe me gjuhën e vjetër helene, që të dëshmohet në këtë mënyrë gjuha shqipe dhe gjuha e vjetër helene dhe kështu të ndikojnë në vëllazërimin shqiptarëve dhe helenëve, gjë që e prek vajtimin e Helladës si një Niobe e lashtë e përjashtuar nga fëmijët e saj”.

Për këto shënime të Përliçevit edhe shkrimtari i famshëm maqedonas Gane Todorovski, në një simpozium kushtuar jetës dhe veprës së Gligor Përliçevit, do t’i pyesë njohësit e veprës së Përliçevit se pse kanë mbetur të pabotuara simiozat që i jep Përliçevi. Po ashtu ky shkrimtar shfaq habi se edhe në publikimin më të ri, të prof. Tome Sazdovit, nuk sqarohen këto, gjë që implikon paqartësi

dhe interpretim të njëanshëm. Po ashtu prof. Todorovski e pyet edhe përkthyesin Todor Dimitroskin pse e ka hequr sintagmën në vargun 397 nga versioni ipërkthimit maqedonas, aty ku thotë Prliçevi “Bullgaret e urtë” dhe atë e ka zëvendësuar me togun “fshatarët tanë”<sup>10</sup>. Sipas tij, nëse nuk botohen këto tri shënime, do t’i behet padrejtësi autorit dhe kjo do të jetë “mëkat ndaj veprës dhe Përliçevit”.<sup>11</sup>

Përkthimet dhe interpretimet e këtilla të njëanshme provokojnë edhe një absurd tjetër, që ishte prezentedhe te disa Entelektualë shqiptarë, se kjo vepër i “nënçmon dhe nënvlerëson shqiptarët si popull. Interpretimet e njëanshme, pa e thënë të vërtetën, do të mbeten në nivelin e një të a.q. “doktor shkence”, Riste Ivanovski, i cili shkroi një libër me plot marrëzi me titull “G. Përliçevi dhe arnautët aziatikë”, botuar në Manastir më 2014.

Përliçevi, në të gjitha veprat e tij, do ta kërkojë raportin e njësisë dhe shkaqet e ndasisë midis vendëses dhe të huajës, si dhe problemin e lidhjeve të fesë në kuptimin elementit përçarës. (Shih shënimin Vita). Përliçevi do ta shpjegojë shumë qartë, nëpërmjet fjalëve të nënës Nedë, e cila do të eksplodojë nga dhimbja për vdekjen e djalit, duke i thënë plakut shqiptar: “*Kot ti ma lavdëron si hero, por djall më je sipas fesë*”.<sup>12</sup> Pra, Përliçevi – në poemën “Serdar” – e paraqet ndarjen e shqiptareve në të krishterë dhe muhamedanë, siç ishin sulmet e grabitjet e fshatarëve të krahinave të tjera me fe myslimane mbi ortodokse, që terrorizonin popullatën nga grupe kaçakësh e kriminelesh të udhëhequr nga Osman Mura dhe Dervish Muça. Këta kaçakë dhe njerëz të këqij nuk ishin të tillë nga natyra, por të tillë i kishte bërë pushteti osman, i cili kishte plot ligje në letër, por asnjë prej tyre nuk zbatohet drejt. Perandoria, nëpërmjet resor-mave centralizuese të Tanzimatit u përpoq të vendoste një shtypje të re mbi të gjitha vendet ku ajo administronte, duke e bërë këtë përmes taksave e rekrutimit ushtarak, me çka e varfëronte popullsinë, sidomos atë fshatare nëpërmjet vergjisë (taksave në natyrë).

---

<sup>10</sup> Гане Тодоровски, ро ату, f. 28.

<sup>11</sup> Гане Тодоровски, ро ату, f. 33.

<sup>12</sup> Ѓорѓи Сталев, Прличев 1893-1953, Скопје 1953.

Në poemën “Serdar” Përlaçevi asnjëherë nuk i përmend osmanlinjtë, sepse ata janë pushtues, por habitet nga shqiptarët e Veriut – gegët, një pjesë e të cilave ishin islamizuar dhe kjo është e keqja më e madhe. Aie identifikon religjionin me kombësinë. Kjo ndarje në baza fetare, sipas tij, kishte sjellë vëllavrasje dhe robërim, ndërsa këtë pushtuesi e bënte në mënyrë të vetëdijshe për të qëndruar sa më gjatë në këto troje.

Cubat dhe hajdutët, në këtë poemë, shihen si një grup kaçakësh shqiptarëtë myslimanizuar, që bëjnë zullumendaj popullatës së krishterë, por edhe ndaj shqiptarëve të pasur të po të njëjtit besim fetar. Natyrisht, ai nuk e anashkalon respektin mes njerëzve të fiseve shqiptare dhe maqedonase, që jetonin sëbashku në të njëjtat treva.

Ai, si njohës i mirë i historisë së popullit shqiptar, posedonte njohuri të mira për këtë popull, aq më shumë që një kohë kishte shërbyer si mësues në Tiranë. Atje ishte njohur edhe me heroin kombëtar të shqiptarëve – Skënderbeun, për të cilin pastaj e thur një poemë tjetër – “Skënderbeun”. Në poemën “Serdar” ai do të përmend se “dikur kemi luftuar bashkë dhe kemi pasur suksese, ndërsa tani erdhëm deri tek ajo që mes vete të vritemi”.

Përveç kësaj, Përlaçevi si i lindur në Ohër nga një nënë fshatit Vërbjan dhe duke qenë mësues në Tiranë, për shumë interpretues maqedonas është dëshmi se ai i ka njohur shqiptarët shumë mirë<sup>13</sup>. Jo që i ka njohur, por ai si duket i kandjerë në shpirt me të gjitha të mirat dhe të këqijat, që nga mënyra e jetesës, kushtet ekonomike sociale, tradita, karakteri dhe mentaliteti, lidhjet fisnore të shqiptarëve, ndërsa ai di që në mënyrë poetike t’i përshkruajë të gjitha këto, duke i nxjerrë në pah arsyet se pse janë ndërsyer ndërmjet vete sindaj pushtuesve. Ai thotë se të këqijtë janë të bashkuar në *tajfa (harpji)*, të cilët nëna Nedë do t’i quajë *langurë, hajdutë, vjedhës, kusarë, të mallkuar*, por konfrontimet nuk i nxjerrë ndërmjet shqiptarëve ose popujve të tjerë, por ndërmjet grupeve të hajdutëve që janë të besimeve të ndryshme. Përlaçevi, në personazhet e tij, përkundër konflikteve, e çmon dhe nxjerrë në pah edhe respektin enjerëzve të

---

<sup>13</sup> Војислав Јачоски, Албанците во делата на Г. Прличев, Бигорски научни собири и научен собир, Гостивар 1971, fq.83.

fiseve shqiptare dhe të tjerëve, që jetojnë në këto treva. Për shembull, Mahmutin- nëpërmjet rrëfimit të shqiptarit plak - do ta karakterizojë si “dem të çartur në mes të kopesë”, që çka ka synuar, atë edhe e ka kryer. Ai ishte guximshëm dhe i prerë në vendime. Sakrifikohej kur i vriteshin shokët dhe i dilte në dyluftim Kuzmanit, ku edhe e humb jetën. Po ashtu Jakupine përshkruan si krahërogrjerë dhe të pamposhtur, ndërsa Rushitine përshkruan si valltarë eshehir dhe siluftëtar shumë të guximshëm dhe trim. Për Selmanin thotë se ai ka mbajtur “mjekër të bardhë” dhe e ka marrë gjakun etë vëllait, duke e vrarë Aliun. Ahmetin e nxjerrë si njeri shumë të nderuar, i cili e vret kadiun në pikë të ditës, sepse ai donte ta përdhunojë një grua të një fqinji. Abdurahami, sipas tij, “e qëllonte edhe zogun duke fluturuar”, ndërsa ishte i njohur si miqësor, i besës dhe mbrojtës i njerëzve nga kërkimi i pushtetit. Sulejmani, sipas autorit, i adhuronte shumë armët, sidomos shpatën, për çka e kishte shitur edhe tokën. Çan Joku, sipas tij, ishte njeriu më miqësor, shtëpia e të cilit çdoherë ishte e hapur, ndërsa ai ka bërë jetë në fshat me banorë të përzier – të krishterë dhe myslimanë. Për të ai thotë:

*“Festa të përbashtka festojnë;  
edhe hoxha dhe prifti në varre të njëjtë  
rituale kishtare këndojnë.”*

Për Përliçevin është më se e evidentese atje ku niveli kulturor ishte i ulët, autoritetin e merrte ndërgjegjja fetare. Në zonat e thella malore feja ka qenë e zbehtë, por për Përliçevin harmonia fetare është një nga pikësnyimet kryesore si një nga vlerat kulturore e civilizuese.

G. Përliçevisi personazh më të fuqishëm e jep plakun shqiptar, i cili bashkë me tre shokë e dërgon kufomën e Kuzmanit në familje dhe rrëfen për luftën që bëri Kuzmani në Stanë. Këtë personazh e përshkruan si një njeri me qëndrim, i cili flet për heroizmin e Kuzmanit si një kapedan i cili luftonte për të drejtën, për mbrojtjen e varfërve dhe të atyre që nuk i përkisnin besimit të njëjtë fetar dhe, sipas tij, edhe pse ishte i taborit tjetër, nga goja e tij dilte thënia popullore “trimin vraje, por hakun mos ia ha”, andaj e lartëson dhe i shpreh ngushëllime. Ja si do të përshkruajë Përliçevi:

*“Gjithë ditën të vajtosh, ke për çka.  
Bëhu e fortë!  
Ti humbe nënë një xhin!  
Populli do t’i këndojë, brezi pas brezi, ....  
Për veprën e djalit tënd!...”*

Përliçevi, në mënyrë objektive, në asnjë mënyrë nuk i nënçmon, por – përkundrazi – ai i lartëson shqiptarët me të gjitha karakteristikat morale dhe nacionale. Ai i nxjerrë në pah virtytet e shqiptarëve pa dallimefetare, siç janë: besnikëria, mosnënshtrimi, dashuria ndaj atdheut, trimëria e krenaria, guximi e gatishmëria, besimi e besa, humanizmi e solidariteti, që sot e kësaj dite janë vlera e norma jetësore të shqiptarëve trashëguara brez pas brezi. Në veprën tjetër “Autobiografia” ai i lartëson edhe ata shqiptarë të myslimanizuar, si: hoxhën, mësuesin, plakun Emin etj., të cilëve do t’ua japë të gjitha karakteristikat dhe virtytet shqiptare pa dallim feje, si: heroizmi, morali, guximi, besa, humanizmi, toleranca, trimëria etj.

Përveç grabitjeve të bandave, Përliçevinuk paraqet asnjë element tjetër për konflikt ndërmjet të krishterëve dhe myslimanëve, pos në një rajon që ai e quan Malësi, që përfshin anën e djathtë të Drinit të Zi, gjegjësisht fshatrat e Rekës (shih shënimin Alfa). Poeti Përliçev nuk i identifikon grupet e kaçakëve me popullin shqiptar. Por, ai i paraqet shqiptarët në mënyrë objektive edhe në veprën “Autobiografia”, ku në një farë mënyre distancohet nga grupet e kaçakëve dhe i sheh shqiptarësi njerëz të besës e të fjalës së dhënë e luftëtarë të denjë. Këto karakteristika shihen nëpërmjet personazhit Emin, që ishte zëdhënës i osmanlinjve.

Përliçevi i këndon heroizmit të luftëtarëve shqiptarë dhe prijësit të tyre, Skënderbeut, i cili jepet edhe si mbrojtësi i popujve të tjerë të Europës. Vepra “Skenderbeu” përshkohet nga ide të fuqishme çlirimtare e demokratike. Për një luftë të drejtë ishte më se bindur se pa pjesëmarrjen e popujve të robëruar osmanlinjtë nuk mund të largoheshin nga Ballkani. Liria nga ata – sipas tij – mund të fitohet vetëm nëse jemi të bashkuar jo vetëm me shqiptarët, por edhe me tërë popujt e Ballkanit, ashtu siç ishin në kohën e Skënderbeut.

Atëherë pa dallim feje të gjithë ishin një tog, jo vetëm shqiptarët, por edhe popujt e tjerë të Ballkanit:

*“Shumë popuj fqinjë, të etur për liri  
fuqitë e veta i kanë bashkuar, pse para tyre  
rrezik është; edhe djalli ishte i përbashkët  
luftëra vitezësh, çdoherë bashkë kanë bërë”<sup>14</sup>*

Përveç që i bëri ballë për 24 vjet kësaj fuqie, edhe kur osmanët ishin nëzurmën më të madhe të luftërave, Skënderbeu i bashkoi të gjithë shqiptarët, por edhe të krishterët e Ballkanit: maqedonas, serbë, vllahë etj. Ai habitet qësot kemi ardhur deri tëvëllavrasja e gjakderdhja në mes veti. Poeti e paraqetSkënderbeun si hero nacional shqiptar.Për këtëdo të shkruajë:“Në shtëpinë e tij në Krujë qëndron shqiptarja dykrenoresi simbol nacional i shqiptarëve”.

Në poemën “Skënderbeu”Përliçevi lë përshtypjen e një kronikani të kohës së heroit shqiptar.Me poemën “Skënderbeu”aie prek temënkryesore, që është ballafaqimi i ushtrisë së Skënderbeut, i historisë, vlerave, moralit dhe fesë, që ai përfaqësonte si Gjergj Kastriot dhe i krishterë, me Ballaban Pashën dhe çfarë përfaqësonte ky pasha turk me origjinë shqiptare. Ai na jepepisode bardh e zi ndërmjet Skënderbeut dhe armikut të tij, Ballaban pashës. Skënderbeu është i Gjon Kastriotit, kurse Ballabani i “lëvruesit” Gjikas. Skënderbeu posedon disa veti, si: i qetë, i afërt, i mbledhur e human, kurse Ballabani ështëi nxituar, i ashpër, ambicioz, hakmarrës, jotolerant, nuk zgjedh mjete për ta arritur qëllimin,është frikacak dhe në shërbim të sulltanit për të derdhur gjak ndërmjet popullit shqiptar. Në anën tjetër, Skënderbeu është i patrembur, hero, i durueshëm,shpirtmadh, gjakftohtë dhe çdo veprim i tij është i menduar mirë. Ai nuk pranon dhurata dhe është në shërbim të popullit. Figura e Skënderbeut ngrihet në pedestalin e heronjve më të mëdhenj jovetëm në Ballkan, por edhe në Evropë e më gjerë.

Hakmarrja nuk është ves i Skënderbeut, por virtyt i lartë i shqiptarit, andajnë konak të tij edhe hasmit nderohen si miqtë vërtetë. Një ushtar i tregon Skënderbeut për vrasjen e ushtarit Dimko nga Ballabani. Edhe pse Emini i tregon për këtë vrasje, ai mërrolet në

---

<sup>14</sup>Г. Прличев, Скендербег, препев: Ѓорѓи Сталев, Скопје, 1953

fytyrë, e ndërron çehrendhe fillon t'i dridhet zemra. Atij Skënderbeu do t'i drejtohetme këto fjalë:

*“Çlirohu dhe uli t’rrahurat e zembrës Emin i pahshëm,  
Dhe qetësohu lirisht si t’ishe në shtëpinë tënde.  
Se ti je në tryezë dhe n’bukë të shqiptarëve të ndershëm,  
Të cilët për besë e nderë s’largoheh kurrë prej vdekje”.<sup>15</sup>*

Përliçevi, si një romantik, jo që gjeti temat dhe motivin aktual, por gjeti edhe format e shprehjesinovative, andaj në asnjë vend nuk e dhunon vargun, por lirshëm këndon si në një simfoni tëlidhjessë trupit me shpirtin, që natyrshëm troket butë në zemra të ndjeshme njerëzore, “duke sjellë njëkohësisht edhe një erë të ngrohtë paqësimi. Të tillë janë poetët. Ata nuk punojnë e mendojnë vetëm në gjallje, por edhe në vdekje. Ata nuk mendojnë vetëm për ditët, por edhe për shekujt. Për ta s’ka kufij”<sup>16</sup>. Skënderbeu ishte një figurë e tillë universale, që në thelb ka bashkimin e jo ndarjen. Ai ia dhatharmin frymës kozmopolite, që është karakteristikë e poetëve, veçanërisht e poetëve të mëdhenj.<sup>17</sup>

Grigor Përliçevi, si një intelektual i kohës dhe si njohës i mirë i gjuhës helene (greke), por edhe si fitues i “Kurorës së artë”, kishte simpati jo vetëm sepse me këtë gjuhë dallohej intelektual i ose njeriu i kulturuar, qëkishte një prestigj shoqëror. Ai e pranon gjuhën shqipe si gjuhë të shqiptarëve pa dallim feje e krahinedhe hap shtegun përbisedime ndërmjet filologëve, porshpreh mendiminse këto dy gjuhë duhet të afrohen, që gjuha shqipe dhe gjuha e vjetër helene të ndikojnë në forcimin e bashkimin ndërmjet këtyre popujve” (shih shënimin Vita). Duke marrë për bazë atë që ka shkruar Përliçevi, veprat e tij nuk mund të vendosen rreptësisht në kufijtë e një kulture nacionale, por ato krijojnë një model “specifik që ka konotacion gjithëballkanik”<sup>18</sup>. Prandaj mund të konkludohet se

<sup>15</sup> Spiro Çomora, Një këngëtar i madh i Skënderbeut, “Flaka e vëllazërimit”, Shkup, 1967, VI-VII.

<sup>16</sup> Zilyftar Hoxha **March 9, 2014 12:44**: <http://www.gazetadita.al/grigor-perlicev-dhe-poema-e-tij-homerike-per-skenderbeun/>

<sup>17</sup> По ату.

<sup>18</sup> Весна Мојсова – Чипушева, Компилација на културната текстуалност, Книжевниот подвиг на Глигор Прличев, Научна конференција, Скопје, 2010, fq.97

veprat e Grigor Përliçevit paraqesin një komunikim ndërkulturor që synon të bëjë një përpjekje të ekuilibrit të dallimeve ndërmjet njerëzve, bashkësive të ndryshme dhe besimeve religjioze, kjo si një nxitje për dialogun tolerant dhe drejtësi sociale.

## Summary

Parlichev in noway, objectively, belittles the Albanians, but on the contrary, he exalts them with all moral and national characteristics. He highlights the virtues of Albanians with out religious distinction, such as: loyalty, love for the homeland, bravery and pride, courage and willingness, faith and the word of honor, humanit and solidarity, which to this day are the values and living standards of Albanians, inherited from generation to generation. In conclusion, the Works of Grigor Parlichev represent an intercultural communication aimed at making an effort to balance the differences between people, different communities and religious beliefs, as an incentive for tolerant dialogue and social justice.

## LITERATURA

ÇOMORA, Spiro. Një këngëtar i madh i Skënderbeut, "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 1967, VI-VII.

НОХНА Zylyftar **March 9, 2014 12:44**: <http://www.gazetadita.al/grigor-perlicev-dhe-poema-e-tij-homerike-per-skenderbeun/>

KADACH, Dorothea. "Armatolos und "Serdarot" zurgrichischen und slavischen Fassung von Grigor S. Priličev sepischen Gedicht" In: Beitrage zur Sudosteuroopa-Forschung, Analablichdes II Internacionalen Balkanologen Kongresses in Athen, (7.V.1970, Munchen, 1970, p. 83-105)

VEGAS, Antun. Naša književnost u njezinih istorici u Problemi književnosti, Beograd, Prosveta, 1964, fq. 56.

ЈАЧОСКИ, Војислав. *Албанците во делата на Г. Прличев*, Бигорски научни собири и научен собир, Гостивар 1971, fq.83.

МОЈСОВА – ЧИПУШЕВА Весна, Компилација на културната текстуалност, Книжевниот подвиг на Глигор Прличев, Научна конференција, Скопје, 2010, fq.97

СТАЛЕВ, Ѓорѓи. Прличев 1893-1953, Скопје 1953.

ТОДОРОВСКИ, Гане. *За потребата од едно ново читање на Прличевата поема „Сердарот“*. Зборник на трудови, Живот и дело на Григор Прличев, Скопје, 1996, fq.22

ISSN 2671-3004

UDC\_929Pulevski, Gj.  
UDC 811.18(091)  
UDC 81'374  
Punim studimor

**Aslan HAMITI**

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi  
Fakulteti i Filologjisë 'Blazhe Koneski' Shkup, Maqedoni  
**aslan\_hamiti@yahoo.com**

**RËNDËSIA E "FJALORIT TRIGJUHËSH" TË GJORGJI PULEVSKIT**  
**IMPORTANCE OF GEORGE PULEVSKI'S "TRUTH GLOSSARY"**

**1. Hyrje**

Në këtë kumtesë do të trajtojmë rëndësinë e Fjalorit trigjuhësh të Gjorgji Pulevskit. Burim të dorës së parë gjatë punës sonë hulumtuese e kemi pasur Fjalorin trigjuhësh.<sup>19</sup> Jemi mbështetur edhe në monografinë "Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit"<sup>20</sup> si dhe në punime e studime të tjera për veprat e këtij autori.

Deri më sot janë bërë jo pak studime për gjuhën e veprave të shkruara në gjuhën shqipe, përfshirë edhe fjalorët dy- e më shumë gjuhësh. Mirëpo, është e nevojshme që ky lloj studimi filologjik të vazhdojë edhe më tej, për të ndriçuar gjithë trashëgiminë e teksteve

---

<sup>19</sup> Të dy fjalorët gjenden në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Shkupit me siglat: Fjalori katërgjuhësh – R II-1501/I, ndërsa Fjalori trigjuhësh – R II-1501/II dbl.

<sup>20</sup> Aslan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.

shqip. Këto studime janë dobiprurëse dhe do të hedhnin dritë mbi shumë çështje të historisë së shqipes së shkruar dhe përgjithësisht të historisë së gjuhës, zhvillimit të dialekteve dhe të të folmeve shqipe në rrjedhë të kohës. Rezultatet e arritura do të kenë vlerë të madhe për kulturën tonë kombëtare në përgjithësi si dhe për të pasqyruar marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera. Puna e këtillë do të jepte rezultate shumëdimensionale, kur dihet se shqipja është gjuhë e folur shumë herët, por mjerisht vonë e dokumentuar.<sup>21</sup>

## 2. Të dhëna të përgjithshme për Gjorgji Pulevskin (1838-1895)

Për jetën dhe veprimtarinë e Gjorgji Pulevskit është shkruar jo pak në maqedonisht e bullgarisht. Gjorgji, emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në disa variante: Gjorgjo, Gjorgjija, Gjorgje, Gjergj; dhe me mbiemrin Pulevski e Pula ishte leksikograf, poet, historian, mbledhës i folklorit, gramatikan dhe luftëtar i dalluar kundër perandorisë Osmane për çlirimin e popujve të robëruar. Në bazë të shënimeve të gjetura, por edhe sipas asaj që vetë autori ka shkruar në fjalorë, del se Pulevski qe autodidakt, me profesion murator, ose siç parapëlqente t'i thoshte vetes – arkitekt.

Lindi në Galiçnik më vitin 1838,<sup>22</sup> katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës. Viti i lindjes së Pulevskit vihet në dyshim, me supozim se ai duhet të ketë lindur së paku 15 deri më 20 vjet më parë.<sup>23</sup>

Do përmendur se Gjorgji luftoi kundër perandorisë turke si në territorin e Serbisë, ashtu edhe në tokat e Rusisë, duke menduar se njëherë nga këto troje duhet çrrënjosur sundimi osman e pastaj do të vijë koha kur edhe në Maqedoni dhe në pjesët e tjera të Ballkanit duhet zhvilluar një luftë e tillë. Ishte i mendimit se gjithë të

<sup>21</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 8.

<sup>22</sup> Bla`e Koneski, *Makedonistot \orji (\orjo) Pulevski*, Kulturen `ivot, mese~nik za kultura, prosveta, umetnost. Organ na rabotni~kata kulturno-prosvetna zaednica na Makedonija, godina VI, broj 2, Shkup, shkurt, 1961, f. 25.

<sup>23</sup> Bla`e Ristovski, *\orjija M. Pulevski*, Odbrani stranici, Makedonska kniga, Skopje, 1974, f. 5.

robëruarit duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse vetëm të bashkuar do të mund të çliroheshin.

Nga skica jetësore e Pulevskit kuptohet se ai mori pjesë në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore, që u bë në tetor të vitit 1878. Në këtë kryengritje ai ishte prijës i çetës VI dhe anëtar i Këshillit të vojvodëve. Në vitin 1878 ishte prefekt i Qustendillit dhe ditët e fundit të jetës së tij i kaloi në Bullgari. Në shoqërinë letrare sllavo-maqedonase („Славјанско-Македонска книжевна дружина“) me seli në Sofje, në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e krytarit. Në pleqëri, larg nga vendlindja, vdiq në qershor të vitit 1895 në Sofje ku dhe u varros.

Siç shihet, jeta e Pulevskit sillej në trekëndëshin Maqedoni - Serbi - Bullgari. Jeta dhe orientimi i tij revolucionar, patriotik e luftarak do të shprehen edhe në shkrime. Me pendë e pushkë në dorë luftoi kundër robërisë shumëshekullore turke dhe njëherit kontribuoi për bashkimin e popujve të shtypur në luftë të përbashkët kundër robëruesit të njëjtë.

### 3. Veçori të rëndësishme të Fjalorëve të Pulevskit

Dihet se Pulevski botoi dy fjalorë shumëgjuhësh: a) Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe b) Fjalor bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.<sup>24</sup> Për shkrimin e të gjitha paraleleve gjuhësore të fjalorëve është përdorur i njëjti alfabet. Teksti i këtyre fjalorëve, ashtu si edhe shkrimet e tjera para kodifikimit drejtshkrimor, nuk mbështetet në “një ortografi fonetike moderne, me ndarje morfologjike të fjalëve, por është një ortografi popullore e fonetikës

---

<sup>24</sup> “Re~nik отъ ~etiri jezika: I. Srpsko-Albanski. II. Arbanski-Arnautski. III. Turski. IV. Gr~ki. Skrojena i napisana отъ Ђорђа М. Пуљвски, архитекта у Гали~никъ, okru`je dibransko, 1872 godine. I-va ~astъ. Beogradъ. [тампарія N. Stefanoviћа i Dru`ine, 1873” (Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873).

“Re~nik od tri jezika: S. Makedonski, Arbanski i Turski. Kwiga II. Napisao Ђорђе М. Пулевски, мижак гаџи~ки. У Beograd, u dr`avnoj {tampariji, 1875.” (Fjalor tregjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875).

sintaktike.”<sup>25</sup> Autori ashtu siç e ka dëgjuar me veshë në ligjërimin popullor, ashtu e ka shënuar.

Vetë fakti se shkroi dy fjalorë: njërin katërgjuhësh e tjetrin tregjuhësh flet bindshëm se ai ishte poliglot, përkatësisht dinte maqedonisht, serbisht, bullgarisht, shqip, greqisht e turqisht. Pulevski kishte mendim të drejtë se në kushtet e bashkëjetesës e të simbiozës së disa popujve si dhe të përdorimit të disa gjuhëve në një territor të përbashkët është më se e nevojshme njohja reciproke e gjuhëve, e kulturës, e traditave dhe fqinjësia e mirë. Përveç kësaj, popujt kanë nevojë shumë të madhe për komunikim të drejtpërdrejtë, ku duhet jetësuar dygjuhësia dhe shumëgjuhësia.

Nga vetë titujt e veprave të Pulevskit, si edhe nga dy fjalorët e tij vërehen dy gjëra të rëndësishme. Së pari, rregullisht i shënon me shifra romake librat e vet: Fjalori katërgjuhësh sipas tij është libri I; Fjalorin trigjuhësh e shënon me II dhe Gramatikën me numrin III. Me atë që për Gramatikën thotë se është pjesa e parë, paralajmëron se ka ose do të ketë edhe pjesë të tjera të saj. Dhe meqenëse, Vjershëzat (Pesnarki) nuk i numëron, sipas gjithë gjasash ato janë jashtë serisë së paramenduar, ndoshta për një publikim më të gjerë.<sup>26</sup>

Së dyti, vërehen emërtime të larmishme për gjuhët. Sllavishten e shkruar në kolonën e parë në të dy fjalorët, që rezulton të jetë një maqedonishte e përzier me përplot serbizma, bullgarizma etj. e pagëzoi me termat *srpsko-albanski*, *s(lovensko)-makedonski*, *slavjansko-makedonski*, *slovenski*, *makedonski* etj. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në atë kohë nga qarqet serbe maqedonasit ende nuk njiheshin si komb e as maqedonistja si gjuhë kombëtare.<sup>27</sup>

Autori për shqipen përdori gjashtë emërtesa: *arbanski-arnautski* në ballinën e Fjalorit katërgjuhësh, ndërsa në brendi të tij disa terma të tjerë, si: *arbanski* – më se 66 herë, *arnautski* – 16 herë dhe vetëm 6 herë - *albanski*. Termin *arbanski* për emërtimin e shqipes e shkruan në kolonat e Fjalorit trigjuhësh, por në faksimilin e

<sup>25</sup> Eqrem Çabej, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) I, Tiranë, 1968, f. 93.

<sup>26</sup> Në tekstin e mëposhtëm Fjalorin katërgjuhësh do ta shënojmë me numrin romak I, ndërsa Fjalorin trigjuhësh me numrin romak II.

<sup>27</sup> Shih: Bla`e Koneski, *Bele{ki za Pulevski*, Makedonskiot XIX vek, Jazi~no i kni`evno-istoriski prilozhi, Shkup, 1986, f. 225-230.

po të njëjtit fjalor shkruan *shqip*. Këto emërtesa në shkencën albanologjike janë të njohura.<sup>28</sup>

Dy fjalorët e Pulevskit dallohen mjaft njëri nga tjetri si në strukturë, ashtu edhe në metodën e mbarështrimit si dhe në grafi. Fjalorin katërgjuhësh mund ta quajmë në një mënyrë si fjalor të mirëfilltë. Në kolonën e parë janë shënuar fjalët në maqedonisht e pastaj në kolonat gjegjëse për gjuhët e tjera është dhënë fjala e përkthyer.

Fjalori katërgjuhësh ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të ndryshme, ky fond i fjalëve është më i vogël. Ky fjalor ka 98 faqe të formatit 14 x 17 cm. Fjalori është i ndarë në 74 qerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Kështu, fjala vjen, aty ka leksema “për perëndinë dhe mirësinë e tij” nga faqja 12 deri në faqen 14. Pastaj kapituj me fjalë nga sfera e gjithësisë, emërtime gjeografike, gurë e metale; emërtime të kohës dhe të ditëve; numrat themelorë; fjalë e shprehje të veshmbathjes; fjalë nga sfera e orendive shtëpiake dhe e enëve; fjalë nga sfera e blegtorisë, emra drurësh, tituj e profesione njerëzish, emërtime veglash e sendesh, emërtime njerëzish për nga mosha e pamja e jashtme (ngjyra e lëkurës); shprehje përsëritëse, fjalë pa ndonjë lidhje me botën materiale etj.

Në fund të librit janë dhënë përmirësimet e gabimeve teknike e në tri faqet e fundit janë shënuar emrat e parapaguesve të fjalorit me të dhënat për profesionin, adresën si dhe numrin e ekzemplarëve të paguar, përkatësisht emrat e njerëzve që e financuan botimin e librit.<sup>29</sup>

Fjalori trigjuhësh (Fjalor nka tre g-juha) është i formatit 14 x 20 cm me gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: sllavisht (maqedonisht), shqip dhe turqisht me fjali e periudha të tëra, pra me tekst të kontinuar. Kjo mënyrë e hartimit të

---

<sup>28</sup> Për këto shih në: Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 85-88; Rexhep Ismajli, *Emri i shqiptarëve*, në Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 96-104 etj.

<sup>29</sup> Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shup, 2005, f. 29.

fjalorit mundëson të bëhet vështrim mbi strukturën gjuhësore të këtij fjalori, pikëpamjet e botëkuptimit e autorit për popujt e gjuhët e Ballkanit.

Ky fjalor i përgjigjet një enciklopedie të kohës me njohuri të llojllojshme nga religjioni, filozofia e jetës, historia, gjeografia etj. Sipas Bllazhe Koneskit, Pulevski në 91 faqet e para të Fjalorit trigjuhësh e ka shfrytëzuar në tërësi (me ndonjë ndryshim të vogël e përshtatje) tekstin e Kuzman Shapkarevit (1834-1909) “Mësimet fillestare për fëmijët e vegjël”, botuar në Stamboll më vitin 1868.<sup>30</sup>

Krahas burimit të zbuluar për 90 faqet e para të Fjalorit trigjuhësh, është konstatuar se Pulevski ka shfrytëzuar edhe modele të tjera. Kështu, prej faqes 93 deri në faqen 128 hetohet se Pulevski ka shfrytëzuar ndonjë shkrim serb, që vërehet sidomos në modelet gjuhësore. Nga faqja 127-157 gjendet një regjistër fjalësh sipas alfabetit, të hartuar nga autori.

Model për përpilim të tillë të fjalorit, autori ka mundur të gjejë edhe në bisedat dhe dialogjet e banorëve të Rekës si dhe te banorët e vendeve të tjera, veçmas në malësinë e gegërisë. Për diskutime, debate, pleqni e filozofi popullore është e njohur veçmas oda shqiptare e vlerësuar si “fakultet i popullit”, sidomos atëherë kur përvoja njerëzore, dija, trashëgimia mendore e kulturore ndër ne është bartur kryesisht përmes traditës gojore.

Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (me disa shkronja të alfabetit glagolik të serbishtes e të rusishtes), ndërsa në Fjalorin tregjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit. Si vepra të shkruara në shekullin XIX, kanë rëndësi të madhe dhe mund të shfrytëzohen si material burimor i kohës për të trajtuar çështje gjuhësore, kulturore e historike.<sup>31</sup>

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Ka raste kur ky përkthim, qoftë në Fjalorin

---

<sup>30</sup> Bla`e Koneski, *Kon makedonskata prerodba*, Makedonskite u~ebnici od XIX vek, Institut za nacionalna istorija, Shkup, 1959, f. 90.

<sup>31</sup> Të dy fjalorët gjenden në Bibliotekën Popullore dhe Universitare të Shkupit me siglat: Fjalori katërgjuhësh – R II-1501/I, ndërsa Fjalori trigjuhësh – R II-1501/II dbl.

katërgjuhësh, qoftë në Fjalorin tregjuhësh, është i qëlluar, kuptohet me bazë gjuhësore të të folmes së Dibrës me rrethinë. Por, megjithkëtë, fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam).

Gjorgji Pulevski ishte njohës i disa gjuhëve sllave e josllave, kompetenca të nevojshme gjuhësore për hartimin e fjalorëve shumëgjuhësh. Si poliglot autodidakt në shkrimet e tij shpeshherë nuk ka mundur t’i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërgjuhësor. Interferenca te individët shumëgjuhësorë siguron material burimor shumë të dobishëm për të bërë hulumtime sociolinguistike e ballkanologjike me të cilat do të kishim prurje të reja ndër ne në praktikën dhe teorinë e gjuhëve në takim.

Në bazë të studimeve gjuhësore është përdëftuar se forma më e shpejtë dhe më masive e ndikimit ndërgjuhësor është huazimi leksikor. Kështu, edhe në fjalorët e Pulevskit, në ndikimet ndërgjuhësore që janë pasojë e plurilinguizmit individual të autorit, në të gjitha rrafshet, padyshim leksiku zë një vend mjaft të rëndësishëm. Aty do të gjejmë një numër të madh fjalësh që janë të përbashkëta për shqipen, maqedonishten, turqishten e greqishten si dhe për gjuhët e tjera ballkanike; pastaj huazime leksikore sllave në gjuhën shqipe, albanizma në paralelen e maqedonishtes, orientalizma e greqizma në shqipen e në sllavishten etj.

Fjalori tregjuhësh fillon me një bisedë (maq. razgovor, shqip kuvend dhe turq. muhabet) dhe mandej vazhdon me pyetje (maq. pitanje, shq. pjutmea e turq. suval) dhe përgjigje (maq. odgovor, shq. u prxheq e turq. xhuvab).

Në të dy fjalorthët shumëgjuhësh kolona e maqedonishtes së përzier me gjuhë të tjera sllave është bazë, e cila është përkthyer në dy-tri gjuhët e tjera. Mirëpo, në Fjalorthin trigjuhësh autori herë-herë iu është shmangur paraleles maqedonase, duke u përpjekur ta ruajë origjinalitetin e çështjeve që shtjellon, varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, bie fjala, në f. 49 kur bën fjalë për popujt dhe atdheun e tyre, në shtyllën e maqedonishtes thotë se: maqedonasit janë popull dhe se atdheu i tyre quhet Maqedoni, ndërkaq në

paralelen e përkthyer në shqipen shkruan se tash jo maqedonasit, por shqiptarët janë popull që jetojnë edhe në Maqedoni: maqedonisht: *“Taka i makedoncive se narod i mestovo njihovno je Makedonija. Shqip: Ashtu ede shkipitarat jan njeraz ede vendin etijse po thojn Makedonija, cili po roin aqe.”*

Edhe kur shtjellon huazimet leksikore në të tri gjuhët (në gjuhën maqedonase, shqipe e turke, f. 92) Pulevski shënon leksema krejtësisht të tjera. P.sh. në kolonën e maqedonishtes shkruan: *“Tugji zborovi se ami, frishko, onomad, par i priçija”*. Në kolonën e shqipes shkruan: *“Vetmi fjal jan jeshil, kapacina, profet edhe kallo”*. Pastaj vazhdon më tutje, duke i shpjeguar këto huazime, varësisht nga gjuha dhe fjalët që i ka shënuar për të huaja, si maq. *ami* – thotë se është fjalë greke, ndërsa në shqipen: *“jeshil ashtë fjal turqisht, apo na thom verdh”* dhe kështu vazhdon më tutje.

Nga faqja 41-48 të Fjalorit II ku trajtohen çështje për ardhjen e sllavëve në Gadishullin Ballkanik, shtrirjen hapësinore, ndarjen e tyre në popuj, degëzimin dialektor të maqedonishtes etj., teksti është shkruar vetëm në maqedonisht, pa u përkthyer fare as në shqip e as në turqisht. Gjykojmë se kjo pjesë nuk është përkthyer sepse autorit i është dukur se kjo tematikë është e parëndësishme për shqiptarët dhe turqit.

Për nga metodologjia e hartimit, dallohet edhe pjesa e fundit e Fjalorit II ku nga faqja 113 deri në faqen 118 është dhënë pasqyra e alfabetit të përdorur në këtë fjalës, duke dhënë disa përskrime nyjetimore të tingujve themelorë të paraqitur me shkronjat e alfabetit të tij. Artikulimi i tingujve është përskruar në mënyrë popullore e laike. Prej faqes 121 deri në faqen 128 përsëri kthehet në pyetje e përgjigje e më pas në 30 faqet pasuese jepet një fjalorth në afro 30 faqe (f. 128-157) me fjalë të radhitura sipas alfabetit cirilik të modifikuar, ku kemi edhe një përpjekje për paraqitje gramatikore të fjalëve, me ndarje dhe shënim të formave të mundshme të tyre.

Në pesë faqet e fundit të Fjalorit II (163-167) janë shkruar emrat e parapaguesve, profesioni i tyre, adresa e numri i kopjeve të porositura dhe përmbajtja. Sipas kësaj liste të gjatë, mund të shihet se interesimi i njerëzve për këtë Fjalorth qe i madh. Pason një

përshëndetje mirënjohëse kushtuar parapaguesve dhe njëherit autori bën thirrje për t'u parapaguar (ose për ta financuar) e ndihmuar materialisht botimin e një abetareje në katër gjuhë: turqisht, sllavisht, latinisht dhe greqisht. Ndërkaq, këngë dhe zakone të kombeve e kombësive të sllavëve të jugut, Pulevski sipas kësaj që ka shënuar, e pati planifikuar t'i publikojë për një rreth më të gjerë lexuesish.

#### 4. Fjalori trigjuhësh - enciklopedi e vogël popullore e kohës

Fjalori trigjuhësh është ndarë në tema të ndryshme me sfera të veçanta leksikore. P.sh. ka një hyrje, pastaj shkruhet për vetitë psiko-fizike të njeriut, për bimët e kafshët, për xehet dhe lëgurat, për kontinentet e botës, yjet, për fenomenet natyrore, për banorët e Galicnikut etj.

Në bazë të kësaj, mund të themi se Fjalori trigjuhësh paraqet një enciklopedi të vogël popullore të kohës.

Si Fjalori trigjuhësh, ashtu edhe ai Katërgjuhësh të Pulevskit janë edhe një dëshmi se shqipja u shkrua, përveç me alfabetin latin, arabo-turk, grek edhe me alfabetin cirilik. Siç dihet, shkrimi i shqipes me alfabet cirilik ka një traditë jo të gjatë. Kështu, si i pari dokument me alfabet cirilik merret mbishkrimi trigjuhësh që gjendet mbi derën e manastirit të "Shën Vlladimirit" të Elbasanit, ndërtuar nga princi shqiptar Karl Topia më 1381. Përpyekjet e para për të shkruar shqipen me alfabet cirilik i bënë Papa Totasi ose Anonimi i Elbasanit, beratasi Kostë Berati, Teodor Haxhi Filipi etj.<sup>32</sup> Shqipen e ndeshim edhe në një fjalor Katërgjuhësh: greqisht-arumanisht-shqip dhe maqedonisht nga voskopojari Pop Danailli, botuar në Veneci më 1794, botimi I dhe më 1802 botimi II. Shqipen me alfabet cirilik e shkruan edhe Gjorgje Pulevski, Kuzman Shapkarevi etj.

Të dy fjalorët e Pulevskit, vështruar në retrospektivën kohore, patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këtë konstatim mund ta mbështesim në disa fakte:

Fjalorët patën karakter praktik, d.m.th. se u hartuan për nevojat praktike të popullatës së Ballkanit, por edhe më gjerë; për të

---

<sup>32</sup> Dr. Petro Janura, *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969, f. 43-56.

nxënë disa gjuhë ballkanike (maqedonishten, shqipen, greqishten e turqishten), për komunikim të ndërsjellë, njohjen reciproke të gjuhëve dhe të kulturave, por edhe për afrimin e tyre.

Komunikimi i njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme është më se i nevojshëm edhe për Pulevskin. Të përkujtojmë me këtë rast konstatimin e njohur të gjuhëtarëve se njohja e disa gjuhëve ka pasoja pozitive edhe në intelegjencë. Përvoja në dy e më tepër sisteme gjuhësore ndikon që personi i tillë të ketë fleksibilitet më të madh mendor, superioritet në përpilimin e ideve si dhe shumë më tepër zgjedhje të aftësive mendore nga njeriu që di vetëm një gjuhë.

Njeriu që zotëron disa gjuhë e vështron botën në disa pikëpamje të ndryshme. E në fund, mjedisi me dy e më tepër gjuhë e kultura mundëson që njohësi i këtyre gjuhëve të fitojë përvojë më të pasur e më të llojlojshme. Prandaj, bashkëjetesa, kontaktet e përditshme të popullatës në anët e Maqedonisë Perëndimore ndërmjet folësve të disa gjuhëve ka krijuar domosdonë e hartimit të fjalorëve shumëgjuhësh. Ja se çfarë shkruan Pulevski për rëndësinë e njohjes së gjuhës amtare dhe të gjuhëve të tjera në Fjalorin tregjuhësh:

<p>RE^NIK OD TRI JEZIKA S. MAKEDONSKI ARBANSKI I TURSKI</p> <p>KWIGA II NAPISAO</p> <p>Ђорѓе М. Пуѓевски</p>	<p>FJAQTOR NKA TRE GJUHA [KINI[T MAKEDONISE [KIP EDE TUR^I[</p> <p>Qiberti II EKA[RUU Ђорѓи Пуѓес</p>	<p>FJALTOR NKA TRE G'JUHA SHKINISHT MAKEDONISE SHKIP EDE TURÇISH Liberti II</p> <p>EKA SHRUU Gjorgji Pules</p>
<p>MIJAK GAQI^KI U BEOGRAD 1875</p>		
<p>S. Makedonski maqedonisht</p>	<p>Arbanski ili arnautski shqip</p>	<p>Transliteruar me alfabetin e sotëm të shqipes</p>
<p>Razgovor</p>	<p>Kuvend</p>	<p>Bisedë</p>

<p>Znawa na mnogu jezika, da je potrebno, za svakoga ~oveka, od najvi{eg do najni`eg reda, koji stranstvuje u dana{wja vremena, ovo sam kazao i u prvoj kwizi.</p> <p>Drugo, govorio sam, kako treba dosta vremena, dok materwi jezik utvrdimo, saznamo i izobrazimo, to treba u~initi, jer tako zdravi razum iziskuje, pak potom i drugi jezika po potrebi da u~imo.</p>	<p>Ma{um gjuha, tadijm, n a{te nkaduhet, prepas vet werji nka mate naqti, herte mate unhet, arada, ciqi po{konaana tevetui, nde moti sotis, kijo, kamθa, ede nde qiberti paras.</p> <p>Ʀeter ekam kuvendova, sipoduhet, {um mot, hertafortoim, ede gjuha te nonas tonte, tatwofim, ede tat msoim, ajo poduhet, prepas vet, tabaroim, pse a{tu pas mend, {indo{i, krkoje, por pastai, ede heter gjuha, paste duhet, vetis, tamsoim.</p>	<p>Mashum g-juha, tadijm, n ashte nkaduhet, prepas vet njerji nka mate nalti, gjerte mate ungjet, aradha, cili poshkon naana tevetui, nde moti sotis, kijo, kamtha, edhe nde liberti paras.</p> <p>Qeter ekam kuvendova, sipoduhet, shum mot, gjertafortojm, edhe g-juha te nonas tonte, tatnjofim, edhe tat msojm, ajo poduhet, prepas vet, tabarojm, pse ashtu pas mend, shindoshi, krkoje, por pastaj, edhe qeter gjuha, paste duhet, vetis, tamsojm.</p>
---	--	--

Nga fjalorët del konstatimi se gjuhët duhet të jenë të barabarta, d.m.th. duhet zbatuar dygjuhësia e shumëgjuhësia e jo diglosia, qëndrim ky më i drejti për mjediset shumëgjuhësore. Nuk është e rastit zgjedhja e gjuhëve: maqedonisht, shqip, turqisht e greqisht. Të rikujtojmë se në atë kohë greqishtja ka qenë gjuhë e arsimit, e kulturës etj., turqishtja – gjuhë e administratës shtetërore; ndërsa shqipja e maqedonishtja gjuhë amtare e popullsisë së Maqedonisë si dhe gjuhë e komunikimit të përditshëm në kushtet e bashkëjetesës së shqiptarëve me maqedonasit.

Fjalorët kanë rëndësi leksikografike, meqë përbëjnë një nga hallkat në vargoin e leksikografisë shumëgjuhëshe. Edhe pse në Fjalorë nuk është pasqyruar me besnikëri shqipja e kohës, d.m.th. format e fjalëve e të fjalive duhet marrë me rezervë, megjithkëtë

mund të thuhet se të njëjtit kanë rëndësi gjuhësore, sepse këtu e gjejmë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX. Aty na paraqiten disa forma të vjetra të shqipes, ka tipare të të folmes së qarkut të Dibrës, tipare gjuhësore të të folmeve të tjera gege, një numër të vogël veçorish gjuhësore të të folmeve toske, por edhe kalke, forma e fjalëkrijime që nuk u pranuan, nuk u përvetësuan apo edhe nuk u bënë pronë e mbarë shqipes.

Megjithë mangësitë që ka, shqipja e Pulevskit siguron një material të shkruar për të vëzhguar gjuhën dhe stilin e tij, për të parë zhvillimin historik të të folmes së Dibrës, e bashkë me shkrimet e tjera të kohës, për të plotësuar rrjedhën kohore të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore e më gjerë. Meqë është fiksuar një shqipe e shekullit XIX, Fjalorët mund të plotësojnë një pjesë të mozaikut për ecurinë kohore të dialekteve dhe të të folmeve shqipe, historinë e shqipes së shkruar e të historisë së gjuhës në përgjithësi.

Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike.

Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

Materiali i dy Fjalorëve është shfrytëzuar në punimin e Aleksandër Beliqit “Dialekti i Galiçnikut”, Beograd, 1935 si dhe nga studiues të shumtë, si nga Bllazhe Koneski, Bllazhe Ristovski, Harallampie Polenakoviç, Trajko Stamatovski, Tome Sazdov, Olivera Jashar – Nasteva, Viktor Fridman, Petro Janura, unë etj. Megjithëkëtë, veprat e Pulevskit sigurojnë material për studime të mëtejme ballkanistike e multidisiplinare.

## Përmbledhje

Gjorgji Pulevski (1817-1895) njihet si leksikograf e poliglot. Lindi në Galiçnik (viti i lindjes nuk dihet me saktësi, por lëviz për 15 deri më 20 vjet), katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës në Maqedoni. Vetëm fëmijërinë e hershme (deri në moshën kur kishte shtatë vjet) jetoi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën tjetër të jetës e kaloi në kurbet, përkatësisht në Rumani (në vendin e quajtur Turno-Mogurell), Serbi (Beograd) e Bullgari (Sofje).

Mori pjesë në disa luftëra e kryengritje serbe, bullgare e maqedonase kundër perandorisë osmane (në anën e rusëve në luftën ruso-turke (1877/78); në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore (në tetor të vitit 1878); në vitin 1878 ishte prefekt i Qustendillit; në shoqërinë letrare sllavo-maqedonase me seli në Sofje në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e kryetarit. Vdiq dhe u varros në Sofje (1895).

Ai qe autodidakt, murator, por la gjurmë si leksikograf. Botoi dy fjalorë shumëgjuhësh: a) Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe b) Fjalor bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

Fjalori katërgjuhësh ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe. Fjalori trigjuhësh është i tipit pyetje - përgjigje, që mund të quhet fjalor bisedimor, i ndarë në 74 çerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (tani të serbishtes e rusishtes), ndërsa në Fjalorin trigjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit.

Si vepra të shkruara në shekullin XIX, kanë rëndësi të madhe dhe mund të shfrytëzohen si material burimor i kohës për të trajtuar çështje gjuhësore, kulturore e historike.

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështruar në tërësinë e trashëgimisë sonë leksikografike, duhet të zënë vendin e merituar në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen edhe në historinë e leksikografisë maqedonase, shqiptare, turke dhe greke.

Fjalorët patën rëndësi relativisht të madhe praktike, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për gjuhët dhe kulturat ballkanike si dhe për ballkanologjinë në përgjithësi. Këta Fjalorë, na sigurojnë material të vlefshëm për të parë jo vetëm 3-4 gjuhë ballkanike në shekullin XIX, por edhe për kulturën e popujve të Ballkanit, përpjekjet e tyre për çlirim nga robëria, fqinjësinë e mirë, njohjen dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet popujve të Ballkanit.

Me këta dy fjalorë Pulevski promovoi jo vetëm shumëgjuhësinë, por edhe barazinë midis gjuhëve e popujve, mirëqenien e bashkëjetesën në Ballkan, multikulturalizmin dhe interkulturën, vlera këto që duhet të kultivohen në çdo kohë e në çdo shoqëri.

Fjalët kyçe: shumëgjuhësi, multikulturalizëm, bashkëjetesë, kulturë, vlerë, rëndësi.

## Summary

George Pulevski (1817-1895) is known as a lexicographer and polyglot. He was born in Galichnik (year of birth is not known precisely, but moves for 15 to 20 years), a village of Little Reka in the county of Debar in Macedonia. Only early childhood (up to the age of seven) lived in the district of Debar, while he spent the rest of his life in the foreign countries, namely Romania (in the place called Turno-Mogurell), Serbia (Belgrade) and Bulgaria (Sofia).

He participated in several wars and uprisings of the Serbian, Bulgarian and Macedonian uprisings against the Ottoman Empire (on the side of the Russians in the Russo-Turkish War (1877/78); the Kresnen uprising in Eastern Macedonia (in October 1878); prefect of Qustendill; in the Slav-Macedonian literary society based in Sofia in 1888 Pulevski served as mayor. He died and was buried in Sofia (1895).

He was an autodidact, a bricklayer, but left a mark as a lexicographer. He published two multilingual dictionaries: a) A multilingual dictionary: Macedonian-Albanian-Turkish-Greek,

Belgrade, 1873; and b) Trilingual Conversational Dictionary: Macedonian-Albanian-Turkish, Belgrade, 1875.

The four-language dictionary has approximately 2,560 words and expressions in Albanian. The three-language dictionary is a question-answer type, which can be called a conversational dictionary, divided into 74 parts, with different lexical spheres. The four-language dictionary has been printed with the traditional Cyrillic alphabet (now Serbian and Russian), while the reformed Cyrillic alphabet of Vuk Karadžić has been used in the Trilingual Dictionary.

As works written in the 19th century, they are of great importance and can be used as a source material for dealing with linguistic, cultural and historical issues.

Pulevski's two multilingual dictionaries, looking at the entirety of our lexicographic heritage, should occupy the deserved place within the multilingual dictionaries of the time and generally be noted in the history of Macedonian, Albanian, Turkish and Greek lexicography.

Dictionaries were of great practical importance, just like any other multilingual dictionary. Both dictionaries have historical value for Balkan languages and cultures as well as for Balkanology in general. These Dictionaries provide us with valuable material to see not only 3-4 Balkan languages in the 19th century, but also about the culture of the Balkan peoples, their efforts for liberation from bondage, good neighborliness, and mutual respect among peoples. of the Balkans.

With these two dictionaries, Pulevski promoted not only multilingualism, but also equality between languages and peoples, well-being and coexistence in the Balkans, multiculturalism and interculturalism, values that must be cultivated at all times and in every society.

Keywords: multilingualism, multiculturalism, coexistence, culture, value, importance.

## Literatura e konsultuar:

- Çabej, Dr. Eqrem, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987.
- Çabej, Eqrem, *“Meshari” i Gjon Buzukut (1555) I*, Tiranë, 1968.
- Hamiti, Asllan, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.
- Ismajli, Rexhep, *Emri i shqiptarëve*, në Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987.
- Janura, Dr. Petro, *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969.
- Koneski, Bla`e, *Kon makedonskata prerodba*, Makedonskite u`ebnici od XIX vek, Institut za nacionalna istorija, Shkup, 1959.
- Koneski, Bla`e, *Bele{ki za Pulevski*, Makedonskiot XIX vek, Jazi~no i kni`evno-istoriski prilozhi, Shkup, 1986.
- Pulevski, M. Ђорђе, *Re~nik otъ ~etiri jezika: I. Srpsko-Albanski. II. Arbanski-Arnautski. III. Turski. IV. Gr~ki*. Skrojena i napisana otъ Ђорђа M. Pulevski, arhitekta u Gali~nikъ, okru`je dibransko, 1872 godine. I-va ~astъ. Beogradъ. [tampariя N. Stefanoviha i Dru`ine, 1873” (Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873).
- Pulevski, M. Ђорђе, *Re~nik od tri jezika: S. Makedonski, Arbanski i Turski*. Kwiga II. Napisao Ђорђе M. Pulevski, mijak gaqi~ki. U Beograd, u dr`avnoj {tampariji, 1875.” (Fjalor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875).
- Ristovski, Bla`e, *\or/ija M. Pulevski*, Odbrani stranici, Makedonska kniga, Skopje, 1974.

**Nebi DERVISHI**

**Universiteti i Tetovës, Tetovë**  
nebi\_dervishi@hotmail.com

**KONTRIBUTI I JOSIF BAGERRIT PËR GJUHËN DHE KULTURËN  
SHQIPE NË REKËN E EPËRME**

**CONTRIBUTION OF JUSUF BAGERI FOR THE ALBANIAN CULTURE  
AND LANGUAGE AT THE SO CALLED PLACE "REKA E EPERME"**

Prej kohës e kamë bërë objekt studimi Josif Bagerrin, veprimtarine spikatur të Rilindjes sonë Kombëtare, nga Nistoria e Rekës së Epërme, i cili iu përkushtua atdheut në një nga periudhat më të rëndësishme historike të Shqipërisë, siç ishte pragu i Shpalljes së pavarsisë, periudhë kjo që u përgatit nga Lëvizja jonë Kombëtare që me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Me veprimtarinë e tij të shumanshme politike, organizative, publicistike, ideologjike, artistike, kulturore dhe arsimore, u rendit me rilindasit më të mëdhenj, përkrah të cilëve luftoi me devotshmëri, me përkushtim derisa shkriu jetën e tij “si kandili që s’ka vaj”, siç thotë Naimi në “Fjalët e Qiririt”. Një jetë tërë në shërbim të atdheut, në shërbim të çështjes kombëtare, të gjuhës shqipe, të arsimit e të kulturës sonë, një jetë e vërtetë prej martiri.<sup>33</sup>

Josif Bageri tërë jetën e kaloi në varfëri familjare, në mërgim, si bari e shegert, punëtor dhe udhëheqës i gazetave “Shqypeja e

---

<sup>33</sup> Rruzhdhi Mata, Josif Bageri – veprimtar i spikatur i Rilindjes sonë Kombëtare” në gazetën “Flaka”, dt. 16 prill 1998, f. 8-9; Rruzhdhi Mata, “Josif Bagerri, SH.B. “8 Nëntori”, Tiranë 1983;

Shqypnisë” dhe “Ushtima e Krujës”, do të thotë profesori dhe studjuesi prof. dr. Avzi Mustafa.<sup>34</sup>

Dhe, s’është e lehtë të bëhet portreti moral, poetik dhe intelektual i Josif Bagerit, rekas i ndritur, të njeriut të ndershëm e me aspirate të shumta e të shëndosha, të njeriut, që kishte vullnet të fortë e dëshirë të zjarrtë që të bëhet sa më i vyeshëm, njeriut të përvuajtur të Rekës së Epërme, të Nistrovës, ashtu siç s’ka qenë e lehtë koha kur jetoi e punoi si punëtor i thejshtë e më vonë si mendimtar, duke filluar prej fundit të shekullit XIX dhe deri në 1915, kur njeriu s’vyente shumë, kur jeta ishte në dorën asgjësuese të pushtetit të huaj, kur jeta politike oscilonte dëmshëm dhe paralamëronte vetëm dhe gjithnjë pasiguri, kur jeta ekonomike ishte e vështirë e kur ajo sociale, me të drejtë, karakterizohej çfrytëzuese e njeriut prej njeriut, kur njeriu ishte ujk i njeriut, kur liri s’kishte “njeriu i vogël”, kur dita e nesërme ishte i zavendësuar me analfabetizmin e injorancën. Në këtë realitet jetoi dhe shkroi Josif Bageri, përpara të cili s’mbeti indifferent, por, punoi<sup>35</sup>.

Pra, në fillim të shek. XX Josif Bageri ishte veprimtar i spikatur i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte poet me zemër të shqetësuar, shkrimtar për fëmijë me ndjenja fisnike, gazetar e publicist me penë të mprehtë, mësues e pedagogë, kreativ dhe humanist me vizione të qarta dhe largpamës mbi çështjen kombëtare shqiptare. Ky “shërbëtor besnik i ton kombit shqypar” (siç e quaj veten Josifi), jetoi, punoi dhe zhvilloi një veprimtari të dendur atdhetare, publicistike, letrare e kulturore mu në kohën kur Rilindja Kombëtare Shqiptare kishte nevojë shumë të madhe për personalitete të këtilla<sup>36</sup>

Bir e nip nalbani, Josif Bageri, autodidakt, me profesion këpucar, ishte dhe mbeti njëri nga publicistët më në zë i Rilindjes

---

<sup>34</sup> Dr. Avzi Mustafa, Kontaktet e Josif Bagerit e patriotët shqiptar”, Portret me rastin e 90 vjetorit të vdekjes, në gazeën “Ljm”, dt. 06.07.2005, fq. 12;

<sup>35</sup> Dr. Petro Janura, “Josif Jovan Bageri”, në “Kopsht Malsoi”, përgatitur nga Ruzhdi Lata, Tiranë, 2019, f. 13-29

<sup>36</sup> Prof. dr. Nexhat Abazi, Josif Bageri – figurë e ndritur e Rilindjes Kombëtare shqiptare”, në gazetën “Flaka”, dt. 18.XI.1995, fq. 15;

Kombëtare Shqiptare<sup>37</sup>. Ishte apo shtatëmbëdhjetë vjeç djalë, kur u përcuall nga Nishtrova e Rekës së Sipërme të Dibrës në kërkim të punës, të jetës. Studjuesit e jetës dhe veprës së Josif Bagerit, si” Prof. Nexhat Abazi, Ruzhdi Mata, Hamit Boriçi, Lutfi Turkeshi, Avzi Mustafa, Petro Janura, Remzi Nesimi, Agim Vinca, Thoma Kacorri, Ali Aliu, Xhevat Gega, Eugen Shehu, dhe disa të tjerë, që për arsye hapsire nuk kam mundësi që t’i përmendi emrat e tyre, e kanë përcaktuar vitin 1870, si vitë të lindjes së tij, ndonëse nga kujtimet e vetë Bagerit del se ai mund të ketë lindur më 1868, vit ky i fiksuar edhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar<sup>38</sup>, në fshatin Nishtrovë të Rekës së Epërme. I ati, Jovani, ushqente ndjenja thellësisht të pastra për Shqipërinë dhe këtë mendohej t’ia transmetonte edhe bijve të vet.Por, vetëm këto ndjenja, ngase ai ishte tepër i varfër të ndihonte djemt e tij.Mandej, aq i madhë ishte kjo varfëri, saqë kur Josifi mbushi moshën për në shkollë, ainuk kishte para as për fletore e lapsa.I heshtur nga natyra e i pasur me një shpirt të butë e të dhembshur, Josifi nuk qahet tek i ati. Përkundrazi kësaj fiton bukën e gojës duke kullotur bagëtitë e të tjerëve, duke ndarë kësisoj në dysh, dhimbjen e madhe të prindëve.

Josifi në rininë e hershme u ropat të gjente ndonjë punë a zanat në Dibër ose në qytetet e tjera përreth.Në pamundësi, u detyrua të merrte udhën e mërgimit e të ngulitej me bashkëshorten Vasilikë – nuse e re, në Sofje të Bullgarisë.Ishte vitit 1887<sup>39</sup>. Tërë jetën iu kujtua dita kur u nda nga babai Jovan dhe nga gjyshi Nikollë, i ndjeu lotët e përqaimit të tyre dhe porosinë që i dhanë: “Kthehu shpejt, mos e harro Nistrovën, Dibrën, mëmëdheunë!” Gjithë jetën Josifi do të përmallej për kodrat, koriet dhe për kullotat e fshatit, ku e shkoi jetën me një tuf dhenë, shtëpinë në rrëzë të kodrës e buzë prroit dhe do t’u këndonte atyre në vjershat e shumta, do t’i përjetonte ato në shkrimet e veta publicistike. Me të t’i mposht mallë e brengë kur tregonte përata dymbëdhjetë ditë e netë rrugë në këmbë duke kaluar shtigje, fshatra e qytete, ujëra dhe pyje derisa

---

<sup>37</sup>Dr.Iset Dermaku, “Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe kolonitë shqiptare në Rumani dhe në Bullgari, Prishtinë, 1987;

<sup>38</sup>Fjalori Enciklopedi shqiptar, Vëll.i, Tiranë, 2002, faqe 151;

<sup>39</sup> Josif Bagerri, Kopsht Malësor”, Tiranë, 2019

arriti në Sofje. Edhe këto ndikuan për të ruajtur ndjenjë e atnisë, siç e kishte dëshirë të thoshte e të shkruante fjalën “atdhetari”. Fëmijëria, rinia e herëshme, tregimet e prindërve të gjyshit, malsorit të Nishtrovës, Nikollë Bagerit, lanë gjurmë të thella në vetëdijen e djaloshit, që shpejt u shqua për veprimtari mëmëdhetare në gjirin e Kolonisë të shqiptarëve të Sofjes në Bullgari.<sup>40</sup>

Historikisht familja e Bagerit është e njohur për merita patriotike. Gjyshi i tij, Nikoll Baggeri, krahas zejës së nalbanit në Dibër, zhvillonte edhe veprimtari të gjërë patriotike<sup>41</sup>. Shtëpia e tij shërbeante si vend takimesh, mbledhjesh dhe strehimesh të atdhetarëve shqiptarë qysh në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kjo veprimtari e vazhdueshme patriotike e familjes së Josifit pati ndikim të madh në formimin e karakterit patriotik të tij. “Jdhea kombëtare – shkruan Josifi, që në oshën 16 vjeçare djali nuk na ka lon urt e në qetësi, por gjithnjë na ka çpue e nguc... Për me punue pa mprajti për kombin shiptar...”.<sup>42</sup>

Josif Bageri, pasi arriti në Sofje, pa humbur kohë shpejt u inkuadrua në lëvizjen kombëtare, mësoi shkrim – lexim në gjuhën shqipe, e më pas filloi të mirret edhe e shkrime. Në atë kohë në Sofje jetonte edhe punonte një numër i madh shqiptarësh të cilët kishin ardhur nga shumë qytete të Shqipërisë. Kafeneja “Albania” e Adem Shkabës dhe dyqani i Dhimitër Molës ishin qendra kryesore ku Josifi I ri njohu shumë shqiptarë, të cilët punonin si zanatçinj për të siguruar kafshatën e bukës. Josifi në Sofje filloi të ushtrojë zanatin e këpuctarit. Ai në kryeqendrën e Shtetit Bullgar, zhvilloi kontaktë të shpeshta dhe bashkëpunim të ngushtë me shumë atdhetarë, të cilët punonin për çështjen shqiptare. Në këtë bashkëpunim sidomos duhet theksuar miqësia dhe bashkëpunimi me bashkëvendasit e tij rekas,

---

<sup>40</sup> Dr. Hamit Boriçi, “Shënime për Josif Bagerrin dhe gazetën shqypeja e Shqipërisë – Emër i shquar i publicistikës shqiptare, në gazetën “Flaka e Vëllaëriit”, dt. 11.06.1994, fq.9

<sup>41</sup> Dr. Lutfi Turkeshi në nëntëdhjetë vjetorin e vdekjes së patriotit Josif Baggeri, fejtton në gazetën “Fakti”, dt. 16-19.04.2005, f.18;

<sup>42</sup> Prof. dr. Nexhat Abazi, “Josif Bageri- figurë e ndritur e Rilindjes sonë Kombëtare” (Me rastin e 125 vjetorit të lindjes..), në gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, dt. 18.XI.1995, faqe 15;

Anastas Albanskin.<sup>43</sup> Ai zhvilloi një bashkëpunim të ngushtë me Dervish Himën dhe dibranët Sait Najdenin dhe Jashar Erebarën, të cilët në këtë periudhë ishin të agazhuar në veprimtarinë kulturore – arsimore, duke përhapur libra, revista, gazeta broshura dhe material tjera ndër masat e gjera popullore shqiptare.

Një ndër personalitetet që ushtroi ndikim të fuqishëm në formimin intelektual dhe patriotic të Josif Bagerrit, pa mëdyshje është Dhimitër Mole nga Korça, i cili kishte ardhur në Sofje një vitë para Josifit. Ai në Sofje kishte hapur një dyqan të vogël për shitjen e prodhimeve ushqimore. Ai kur kishte ardhur nga Bukureshti në Sofje, në shkurt të vitit 1886, me vete kishte sjellë shumë libra e gazeta shqipe dhe nëmbrëmje gurbetçinjtë e Sofjes mësonin të lexonin e të shkruanin gjuhën shqipe “Hani i Moles u bë mësonjëtoje, ndërsa hanxhiu mësues”.<sup>44</sup> Krahas përvetësimit të shkrim – leximit, gurbetçinjë (në mesin e të cilëve ishte edhe Josifi) zhvillonin biseda të ndryshe, këndonin këngë shqipe e luanin valle. Meqë numëri i shqiptarëve në Sofje rritej dita në ditë, u paraqit nevoja për themelimin e një shoqërie kulturore – arsimore e cila do të përhapte mësimin dhe në gjuhën shqipe. Prandaj, më 1 janar të vitit 1893, një numër i madh shqiptarësh, toskë e gegë, myslimanë e të krishterë themeluan shoqërinë shqiptare të Sofjes me emrin “Dëshira”.

Josif Bageri ishte një ndër themeluesit dhe anëtarët më aktivë të kësaj shoqërie. Pas një kohe të veprimit të kësaj shoqërie, Josifi erdhi në kundërshtim me disa përcaktime statutare, sepse nuk i toleronte ndasit fetare, prandaj që i detyruar të largohet nga radhët e saj dhe të formoi një shoqëri tjetër me emrin “Bashkimi” në vitin 1898.

Josif Bageri si një rilindas i shquar i trevave lindore shqiptare, pra, i këaj ne, ishte future shumë herët në shtigjet e luftës për Liri, demokraci dhe arsim. Ky patriot e kishte kuptuar po ashtu se shkolla është një prej burimeve kryesore për të jetuar një komb. Si një aktivist i shquar, duke përfituar nga mundësitë që kishte krijuar nga

---

<sup>43</sup> Po aty, Dr. Nexhat Abazi, Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912), Tetovë, 1997, f. 297-312.

<sup>44</sup> Po aty.

kushtetuta e ashtuquajtur e xhonturqve “Hyrjeti”, ai i drejtoi fuqit e veta në zhvillimin e arsimit, në hapjen e shkollave në gjuhën amtare, në përdorimin e një alfabeti dhe në përdorimin e gjuhës shqipe në shkollë, në karakterin kombëtar të edukatës, në miqësimin e vëllezëerëve shqiptar pa marrë parasysh krahinën e besimin religjioz<sup>45</sup>. Josif Bageri u shqua si një demokrat i vërtet midis shumë aktivistëve të Rilindjes, ku dha një kontribut të çmuar në fushën e arsimit dhe kulturës. Ai do të mbetet si një militant i paepur i lëvizjes kombëtare. Atë e gjejmë kudo herë në Shkup, herë në Dibër, herë në Sofje, herë në Bukuresht. Siç shkruan gazeta “Shqypja e Shqypnisë”, Nr. 6. E datës 1 gusht 1909 “nuk na kalon urt e në qetësi, por gjithnjë na ka çpue e nguc... për e punue pa mprajti, për kombin shqiptarë”.<sup>46</sup>

Gazeta “Shqypeja e Shqypnisë” të cilën e themeloi dhe e redaktoi personalisht Josif Bageri, ishte fletore politike shoqërore, letrare e kulturore në gjuhën shqipe, numri i parë i së cilës doli më 15 maj 1909. Prej numrit 41 që doli më 5.X.1911 gazeta doli me emrin “Shqiponja e Shqipërisë. Adresa e gazetës në fillim ishte “Nishka”, nr.35 dhe shtypej në shtypëshkronjën “Makedonija” në Sofje.

Lajmotivi i gazetës ishin vargjet që i shkroi vetë Josifi:

“Unë jom Shqypeja e Shqypnis

Sqohi, or zoçt e trimnis...

Un jom shpeza e furrikut,

Epni derëman ma rrezikut;

Mjaft në t’errët, si vorfuni...

Sqohi trima, zoçt e mi.”

Josif Bagerri, ky veprimtar i shquar, tregonte një veprimtari të gjallë për të vënë në jetë qëllimet e klubeve shqiptare që ishin ngritur kudo nëpër qytete të ndryshme që ishin bërë qendra e vatra për të hapur shkolla popullore në qytete e në katunde.<sup>47</sup>

---

<sup>45</sup> Prof. Avzi Mustafa, “Përpyekja e Josif Bakerit për gjuhën dhe shollën shqipe”, në gazetën “Koha”, dt. 15 gusht 2011, fq. 17.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Po aty.

“Detyra e secilit shqyphtar me ndërgjegje osht.... Të përpiqet pa mprajtim për me e shpëtua vëllain e vet prej robënisë së padijes...”<sup>48</sup>

Si rilindas illuminist, Bageri nuk mund të qëndronte indiferent përpara gjendjes së mjerueshme të popullit shqiptar, i cili më së shumti kishte nevojë për arsim, zgjim kombëtar dhe përparim kulturor. Prandaj, Jofisi përpiqet të gjente forma dhe mënyra për arsimin institucional për hapjen e shkollave botimin e librave, gazetave (rubrikave arsimore pranë gazetave e revistave, grishje, shpallje, vjersha me porosi edukative dhe shumë forma të tjera.).

Josif Bageri si një patriot i flaktë e vetinciativë mori rrugën e misionarit arsimor që të shkojë në Dibër, për t’u njohtuar për së afërmi me gjendjen e shkollave dhe për të nxituar hapjen e shkollave edhe në vende të tjera të banuara me shqiptarë.

Me qëllim që t’i jetësojë të gjitha këto forma, ai u përpoq që në kuadër të sistemit ekzistues të arsimit të Perandorisë të hapë një shkollë fillore në Dibër e pastaj në Rekë. Të dhënat burimore për hapjen e shkollës në fshatin Nishtrovë të Rekës së Epërme, na jep vetë Bageri në një letër të gjatë, të cilën ia dërgon kryetarit të shoqërisë “Djalëria” në Konstancë. Këtë letër e kishte shkruar në Shkup në vjeshtë të vitit 1908, gjatë qëndrimit të tij në Klubin shqiptar të Shkupit.<sup>49</sup>...

Për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme historike, Josifi nisët më 7 shtator 1908, për në Dibër. Gjatë udhëtimit ndalet në Shkup për të vizituar Klubin Shqiptar, kurse në Dibër arrin më 20 shtator 1908. Atje takohet me atdhetarë dibranë, ndër të cilët edhe me Shyqyri Beun dhe Hasan effendi Ballancën, të cilët, siç shkruan Josifi, ishin njerëz me “ndiesa kombiare”. Për të realizuar detyrën e tij, Bageri u drejtua te organet e pushtetit osman për të marrë leje për hapjen e një shkolle shqipe në Dibër. Për këtë qëllim ai i luti zyrtarët katër ditë që të marrë leje “por s’ ishte kollaj kjo punë se kriste huta dhe luante shkopi” – shkruan ai..<sup>50</sup>

---

<sup>48</sup> Dr. Nexhat Abazi, Josif Bageri – figurë – e ndritur e Rilindjes” në gazetën “Flaka”, 18.Xi 1995, faqe 15.

<sup>49</sup> Prof. Dr. Nexhat Abazi, “Josif Bageri – figure e ndritur...” punim i cituar, dt. 18 nëntor 1995, f. 15.

<sup>50</sup> Po aty.

Josifi harxhoi 2 lira turke për të nxjerrë një leje, ai e mori këtë, por jo për në Dibër, por për në fshatin e lindjes – në Nishtrovë. Pasi mori lejen, shkoi në Nishtrovë, ku i bënë një pritje të përzemërt familja, farefisi bashkëfshatarët dhe shumë të tjerë. Pasi i njoftoi me qëllimin e ardhjes, Josifi filloi të mbledhë fëmijë për në shkollë: “ Në nestrin grisha disa prej fisit vetë të çojnë fëmijë për me msue bashkë me fëmijë e vet. Edhe kështu u mblodhën 8-9 fëmijë dhe zuna të mësoj a.b.c. (abetaren N.D.).Kisha tepër se 20 cop.Mirëpo, në Malsinë e Dibrës kishte vajtzani, se në Rek a ardh njifar daskalli....”<sup>51</sup>

Në këtë mënyrë, pra, pas një rruge të mundishme, Bageri arriti që në fshatin e tij të lindjes – në Nishtrovë, më 25 shtator të vitit 1908 ta çel shkollën e parë shqipe, të cilën sikurse vetë Josifi, pa ashtu edhe bashkëvendësit e tij e kishin ëndërruar shumë shekuj. Në historinë e kësaj krahine, për herë të parë fëmijët filluan shkri – lexim shqip, mësuan të lexojnë abetaren dhe libra shqip, historinë e popullit shqiptarë, si dhe fjalë dhe këngën shqipe.

Nuk kemi të dhëna konkrete lidhur me punën e mëtutjeshme të kësaj shkolle, por dihet se Josifi abetaret dhe librat i la aty, që të shërbehen jo vetëm fëmijët, por edhe rriturit.<sup>52</sup>

Josif Bagerri shpejt këthehet në Sofje, për të vazhduar veprimtarinë e tij, mëmëdhetare, kryesisht përmes shtypit.<sup>53</sup>Në pranverën e vitit 1909, ai nisi përgatitjen për themelimin e një gazete. Përsëri këpucar, sa për të nxjerrë kafshaën e bukës së fëmijëve. Por, gjente kohë për të shkruar artikuj për gazetën që projektonte të botonte në Sofje. Kishte përcaktuar edhe drejtimet e gazetës, gjuhën, shkronjat sipas alfabetit të sapovendosur atëherë në Kongresin e Manastirit dhe më në fund ranë marrëveshje edhe me një shtypshkronjë bullgare. Një e keqeshte se radhitësit nuk e dinin gjuhën shqype. Zgjodhi dhe përcaktoi edhe emrin e gazetës: “Shqypeja e Shypnisë”. Më 18 maj 1909 doli në qarkullim numri i parë i gazetës në krye të së cilës lexoheshin vargjet e Bagerit:

---

<sup>51</sup>Po aty.

<sup>52</sup> Prof. Dr. Nexhat Abazi, “Josif Bageri.... Punim i cituar”, në gazetën “Flaka”, 18 nëntor 1995, faqe 15.

<sup>53</sup>Dr. Hamit Boriçl, “Josif Bageri – emër i shquar i publicistikës shqiptare”, në gazetën “Flaka”, 11 qershor 1994, fq.9.

*“Unë jam Shqypja e Shqypnis  
Sqohi, or zoqt e trimnis...”*

Gazeta “Shqypja e Shqypni”, si një gazetë përparimtare e demokratike luajti rol të rëndësishëm për ngritjen në këmb të opinionit të përgjithshëm shoqëror në Shqiptarët e Bullgarisë dhe të kolonive të tjera në prag të pavarësisë. Në të njëjtën kohë, gazeta, që Bageri e botonte për qëllime të larta mëmëdhetare, u bënte jehonë problemeve të Shqipërisë edhe përpara lexuesit të huaj, duke informuar e komentuar ngjarjet e atyre viteve të rëndësishme. Tematika kryesore e saj ishte lufta për gjuhën e shkrimit shqip, çështja e çlirimit të plotë të atdheut, demaskimi i Fuqive të Mëdha si dhe i Shteteve shoveniste fqinje.

Pra, në vitet 1909-1911, Josif Bageri bëhet botues dhe redaktor i gazetës “Shqypja e Shqypnisë” të cilën ai e botonte në Sofje. Kjo gazetë ishte një organ politik, kulturor dhe letrar siç ishte e shënuar në ballinë. Në këtë gazetë Josifi shkruante me pseudonimin Rek – Rekasi, për të zvogluar rrezikshmërinë e tij fizike nga përndjekësit politik.

Gjithashtu, në vitin 1910, Josif Bageri në Sofje boton përmbledhjen me tregime e vjersha “Kopësht Malësori, e cila u përdor edhe si libër leximi për shkollat shqipe.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, Bageri nga Sofja kthehet në Shqipëri dhe vendoset në Durrës. Atje Qeveria e Vlorës e emëron redaktor të revistës “Ushtima e Krujës”. Kjo gazetë për shkaqe të varfërisë ekonomike, pas disa numrash pushon së botuari.

Kushtet e rënda jetësore, keqësimi i shëndetit dhe dëshpërimi i thellë politik e social, e shtynë Josifin në qershor të 1915 të vendoste që të kthehet sërish në Sofje.

Rrugës për në Sofje ndalon në Prishtinë, kunë rrethana ende të pahulumtuara deri në fund vdes në kishën orthodokse të qytetit.

Dhe krejt në fund, Josif Bageri, përpos që ishte njëri nga figurat më të shquara të lëvizjeve të mëdha çlirimtare në Ballkan për lirinë e mendimit shprehjes, arsimimit dhe për lirinë e popujve që jetonin të lirë në shtetet e tyre kombëtare, ai ishte edhe poet,

prozator dhe publicist. Shkroi shumë tregime dhe vjersha për fëmijë. Shkruante edhe tekste pedagogjike e didaktike arsimore, tekste shkencore, krijonte e mbliidhte aforizma e proverb etj. Fillimisht i botonte nëpër gazeta dhe revista të kohës, si: “Kalendari Kombir”, “Drita”, “Liria”, “Shqipëria”, “Shpresa e Shqypnisë”, etj

Josif Bagerrri përveç se botoi gazeta, hapi shkollën e parë në gjuhën shqipe në Nishtrovë, shkrojti poezi, tregime etj, ai ka edhe meritë historike, se në disa kisha orthodoxe të Rekës së Epërme, ai futi gjuhën shqipe si gjuhë në të cilën bëheshin lutjet fetare. Në këtë mënyrë ai zgjoi interesim shumë të madh ndër banorët (besimtarët orthodox) të kësaj ane për t’i ndjekur lutjet e këtilla të kuptueshme, sepse bëheshin në gjuhën amtare shqipe.

### **Përmbledhje**

Prej kohës e kamë bërë objekt studimi Josif Bagerrin, veprimtarine spikatur të Rilindjes sonë Kombëtare, nga Nistoria e Rekës së Epërme, i cili iu përkushtua atdheut në një nga periudhat më të rëndësishme historike të Shqipërisë, siç ishte pragu i Shpalljes së pavarsisë, periudhë kjo që u përgatit nga Lëvizja jonë Kombëtare që me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Me veprimtarinë e tij të shumanshme politike, organizative, publicistike, ideologjike, artistike, kulturore dhe arsimore, u rendit me rilindasit më të mëdhenj, përkrah të cilëve luftoi me devotshmëri, me përkushtim derisa shkriu jetën e tij “si kandili që s’ka vaj”, siç thotë Naimi në “Fjalët e Qiririt”. Një jetë tërë në shërbim të atdheut, në shërbim të çështjes kombëtare, të gjuhës shqipe, të arsimit e të kulturës sonë, një jetë e vërtetë prej martiri.

### **Summary**

Since before I have had as a subject of study the whole life of Josif Bagerrin's remarkable activity, also our National Renaissance movements, the History of the Upper Lake, which devoted itself to one of the most important historical periods of Albania, such as the Declaration of Independence, this period that was prepared by our National Movement with the Albanian League of Prizren. With his political, organizational, publicist, ideological, artistic, cultural, and educational activities, he enlisted with the greatest people who were eager for change, with whom he fought devoutly until he melted his life "like a candle without oil" as Naim says in "Words of Candle". A whole life serving the homeland, serving the national cause, the Albanian language, our education and culture, a true life of martyr.

**Mixhait POLLOZHANI**  
**Universiteti i Tetovës, Tetovë**  
**mixhait\_p@yahoo.com**

## **TRADITA JONË INTERKULTURORE NË ARTET PAMORE**

### **OUR INTERCULTURAL TRADITION IN THE VISUAL ARTS**

Multikulturalizmi dhe interkulturalizmi përbëjnë binomin më kompleks socio-antropologjik dhe universal, si dhe paraqesin njëherësh edhe burim të përhershëm të vlerave humane dhe demokratike të shoqërisë njerëzore. Prandaj, këto dy ekzagjerime shoqërore, duhet shikuar si mekanizma të cilët e lehtësojnë bashkëjetesën dhe i harmonizojnë marrëdhëniet midis popujve në shoqëritë heterogjene. Gjithashtu, duhet nënvizuar se kohezioni multikulturor dhe komunikimi ndërkulturor nuk i zbulon vetëm dallimet ndërmjet kulturave, por edhe variacionet dhe ndryshimet brenda një kulture, prandaj, jo rastësisht, interkulturalizmi është bërë faktori bartës i politikave të vendeve të ndryshme demokratike. Për këtë arsye, duke u nisur nga konstatimet e socio-antropologut, Klod Levi Shtros, se, *“zbulimi i tjetrit është zbulim i marrëdhënieve, dhe jo i pengesave”*, del që interkulturalizmin pra duhet kuptuar si e kundërta e asimilimit kulturor.

Kështu, përderisa multikulturalizmi nënkupton ekzistencën e kulturave të shumta në të njëjtën hapësirë, interkulturalizmi, ndërkaq, vë në pah, marrëdhëniet midis kulturave dhe domosdoshmërinë e bashkëveprimit të ndërsjellë të tyre. Andaj, të

bazuar pikërisht në këtë përkufizim në vijim do të pasqyrojmë relacionin e traditës sonë ndërkulturore në artet pamore. Por, gjithashtu duhet theksuar se, tradita ndërkulturore e shprehur nëpërmjet arteve pamore sa është profane aq është edhe sakrale, sa është lokal po aq është universale dhe sa është nacionale aq është internacionale.

Meqenëse, artet pamore, si forma më e lashtë e shprehjes kulturore, gjuhë të komunikimit kanë sekuencat pamore, brenda vetes ngërthejnë një spektër të gjerë gjinish dhe mediumesh artistike, atëherë jemi të detyruar që objektin tematik të këtij studimi ta përqendrojmë te trashëgimia artistike figurative tradicionale, moderne dhe postmoderne. Thënë më saktë, si shembuj do të sjellim veprat e krijuesve, të cilët, ndonëse etnikisht u përkasin popujve dhe vendeve të ndryshme, por si tema në krijimtarinë e tyre artistike ata kanë shfrytëzuar dhe e shfrytëzojnë të kaluarën dhe të tashmen e popujve të tyre fqinjë. Por nuk do të anashkalohen as edhe krijimet figurative të krijuesve të vendeve evropiane perëndimore që kanë trajtuar tema me shqiptarët.

Dihet se historia e artit njih shumë artistë joshqiptarë të cilët kanë lënë një numër të konsiderueshëm të veprave artistike, kushtuar shqiptarëve. Por, duhet përkujtuar edhe faktin se nuk është i vogël as edhe numri i krijuesve shqiptarë, të cilët kanë shfrytëzuar traditën e popujve të tjerë si objekt tematikë për krijimtarinë e tyre. Dhe ajo që duhet nënvizuar, duke marrë për bazë shtrirjen kohore, del se tradita ndërkulturore në artet pamore të popujve ballkanik, por edhe me gjerë, është shumë e lashtë, ka filluar që nga antikiteti ka mbijetuar gjatë mesjetës dhe po vazhdon edhe deri më sot.

Meqenëse, mungojnë publikimet më të plota studimore kushtuar trajtimit vizual të traditës ndërkulturore, sidomos te shqiptarët, për plotësimin e kësaj mungese në masë të madhe jemi përqendruar te subjektet artistike. Ndërkohë që, pasqyrimi i krijimtarisë figurative është bërë sipas parimit: etnik dhe historik, kurse, zbërthimi i veprave është bërë nëpërmjet kriterit: poetik dhe estetik. Por, gjithashtu duhet nënvizuar faktin se, pjesa më e madhe e këtyre veprave është realizuar me mjete tradicionale figurative, ku

dominon: piktura dhe skulptura, kurse nuk mungojnë as edhe veprat e arteve postmoderne, siç janë: instalimet artistike, performansa, foto-artet, video-artet, etj. Ndërkohë që, në këto vepra është e pranishme tematika historike, religjioze, sociale, politike, të shprehura vizualisht nëpërmjet motiveve të ndryshme, ku dominon figura e njeriut (lexo portretet apo bustet) pastaj, peizazhet, ready mede (rendi medet), Nëpërmjet artit të prezantueshëm figurativ artistët e kanë riprodhuar realiteti e kohës, ndërkaq, me anë të projekteve konceptuale pamore kanë problematizuar tema të ndjeshme të popujve.

Duhet vënë në pah se së pari do ta pasqyrojmë krijimtarinë e artistëve shqiptar, të cilët, dikur dhe sot, kanë lënë vepra me vlerë dokumentare dhe estetike, por edhe kanë zënë vend si shembuj konkret të ndërveprimit kulturor në historinë e artit. Artisti i cili është realizuar dhe ka lënë një trashëgimi të çmuara artistike në një vend dhe për një popull tjetër është Andrea Aleksi (1425-1503). Ky artist, traditën ndërkulturore e ka begatuar nëpërmjet trajtimit të tematikes krishtere. Emrin e tij e hasim në më shumë versione, Aleksi Andrea (Durrsaku) pastaj si Andrea de Alesio, apo Andrea Aleshi, është lindur në qytezën e Lezhës, kurse në vitin 1435 shkon në bregdetin dalmatin të Kroacisë. Fillimisht ai është vendosur në qytetin e Zarës, ku për tetë vjet rresht ka mësuar mjeshtërinë e gurgdhendjes. Pas përfundimit të shkollimit në Zarë, Andrea, shkon në Shibenik ku ka punuar si ndihmës i mjeshtrit të madh kroat, Juraj Matej Dalmatinasi, me të cilin pastaj ka vazhduar bashkëpunimin gjatë tërë karrierës së tij artistike. Dhe më pas vendosët në qytetin e Splitit, ku edhe ka hapur një atelie të specializuar për gurë-gdhendje.

Duhet theksuar se, Andrea, është marrë edhe me ndërtim dhe më pak me pikturë murale, por, megjithatë ai ka qenë i specializuar për gdhendjen e relievit me përmbajtje sakrale për zbukurimin plastik të kishave dhe katedraleve dalmatinase. Ndër veprat të tij më të rëndësishme merren: Opusi i realizuar në ujdhesën, Rab, ku ka realizuar ndërtimin dhe dekorimin plastik të kapelës dhe varrit monumental në kishën Shën. Ivan Evangjelisti. Gjithashtu, një krijimtari shumë të rëndësishme përbënë edhe Opusi i tij krijues i

Trogirit, ku duhet veçuar Pagzimoren (kryqëzimoren) për katedralen e Shën Lovre, e cili ka filluar të ndërtohet në vitin 1460 dhe ka përfunduar më 1467. Në anë e brendshme të derë së këtij objekti monumental kishtar ai e ka shënuar edhe emrin tij. Ky është teksti që mund të lexohet aty: ANDREAS ALEXIUS DURRACHINUS OPIFEX MCCCCXII, që flet për prejardhjen e këtij artiste që i la një trashëgimi artistike me elementet gotike dhe rilindëse kulturës kroate.

Nga trangu shqiptar ka dal edhe një artist tepër i rëndësishme në fushën e artit krishterë, i cili, ndonëse njihet si piktori kishtar postbizantin, ai megjithatë është artisti i parë nga trojet ballkanike që mund të ndërlidhet edhe me frymën e renesancës. Fjala, pra, është për piktorin, Onufri (shek. XVI), krijimtaria e të cilit është hulumtuar, studiuar, zbërthyer, prezantuar edhe është publikuar nga studiues të vendeve të ndryshme. Onufri ka pikturuar kishat që dikur bënë pjesë në kuadër të Patrikanës së Ohrit, e cila nën juridiksionin e saj kishtar administronte territore të Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Greqisë. Prandaj, tash një kohë më të gjatë, ai studiohet paralelisht nga studiuesit shqiptar, grek, maqedonas, serb dhe të huaj.

Krijimtaria e tij, ka një shtrirje të gjerë gjeografike dhe ikonografi të begatshme me vlera estetike. Onufri, apo siç njihet ndryshe edhe si, Onufër Neokastriti, me përkatësi fetare ortodokse, të cilit nuk i dihet me saktësi as vendi dhe as viti i lindjes, ka qenë një mjeshtër i rrallë i fresko-pikturës dhe ikonografisë. Në kuadër të opinionit shkencor akoma ekzistojnë mendime të ndara rreth prejardhjes së tij etnike (kombëtare). Studiuesit grekë, por edhe ato sllavë, Onufrin e kanë shpallur me prejardhje greke, ndërkohë që, studiuesit shqiptarë, me argumentet e tyre dëshmojnë se ky piktor është shqiptar.

Sidoqoftë, veprimtaria e tij artistike kishtarë i kalon suazat e artit etnik, është përqendruar në disa qendra, përkatësisht, në kishën e Shën Nikollës në Shelçan dhe në kishën e Shën Premtës në Shpat dhe Shën Teodori në Berat të Shqipërisë, në Kostur të Greqisë dhe në fshatrat Slepçe dhe Zërze të Prilepit të Maqedonisë së Veriut. Ai e ka trajtuar veprimtarinë e shenjtoreve të ndryshëm, përfshirë këtu edhe

atë të Jezu Krishtit, Shën Mërisë, Shën Pjetrit, pastaj të figurave mitologjike, siç është Davidi, etj. Por, duhet theksuar se në krijimtarinë e tij është e pranishme edhe tematika nga historia dhe nga përditshmëria e atëhershme shqiptare.

Onufri, duke i thyer konventat e rrepta kishtare bizantine, futi një realizëm dhe individualizëm më të theksuar në ndërtimin e portretit të personazheve të tij. Në krijimtarinë e tij vihet re sidomos përdorimin i ngjyrave intensive natyrore. Por është për tu theksuar fakti se ai ishte i pari që përdori fuqishëm ngjyrën e kuqe në freskopikturën dhe ikonografinë në artit e tij kishtar. Georgios Golobias, studiues grek, pasi e ka zbuluar qëndrimin e Onufrit në Itali, nga viti 1534 deri në vitin 1543, ai ka konstatuar edhe ndikimin e piktorit tonë nga arti i renesancës italiane. Këtë ndikim ai e ka shprehur nëpërmjet përdorimit të ngjyrës së kuqe tejet intensive, e cila ka qenë karakteristike e koloritit të Shkollës së Vendikut. Ndaj edhe nuk është gabim nëse thuhet se të kuqen e tij, Onufri e huazoi pikërisht nga kjo shkollë e njohur italiane, ashtu siç pat vepruar edhe piktori i famshëm italian, Ticiani (1488/90-1576), i cili po ashtu e ka praktikuar të kuqen e njohur - umbre, një karakteristik e shkollës venedikase. .

Por, megjithatë është fare vogël numri i krijuesve bashkëkohor shqiptar të cilët janë marrë me trajtimin e traditës kulturore të popujve tjerë në krijimtarinë e tyre. Rexhai Hyseni (1939 – 2018) nga fshati Mateç i Kumanovës, mbase është piktori i rrallë ndër krijuesit figurative shqiptar në Maqedoni, dhe më gjerë në planin mbar-shqiptarë, i cili ka pikturuar disa vepra kushtuar popujve tjerë. Karakterin dhe epitelin e proveniencës ndërkulturore, pse jo edhe ndërkombëtare, krijimtarisë së këtij piktori, ia jep realizimi i miniciklit prej disa pikturash kushtuar masakrave të Luftës së Vietnamit. Ai ka pikturuar edhe *“Portretin e Kemal Atatürkut”* reformatorit të Turqisë, pastaj dy portrete kushtuar figurës së Josip Broz Titos, ish - liderit komunist jugosllav, një minicikël pikturash me tematik nga Luftës Nacional Çlirimtare. Për tu veçuar, janë sidomos kompozicioni: *“Natyrë e qetë me portretin e Lekës së Madh”*, si dhe vepra e titulluar: *“Komiti Ilindenat”* (1971). Këto vepra

ekspresive dhe kubo-surreale flasin për perceptimet ndërkulturore të këtij piktori shqiptar.

Ndërkaq, piktori, Omer Kaleshi (1932) me të drejtë e meriton epitelin e krijuesit më multikulturor të nënqiellit ballkanik. I lindur në fshatin Sërbicë të Kërçovës (Maqedoni), nga ku në vitin 1955, shpërngulet me familjen e tij për në Turqi, dhe prej atje shkoi në Paris. Dhe po ti referohesh krijimtarisë së Omer Kaleshit, atëherë vetvetiu del konstatimi se ky piktor i ka tre atdhe! Atdhetë e tij, të cilët, sa janë real, po aq janë edhe metaforik, luajtën një rol të madh në jetën e tij. Pra, nga atdheu i lindjes, Maqedonia e Veriut, trashëgoi gjenin kombëtar shqiptar dhe trashëgimi të toposit ballkanik, nga atdheu i natyralizuar, Turqia, mori shkollimin dhe u frymëzua nga humanizmi i mistikëve sufist, Mevlana Rumi dhe sidomos, nga poeti, Jonus Emre. Ndërkaq, në atdheun artistik, Franca, i gjetur në qarqet e mbi-ndërtoi personalitetin dhe rrumbullakoi rrugëtimin e tij si krijues.

Ndonëse, për të gjithë ata të cilët kanë shkruar për krijimtarinë e këtij piktori, motivet në veprat e tij i quajnë koka, megjithatë, sipas gjuhës së teorisë figurative ata janë portretet personazhesh të (pa)identifikuara, të moshave, gjinive, profesioneve, karaktereve dhe fateve të ndryshme. Në ndërkohë që, për Alen Boske dhe Ismail Kadarenë, “gjeneza etnike” e atyre kokave, të cilat, përveç që janë anadollak, ato mund të jenë edhe shqiptarë, turq, maqedonas, epirotas, ebrejë, trojanë, babilonas, ilirë.

Arti i tij, sa është sintezë e kulturës mesjetare dhe asaj bashkëkohore, po aq është edhe gërshetim stilistik i surrealizmit dhe disa “izmave” tjera. Arti i tij sa është i gjithëkohshëm, po aq është edhe universal. Krahasimi me piktorin irlandez, Bejkon, i cili i mbeti besnik ekspresionizmit të tij individual, shkon përtej, pasi që, Omer Kaleshi, vazhdoi rrugëtimin stilistik (post)surrealist, duke e begatuar figuracionin e tij irracional edhe me premisat e neofigurativizmit, përkatësisht, neorealizmit. Manifestimet surrealistike të ky piktor, megjithatë, shfaqen si diktat i mendimeve pjesërisht të kontrolluara, por edhe si reminishenca të misterit, mistikes, si dhe të përjetimeve personale, prej nga merr frymëzim fantazia dhe liria krijuese e tij.

Kaleshi është nga ato artist që hapur e relativizon përkatësinë e tij etnike në favor të traditës ndërkulturore të shprehur nëpërmjet artit të tij. *“Unë para se gjithash dhe mbi të gjitha, jam artist dhe jo nacionalist. E dhëna se jam me rrënjë të përziara (para se gjithash shqiptaro – maqedonase) më bënë të ndihem mirë brenda lëkurës sime, sepse bart në vete më shumë kultura të popujve ballkanikë, prej të cilëve ka përfituar shumë krijimtaria ime artistike”*. është shprehur, Omer Kaleshi. Por, megjithatë, shumë qartë e përcakton personalitetin e Kaleshit, miku dhe studiuesit arit të tij, akademiku, Luan Starova, i cili thotë: *“Duke sfiduar ndërlikueshmërinë e kompletksitetit të njeriut nëpërmjet portreteve, a sikur posedon një instinkt të pagabueshëm për ta zbuluar tjetrin”*.

Shikuar nga ana tjetër, ndërkaq, shqiptarët kanë qenë objekt trajtimi vizual edhe te piktorët evropian edhe tek ato fqinjë. Interesimi i artistëve të huaj për botën shqiptare ka filluar shumë herët, dhe se, ashtu siç kanë vepruar shumë udhëpërshkrues, shkrimtarë, ka pasur edhe piktorë të cilët, nëpërmjet krijimtarisë së tyre kanë sjellë imazhe pamore shqiptare. Sidomos në këtë drejtim shquhen disa piktorë, kryesisht, nga Franca dhe Britania e Madhe. Por, megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e tyre shkuan përtej tokave të Ali Pashës, që sot shtrihen në pjesën veriperëndimore të Greqisë dhe në Shqipërinë jugore. Këtë e bëri poeti dhe piktori anglez, Eduard Lir, ndonëse rastësisht, por ai merret si artisti i pare i huaj që bëri një udhëtim të plotë në jug dhe veri të Shqipërisë. Gjatë këtij udhëtimi ai ka kaluar nga Manastiri, në Ohër, Strugë, Elbasan, pastaj prej atje vazhdon në drejtim të jugut në Himarë, Çamëri dhe Greqi. Ditari i udhëtimeve të tij nëpër Shqipëri, është një prej librave më të mrekullueshëm që janë shkruar ndonjëherë për këtë vend në gjuhën angleze, veç tjerash përmban edhe disa vizatime dhe akuarele me pamje të xhamive dhe peizazheve të viseve shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Ndërkaq te krijuesit fqinjë, sidomos te një pjesë e artistëve maqedonas, hasim një situatë më ndryshe, pasi që ata, nëpërmjet artit të tyre, ose mbajnë qëndrim neutral prezantues, ose po e problematizojnë tematikën shqiptare. Shikuar nga këndvështrimi

socio - historik dhe gjeo - politik dihet se shqiptarët si fqinjë të kahmotshme me popujt sllav, në radhë të parë me serbët, maqedonasit dhe malazezët, dhe duke qenë se, një pjesë e popullit shqiptar, pothuajse, për një shekull të plotë, ishte nën juridiksionin politik dhe administrativ, njëherë të ish - mbretërisë dhe pastaj edhe të ish - federatës Jugosllave, disa artist figurativ kanë shprehur interes kohë pas kohe për traditën dhe kulturën e shqiptarëve.

Por, kur bëhet fjalë për krijuesit figurativ sllav, duhet veçuar piktorin e shquar serb, Pavle (Paja) Jovanoviq, (1859 – 1957) përfaqësues i realizmit akademik, i cili shquhet për një mori veprash kushtuar tematikës shqiptare. Jovanoviq ka udhëtuar disa herë në Shqipëri, duke qëndruar sidomos në Shkodër, ku ka kontaktuar me mikun e tij, piktorin e shquar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Kol Idromenon. Gjatë atyre vizitave ai është njohur mirë me kostumet kombëtare dhe traditën shqiptare. Në veprat e tij ai ka nxjerrë në pah krenarinë dhe larminë e veshjeve popullore shqiptare. Duke mos lënë asgjë mangët nëpërmjet kompozimeve, portreteve e peizazheve ai solli me përkushtim socio-antropologjinë e veriut të Shqipërisë. Nëpërmjet tablove: *“Trimat shqiptar në vallen epike”* (1892); *“Përgatitja e nuses shqiptare”* (1885/86); *“Dy rojet shqiptare para portës”* (1887/88), etj., përcolli detaje nga folklori, traditat e zakonet, nuk la pa e përmendur as vuajtjet, por as edhe shpirtin luftarak të shqiptarëve. Kështu, nëpërmjet pikturës së tij, bashkë me imazhet e disa popujve tjerë ballkanik përcolli një paletë plot ngjyra dhe dramë për artdashësit e perëndimit.

Duhet theksuar se, tematika nga jeta e shqiptarëve nuk është anashkaluar as edhe nga artistët bashkëkohor maqedonas. Dihet se dy skulptorë të njohur maqedonas kanë modeluar personazhet shqiptarë në veprat e tyre. Ndër veprat më të hershme të artistëve bashkëkohor maqedonas, shfaqet skulptura me titull *“Koka e shqiptarit”* (1954) e skulptores, Borka Avramova (1924 – 1993) nga Tetova. Meqenëse, kjo artiste me prejardhje ka qenë nga Tetova, ekziston mundësia që ajo të jetë inspiruar nga mjedisi multi-etnik i vendlindjes së saj. Nga vepra duket se kemi të bëjmë me një modelim

tejet ekspresiv, të një personazhi të përvuajtur i përditshmërisë shqiptare.

Edhe një skulptor tjetër shumë i shquar maqedonas, Tome Serafimovski (1935 – 2016), në kuadër të opusit të gjerë të tij krijues, ka realizuar edhe disa vepra me personalitet të rëndësishme iliro - shqiptare. Ky skulptor në vitin 1998 ka realizuar shtatoren në bronz të Shën Nënës Terezë. Kjo shtatore është vendosur para Shtëpisë Përkujtimore të humanistes shqiptare në Shkup. Monumenti skulptural, i cili është i lartë 2,5 metra, dhe i vendosur mbi një postament vetëm prej gjysmë metri, është një kombinimi i gjuhës stilistike ekspresive dhe asaj kubiste. Duhet rikujtuar se njëra replikë e po të njëjtës shtatore të Nënës Terezë të Serafimovskit, në të njëjtin vit është ngritur edhe në qytetin Nyrnberg të Gjermanisë. Ndërkaq, replika tjetër e skulpturës së Nënës Terezë, në vitin 2008 është vendosur në Vatikan të Romës. Serafimovski është autor edhe i një busti të Gjergj Kastrioti – Skënderbeut, i cili me rastin e 500 vjetorit të lindjes së heroit shqiptar është vendosur në oborrin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut në Shkup. Këtij grupi të veprave të Tome Serafimovski duhet shtuar edhe një reliev në bronz, i cili i kushtohet Justinianit të Parë, perandorit ilir të Romës, që është vendosur si monument përkujtimor në Fakultetin e Drejtësisë “Justiniani i Parë” në Shkup.

Por, megjithatë, duhet veçuar projektet hulumtuese pamore të dy krijuesve maqedonas, të cilët i japin përparësi idesë përballë produktit final artistik. Në epiqendër të veprave të tyre konceptuale qëndron tematika aktuale shqiptare. Fillimisht, do te ndalemi tek artistja, Zhaneta Vangeli (1963) e cila në vitin 2003, e ka përfaqësuar Republikën e Maqedonisë në Bienalen e 50 – të Venedikut, pikërisht me temën nga Lufta e vitit 2001, ku ishin të përfshirë drejtpërdrejtë popullata shqiptare vendase kundrejt forcave të sigurisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në projektin e saj të titulluar “Integralism”, artistja, Zhaneta Vangeli, merret në mënyrë ironizuese me tre probleme thelbësore: me luftën si “think – tank” e alkimistëve, me armatimin e luftës i paraqitur si artefakt i muzeut

paradoksal të integralistëve dhe me dizajnimin e identiteteve nga globalistët.

Ky projekt paraqet një instalim artistik me tre pjesë të vendosura në tre hapësira, të cilat janë titulluar: Dhoma e Luftës; Dhoma e Shout dhe Dhoma e Dizajnit. Vangeli, e imagjnon sesi duket dhoma luftës me globalistëve dhe e integralistëve modern? Ajo nuk e shikon atë të sofistikuar, sepse zhvillimi i avancuar i teknologjisë është vetëm një mjet. Sipas saj, ideja e vërtetë gjendet te mendja e njeriut. Në fakt, dhoma ushtarake për këtë artiste është një kënd lodrash për fëmijë të papjekur por ambicioz, të cilët, argëtohen aty si të rritur; krijojnë kriza rajonale, planifikojnë konflikte, simulojnë aksione ushtarake dhe parashikojnë dëm kolateral. Problemi më i madh është se, “lojërat e tyre ushtarake” më vonë bëhen realitet që e shkatërrojnë botën.

Vangeli, nëpërmjet këtyre lojërave hulumton thellë në mënyrë më filozofike në ndërgjegjen shoqërore. Ajo nisët nga qasja paradoksale që i shkakton lufta, si simbolik në rajonet e krizës ka vendosur arin, duke u dhënë kështu dimensionin alkimik këtyre lojërave. Problemi i vërtetë është se alkimistët modern të integritit në vend të “prima materia” promovojnë “ultima materia” dhe ata e shndërrojnë arin në gur.

Pjesa e dytë e triptikut duket si një muze virtual imagjinar, por edhe si një muze i vërtetë paradoksal integralist i artefakteve elementare konkrete. Fjala është për armët të cilat u dorëzuan në vitin 2001, nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare pas Marrëveshjes së Ohrit. Ndërkaq, autorja, mendon se gjatë aksionit të NATO-s në vitin 2001 ishin grumbulluar armët nga Lufta e Parë dhe e Lufta Dytë Botërore. Këto armë të “rreme” sipas autores Vangeli, të përdorura për këtë projekt prej saj si “ready made” (rejdi mede) më vonë iu treguan në mënyrë pompoze publikut në Maqedoni. Kuptohet nënteksti i autores është se, armët e vërteta - ato të rejtat dhe të dobishmet – mbeten të paprekura për një “rast tjetër”!

Ndërkaq, nëpërmjet hapësirës së tretë, të emërtuar si Dhoma e Dizajnit, e cila simbolizon ardhmërinë e vendit dhe popullit të tij. Ajo merret me fatin e krijimit të shtetit, identitetin dhe me

individin e Republikës së Maqedonisë ( kurse tani Republikës së Maqedonisë së Veriut). Duke e venduar përgjegjësinë e të ashtuquajturit globalistët alkimist, konstaton sesa më i gjatë të jetë procesi i krijimit të identitetit i një individ apo një shteti, aq më e thjeshtë dhe më e shpejtë është zhbërja e tij. Efektet e integritit global autorja i shikon si rekonstruktiv i plotë dhe si ndotje kritike e identitetit. . .

Ndërkohë që edhe një krijues tjetër maqedonas, Tome Axhievski (1958), në vitin 2002 n; kuadër të programit “*Kontekstualizimi i subverzionit*”, ka realizuar edhe një projekt të titulluar “*Shqiptarët si metaforë*” të realizuar në gjashtë pjesë të veçantë ashtu që çdonjëra nga ato pamje përcjell nga një mesazh artistik. Autori këtë program artistik ua dedikon shqiptarëve, duke e nisur me pjesën e parë nën moton – të gjithë ne në esencë jemi shqiptarë (fotoinstalim); pjesa e dytë titullohet identifikimi me simptome – si ti njohësh marksistët dhe leninistët (fotoinstalim), pjesa e tretë Kontekstualizimi i frikës, - XXL – kryqi (video); pjesa e katërt: Bilbordi i një autori maqedonas në Shkup, (bilbord); pjesa e pestë: Kontekstualizim i subverzionit – bos – bos, abe - abe, parisien – parisien (performans); pjesa e gjashtë: Dhënia e mirënjohjes me rastin e 13 Nëntorit ndonjë shqiptari – simulim (performans) dhe përfundimi: Mësimi themelor i ideologjisë dialektike është që, megjithatë me rëndësi është pamja (imazhi).

Me anë të këtij programi Axhievski alarmon se pa një dialog të sinqertë dhe ndërkulturore nga dy anët vështirë se do të mund të zgjidhen çështjet dhe stereotipat. Ky autor shqiptarët i paraqet nëpërmjet dy këndvështrimeve të ndryshme. Nga njëra anë i admiron të arriturat më të mëdha në aspektin artistik, kulturor dhe shoqëror, në të kaluarën dhe sot, kurse nga ana tjetër, paraqet imazhet triviale të përditshmërisë shqiptare. Axhievski i prezanton fotografitë e pesë figurave më të shquara të botës shqiptare, të cilët janë: reformatori, Gergj Fishta, nobelisti, Ferid Muradi, nobelistja dhe shenjtorja, Nëna Terezë, aktori i shquar holivudian, Aleksandar Belushi dhe shkrimtari me famë botërore, Ismail Kadare. Ndërkohë që përball tyre shfaq fotografinë e zyrtarëve të rinisë shqiptare në

Shkup, duke shitur markat e falsifikuara të cigareve të ndryshme në tregun e zi, duke e vënë kështu në pah imazhin negativ të shqiptarëve që del jashtë kontekstit të vlerave të synuara mbarë-shqiptare.

Me propozimin e tij, Axhievskit, pra si një artisti maqedonas, jo vetëm që vjen nga ana tjetër, por ai nxit edhe një provokim për anën shqiptare. Ai është i gatshëm dhe i vetëdijshëm që të hap një dialog ku do të flitet hapur për dukuritë negative të shqiptarëve, por edhe të përballet hapur me mendimin e shqiptarëve. Ky është një projekt pamor që asokohe në pati ndonjë reflektim të dukshëm te shqiptarët, por nga ky këndvështrim i sotshëm del se, autori në fjalë ka trajtuar një temë të ndjeshme dhe mjaft të qëlluar me proveniencë ndërkulturore.

Edhe në projektin tjetër “Arkitektura e agresionit – Kolumna” si rrumbullaksim i punës njëvjeçare nga Tome Axhievskit, në bashkautorësi me Lubomir D. Frçkovski, ku temë qendrore janë ngjarjet e Luftës së vitit 2001. Në fakt fjala për një publikim ku është përfshirë pjesa e gjashtë dhe e fundit nga projektit i realizuar nga Axhievski. Këtij publikimi i bashkëngjiten edhe njëmbëdhjetë kolumnat e Lubomir Frçkovskit. Këto dy autor i lidh rakursi i përafërt kulturor dhe ideologjik i tyre. Secili nga këndvështrim i vet profesional, këta bashkautorë kanë konstatuar se, një intelektual i mirëfilltë duhet të reagoj në kohë të duhur për një ngjarje dhe jo pasi të ketë kaluar gjithçka.

Sigurisht që mund të ketë edhe shembuj tjerë të pa përfshirë në këtë kumtesë, por edhe kaq sa u fol më lartë, del si përfundim se, artet pamore në këtë mënyrë e kanë ndihmuar mbijetesën e traditës ndërkulturore, kurse, artistët, duke gjetur te kjo traditë një burim të pashtershëm inspirimi, e kanë sprovuar veten në prezantimin e tjetrit pa nguruar se mund të keqkuptohen. Ky pra është njëri nga misionet e pashmangshëm të artistëve.

### Summary:

Multiculturalism and interculturalism represent two social exaggerations that should be viewed as a mechanism which facilitates coexistence and harmonizes the relations between peoples in heterogeneous societies. Moreover, the relations of our intercultural tradition in the visual arts will be dealt with in the same context. This is expressed by the title of the paper **“Our intercultural tradition in the visual arts”**, by focusing on the traditional, artistic and contemporary heritage. The intercultural tradition in fine arts dates back very early and in this paper it will be mirrored through specific examples of Albanian artists as well as foreign artists, in order to discover what the peoples have done for each other. We will include different artists, who in the past and today, have left behind works of documentary and aesthetic value, but have also taken a place as specific examples of cultural interaction in art history. We will mention the names of some creators such as: Andrea Aleksi, Onufri, Omer Kaleshi, Eduard Lir, Paja Jovanoviq, Tome Serafimovski, Zhaneta Vangeli, Tome Axhievski etc, who through representative fine arts have either reproduced the reality of the time or through visual conceptual projects have problematized people’s sensitive topics. Certainly, together, this artistic heritage constitutes the backbone of intercultural coexistence and cohesion between diverse peoples. Therefore, it can be concluded that visual arts have helped the survival of intercultural tradition whereas artists have put themselves to test by presenting the other without hesitation that they can be misunderstood.

Keywords: multicultural, interlculture, visual, conceptual, national, international

## Bibliografi

- Prijatelj, Kruno - Fisković, Cvito - *Albanski umjetnik Andrija Aleši u Splitu i u Rabu*, Konzervatorski zavod Dalmacije, Split, 1948.
- Popa, Theofan, *Piktorët mesjetarë shqiptarë*, Tirana 1961, 37-62;  
*Ibid.*, *Onufre une figure éminente de la peinture medieval albanaise*, *Studia Albanica* 1 (1966) 291-303;
- Puzanova B. - Damo, Dh. *O tvorestvu albanskogo srednevekovogo hudoznika Onufrie*, *Studia Albanica* 1 (1996) 281-290;
- Расколска – Николовска, *Творештвото на сликарот Онуфриј Аргитис во Македонија*, Зборник за средновековна уметност, бр. 3, Музеј на Македонија, Скопје, 2003, 135 – 136;
- Николовски Д., *Царските двери од црквата Св. Никола Св. Никола во село Зрзе – Прилеп*, Патримониум.мк3-4, 5-6 (2008=2009) Скопје, 2009, 139 – 150;
- Божурски, Гоце, *Реџаи Исени*, каталог, Скопје, 2019
- Starova, Luan, *Biseda me Omer Kaleshin*, ITKSH; Shkup, 2019, 27;
- Elsie, Robert, *Edward Lear në Shqipëri: ditar udhëtimesh, 1848-1849*, Tiranë 2008
- ["Catalog of Pavle Paja Iovanovic Artworks | Народни музеј"](#)**  
***Retrieved 15 October 2019.***
- Македонска нација, Академик Томе Серафимовски, среда, 02 декември, 2009***
- Аврамова, првиот тетовскиот вајар,***  
**<https://www.opafondacija.org/zaum/>** - shikuar më 10. 10. 2019
- Art Galery Skopje, *Integralism*, Zanet Vangeli, Jun – November, 2003
- Томе Аџиевски, *Контекстуализација на субверзијата*, втор дел на проектот, *Албанците како метафора*;
- Томе Аџиевски – Лубомир Д. Фрчковски, *Архитектура на агресивната Колумни*, Скопје, 20 декември, 2002

**Rizvan SULEJMANI**

**Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup**

**Rizvan.sulejmani@unt.edu.mk**

**SA KANË NDIKUAR DALLIMET FETARE DHE KULTURORE NË  
FORMIMIN E KOMBIT “MODULAR” SHQIPTARË?**

**HOW HAVE RELIGIOUS AND CULTURAL DIFFERENCES  
INFLUENCED THE FORMATION OF THE “MODULAR” ALBANIAN  
NATION?**

Kombi, identiteti kombëtarë, çka është ai?

Kombi, çka është ai, pyetje që jo njëherë është shtruar nga mendimtarë që merren me studimin e kësaj problematike. Kur dhe si u krijua? Cilat ishin parakushtet dhe rrethanat që sollën në lindjen e kombit si krijesë socio-kulturore? Çka është nacionalizmi, një ideologji, ideal apo virtyt i lindur që i shtynë njerëzit të sakrifikojnë më të mirën, për të arritur qëllimin madhorë, formimin e kombit dhe shtetit kombëtarë. Këto dhe shumë pyetje të ngjashme janë munduar të ju japin përgjigje shumë mendimtarë por jo gjithmonë kanë qenë të suksesshëm. Në vazhdim do të shtrojmë disa nga këto teori.

Dy teoricientët të njohur të nacionalizimit, Benedict Anderson dhe Gellner, paraqitjen e nacionalizimit e lidhin me modernizimin edhe se kanë ca dallime në disa aspekte. Identiteti kombëtarë sipas tyre nuk ekziston në kohën e para-modernizmit, më së paku ekziston në kohën kur njeriu jetonte nga gjuetia apo në një ekonomi bujqësore. Sipas tyre ka një dallim të identitetit social - ndërmjet gjuetarit dhe grumbulluesit të ushqimit në fshat, gjegjësisht, burrit dhe gruas, fshatarit, klerit, luftëtarit dhe burokratit – pasi kishte shumë pak ose fare nuk kishte mobilitet social në kohën paramoderne. Kishte aq pak

ndarje të punës saqë individi nuk kishte mundësi të ballafaqohej me më shumë zgjedhje, se cilës bashkësi sociale do t'i takojë. Në një shoqëri agrare zgjedhjet personale më të rëndësishme për një njeri ishin – ku do jetojë, çfarë të bëj për të jetuar, çfarë feje të praktikojë, me kë të martohem – gjegjësisht, ata më së shumti vareshin prej klanit që e rrethonte, katundit, apo kastës. Individi nuk harxhonte shumë kohë duke ndenjur dhe parashtruar pyetjen, “Kush jam unë, në realitet?”<sup>54</sup>.

Sipas Andersonit, gjithë këto filluan të ndryshojnë me paraqitjen e kapitalizmit komercial në shekullin e gjashtëmbëdhjetë në Evropë, të ndikuara nga paraqitja e shtypit të shkruar dhe rritjen e tregut të librave. Shkrimi mundësoj që komunikimi dhe afrimi i njerëzve në mes vete të bëhet për një çmim të lirë.

#### Kombi si krijesë sociokulturore


Kombet si krijesë socio-kulturore e historike, sipas studiueseve të kësaj problematike lindin në rrethana dhe kontekste të caktuara, që zakonisht promovohet nga një elitë intelektuale që bën përpjekje të shpjegoj prejardhjen e përbashkët të një komuniteti që është kalitur përmes figurave të caktuara, si mbrojtës të një grupi njerëz, zakonisht nga një grup tjetër që rrezikon tokat e tyre, të mirat materiale, pse jo edhe eliminimin fizik. Figura që shihen si prejardhës të përbashkët të grupit ngrihen në mite të cilëve u këndohet e u thuren name e lavdi. Kjo histori gojëdhënash nga njerëz të pendës dhe këngës, glorifikohet dhe aktualizohet në rrethana kur grupi është para një rreziku të ri, duke u thirr në trimërinë, namën dhe heroizmin e një figure paraprake, kohën kur ai do të ketë jetuar do ta shpallin si më të ndriturën që ka pas ndonjëherë komuniteti. Përmes kësaj bëhet përpjekje për homogjenizim, dhe unifikim të sërishëm, ku interesi i bashkësisë ngrihet mbi atë personal. Kur kjo bindje depërton në masat e gjëra, përthithet prej tyre, ngrihet në një eufori dhe emocionet shtypin arsyen e individit, fillon e vepron i ashtuquajturit instinkt i kopesë. Mobilizimet e tilla zakonisht i njohim si lëvizje nacionaliste dhe si qëllim të fundit kanë garantimin e ekzistencës dhe sigurisë së popullit në një territor të caktuar të quajtur shtet të përbashkët. Por jo gjithë popujt kanë ndjekur të njëjtën rrugë të ngritjes së identitetit të përbashkët, dhe kanë arritur të bëjnë shtetin e tyre.

---

<sup>54</sup> Francis Fukuyama, “Political Order and Political Decay – From the Industrial Revolution to the Globalization of Democracy”, (2014), Farrar, Straus and Giroux, New York, USA, faq. 187

Historiku i ndarjeve fetare që ndikoi në formimin e kombit shqiptarë “modular”

Në shekullin e 19-të kur filloi të zgjohej ndërgjegjja për identitetin kombëtar, jeta shpirtërore (ndërgjegjja fetare) e besimtarëve shqiptarë sundohej nga tre institucione fetare, tri shkolla dhe tri kultura të huaja. Këto institucione klerikë vareshin nga tri qendra universale, nga Halifati sulltanor, Patrikana fanaroide dhe Papati roman, prej të cilave asnjëra nuk e përkrahte idenë e një shteti kombëtar.<sup>55</sup> Se si u zhvillua historia e ndarjeve fetare dhe çfarë ndikimi patën në shoqërinë dhe shtetin në vazhdim është dhënë skema që përfshin periudhën nga viti 476 deri në vitin 1453.



Skema Nr.1. Ndarja fetare dhe shoqërore e shqiptarëve nga viti 476-1453

Nëse bëjmë përpjekje në vija të trasha t'i japim dallimet ndërmjet këtyre dy drejtimeve kishtarë që qo të paraqiten në këtë periudhë kohore dhe ndikimin që ata kanë pasur në jetën shoqërore dhe shtetërore do të mund t'i përshkruajmë në sa vijon:

<sup>55</sup> Aleks Buda, Kristo Frashëri, Hysni Myzyri, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjili, “Historia e Popullit Shqiptarë, Vëllimi i Dytë, Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX-1912”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, faq. 27.

Romo-katolikët, pretendonin se Shpirti i Shenjtë buron edhe nga Ati edhe nga i Biri, të cilët veprojnë bashkë. Nëse sinonimi për atin në tokë është Mbreti, sinonim për Birin në tokë është kisha. Kjo ndikoj që pas rënies së Romës në vitin 476 në pjesën ku dominonte kjo bindje fetare të mos kishte shtet të centralizuar që sundohej me ligj por kishte territore që sundoreshin nga zakoni. Kurse kishat ishin e vetmja lidhje në mes të vendeve të ndara dhe kishte një organizim hierarkik. Për këtë dhe arsye të tjera ndërmjet këtyre dy institucioneve gjatë historisë do të ketë një luftë pothuajse të përhershme për primat. Por, pasi në vitin 800 Sharlemanje u kurorëzua nga Papa, me çka pranoi supramacionin e kishës mbi pushtetin tokësorë, fillon ndërtimi i shtetit hierarkik feudal mesjetarë mbi parimin; Mbreti, Fisnikëria, Kalorësit, Bujkrobët të lidhur në varshmëri të ndërsjellë. Mbreti ishte ai që u jepte tokë fisnikëve në këmbim për besnikëri, kurse këta u jepnin kalorësve në këmbim për mbrojtje dhe ushtri. Klasa më e ulët, bujqit, ishin ata mbi të cilët binte e gjithë barra pasi duheshe të bëjnë punë për të gjithë vetëm për t'u garantuar siguri.

Nga ana tjetër pjesa e mbetur e ish-Perandorisë Romake, e njohur si Bizanti, me kryeqendër dhe Kryepeshkopatën e Konstatinopolit, interpretonin se Shpirti i Shenjtë buron vetëm prej Atit dhe shprehjen e lartpërmendur nuk e përdorin fare<sup>1</sup>. Sinonim për Atin në tokë ishte Perandori, andej ai e emëronte Kryepeshkopin i cili ishte në shërbim të tij. Në këtë mënyrë shteti vazhdoi të sundohej me ligje, siç ishte Kodi i Justinjanit (525-575) ngritur mbi parimin; Një Zot, Një Perandor, Një Fe. Gjuha e predikimit ishte greqishtja por mundëson edhe përdorimin e gjuhëve lokale në ceremonitë fetare. Ky sistem politik dhe administrativ i Perandorisë Bizantine bëri decentralizimin e pushtetit duke e ndarë atë në Teme (provincat) që pretendohesh të sundohen me ligje romake. Me këtë shoqëria bizantine të krijoj një hierarki ku nivelin e parë e përbënte aristokracia, Kisha e Lartë, niveli e dytë, pjesa tjetër e klerikëve, shërbëtorët civil, tregtarët, bujqit e lirë, kurse nivelin e tretë e përbënin shërbëtorët dhe skllëvërit.

Viti 1453, që lidhet me rënien e Konstatinopojës nën Perandorinë Osmane shënoi një tjetër kthesë në jetën religjioze por edhe të organizimit shtetërorë në pjesën e Evropës ku jetojnë shqiptarët. Në këto troje paraqitej një fe e re monoteiste e cila që në kohën e profetit Muhamed nuk bën distinkcion ndërmjet hyjnore dhe tokësore. Përskaaj shumë shkrimeve, posaçërisht pas 11 shtatorit të vitit 2001 për islamin si fe jo tolerante dhe agresive disa dokumente

dhe studime nuk e argumentojnë këtë qëndrim, në mos e vërtetojnë të kundërtën: Islamin e karakterizojnë vlera si toleranca, barazia dhe drejtësia, të mjaftueshme për jetë të qetë shpirtërore por edhe shoqërore. Në funksion të këtij konstatimi qëndron fakti se Islami këmbëngulë se mesazhi i tij është një “kujtesë” e të vërtetave që i din çdokush. Sipas këtij besimi të ri, Zoti nuk i kishte lënë krijesat njerëzore të paditur për mënyrën në të cilën duhet jetuar. Pra, Islami as nuk kishte detyrë të eliminoj fetë paraprake monoteiste si Hebreizmin dhe Krishterimin as nuk shihet ndonjë konflikt me ta, përkundrazi, ai e sheh veten një kontinuitet të të njëjtit mision, promovimin e besimit në një Zot sikurse edhe ato.


Ky moment, që lidhet me jetësimin praktik të këtij besimi në një shtet islam, për ne do të shërbej të nxjerrim në pah së paku dy çështje shumë me rëndësi; një, promovimi i bashkëjetesës ndër-fetare dhe mospërdorimin e dhunës për konvertim në islam. Nëse për bashkëjetesën ndër-fetare përmendet e ashtuquajtura marrëveshje e Medinës, sa i përket përdorimit/mospërdorimit të dhunës për konvertim në islam që shpesh përdoret si argument studiuës të ndryshëm do t'i kundërvihemi me një parim Kuranor, “*nuk ka detyrim në fe*”(El-Bekare, 256) <sup>56</sup>.

Në bazë të këtij parimi Perandoria Osmani ofroj modelin e vet të bashkëjetesës të popujve tanimë të njohur si sistemi i milletit. Ky vizion apo sistem parakombëtarë sipas disa autorëve nuk ishte i osmanëve, si besnik të Profetit, por më shumë i përshkruhej *shariatit*, ligjit islam por edhe më tepër mund të shihet si kopjim i një nga perandoritë e mëdha të Lindjes së Mesme, veçanërisht Persisë. Në vazhdim është dhënë skema e organizimit shoqërorë në këtë perandori.

---

<sup>56</sup> Gazi bin Muhammad, Ibrahim Kalin, Muhamed Hashim Kamali, “Lufta dhe Paqja në Islam – përdorimi dhe abuzimi me xhihadin”, “Miti i Islamit Militant”, David Dakake, Logos-A, Shkup, 2015, faq. 190-193.

### Shoqëria Osmane



Nga skema mund të përfundohet se sistemi i mileteve që pranonte fetë monoteiste do të ndikojë që organizimi shtetërorë të jetë tejet i decentralizuar që si efekt të fundit prodhoj një shtresim shoqërorë piramidial, ku secili komunitet fetarë, ata që i njej libri i shenjtë Kurani, Hebreizmi, Krishterimi dhe Islami kanë ndërtuar piramidën e vetë shoqërorë që mbarojnë gjithë së bashku në një pikë kulmore tek sulltani si udhëheqës shpirtërorë dhe shtetërorë.

Nacionalizmi dhe ideja e kombit tek popujt ballkanik

Nacionalizmi që tek popujt ballkanik do të shfaqet në shekullin e XIX, padyshim se ishte i ndikuar nga filozofia e Evropës Perëndimore, por zhvillimi i tij në Perandorinë Osmane ngjanë të jetë i veçantë. Duke marrë parasysh sistemin osman ku kombi kishte një përkufizim unikal (*milet*) që lidhej me fenë dhe jo me etninë, siç ishte rasti në Perëndim, këto komunitete, milletet në kuadër të denominimeve kishtarë kishin një vetëqeverisje të kufizuar.

Sipas, Justin McCarthy-it në sistemin e mileteve, osmanët kishin pranuar ekzistencën e një klase nënshtetasish pa asnjë besnikëri të qëndrueshme ndaj shtetit<sup>57</sup>. Sipas po të njëjtit autor, në shekullin XIX ndërgjegjësimi “kombëtarë” i ndikuar nga Perëndimi tek popullata e krishterë osmane mori karakter “racorë” por lidhja me përkatësinë fetare ishte shumë e fortë. Ndërgjegjësimi kombëtarë i grekëve, bullgarëve dhe armenëve, pjesa më e madhe e tyre ishte themeluar

<sup>57</sup> Justin McCarthy-(2015:27)

mbi identitetin fetarë. Gjithsesi se kjo nuk ishte e rastësishme kur kemi parasysh se kishat krishtere me shekuj kishin qenë magazina kryesore e kulturave të ndara të secilit grup të krishterë. Ky sens i ndarjes fetare, miletit krishterë, do ta përdorin si burim për të krijuar një nacionalizëm anti-osman.

Fenomeni i cekur ishte rast në shumicën e vendeve ballkanike. Për këtë ka më tepër arsye por në këtë rast do të përmendim vetëm dy; një, popujt e kësaj pjese të Evropës në përgjithësi ishin vende agrare me njerëz të pashkolluar që jetonin karshi njeri-tjetrit nëpër fshatra me etni dhe religjione të ndryshme dhe dy, sipas Russel, shtypi perëndimor

që kontrollohej nga industrialistët, agjitonte për zgjerim të tregut që nënkuptonte se një luftë e mundshme për këto qëllime ishte mase reale në Ballkan. Për këto arsye Russel do të konstatojë:

*"Sa më shumë rritej fuqia destruktive e luftës aq më shumë rritej frika nga ajo; andej edhe ndjenje e përkatësisë nacionale rritej".*

Me një fjalë, nacionalizmi në këtë pjesë të Ballkanit ishte i ndikuar edhe nga rreziku që i kërcënohej zhbërjes së Perandorisë Osmane po edhe nga zgjerimi i vendeve perëndimore, veçanërisht një ndejnë e tillë është e shprehur tek populli shqiptarë për shkak të rrezikut nga Rusia, që ndjente si presion që vinte nga popujt sllavë që i rrethonin. Rrethanat e brendshme dhe këto që vinin nga faktorë të jashtëm do të prodhojnë nacionalizmin që megjithatë në këto troje do të ketë shumë më tepër elemente religjiozë sesa etnik, por jo edhe tek shqiptarët, për të cilët do flasim më vonë.

Si filloj ngritja e identitetit kombëtarë tek disa popuj të Ballkanit, sa ishte ai i ndikuar nga feja, dhe çfarë përmasa dramatike mori do të sugjerojmë të konsultohet libri i Justin McCarthy, "Vdekje dhe dëbim, spastrimi etnik i myslimanëve osmanë 1821-1922"<sup>58</sup>.

Autorit përmend thirrjet patriotike të revolucionit, të shpallur nga Arqipeshkopi grek Germanos, të ishin: *"Paqe të krishterëve! Respekt konsujve! Vdekje turqve!"*<sup>59</sup>.

Kjo frymë ishte bartur edhe nëpër vendet tjera si në Rumani por më vonë edhe në Serbi, Bullgari e gjetiu. Pastrimi etnik (fetarë) do të

---

<sup>58</sup> McCarthy (2015:31).

<sup>59</sup> Justin McCarthy, "Death and Rxile – The Ethnic Cleansing off Ottoman Muslim 1821-1922", përkthyer shqip, "Vdekje dhe Dëbim – Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë 1821-1922" (2015), Alsar, Tiranë.

bëhet një fenomen që do ta ndjek tërë procesin e formimit të shteteve kombe deri në pavarësimin e tyre<sup>60</sup>.

#### Nacionalizmi dhe kombi në botën Islame

Nëse tanimë dhamë dy rrugë të lindjes së nacionalizmit dhe ideja kombëtare, njëra Perëndimore, që përfshinte pjesën katolike të Evropës dhe tjetra Lindore që identifikohet me krishterimin ortodoks, është koha të themi disa fjalë edhe për nacionalizmin në botën Islame. Në këtë rast do të përmendim disa drejtime, njeri që lidhet me turqit me të cilët bashkëjetonin shqiptarët dhe popujt tjerë të Ballkanit në kohën e Perandorisë Osmane dhe dy të tjerat që lidhen me luftën e myslimanëve kundër kolonializmit. Këto modele janë dhënë në vazhdim.

1. Nacionalizmi turk që identifikohet me modernizimi si luftë kundër religjionit apo shekullarizim të shtetit që personifikohet me Mustafa Kemal Atatürkut (1881-1938), bazohet në gjashtë parime si në vijim: 1. republikanizmi, 2. shekullarizimi, 3. nacionalizmi, që promovoi idenë bazë të së cilës gjuha turke e definon kombin turk, 4. populizmi, që e potenconte idenë e sovranit popullorë,. 5. revolucionariteti dhe 6. etatizmi, që implikonte idenë që shteti duhet të ketë rolin e rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, në shoqëri, kulturë dhe arsim kur janë në pyetje interesat shtetërore.

2. Nacionalizmi që angazhohej për reformizmin mysliman ku bëjnë pjesë autorët: Xhemaluddin el-Afgani, Muhamed Abduhu dhe Reshid Rida. lidhet me myslimanët dhe nacionalizmin tek popujt arab që luftonin kolonializmin.

Xhemaluddin el-Afgani (1839-1897), mbante qëndrimin se, 1. Zhvillimi mund të arrihet vetëm me matematikë dhe duke kultivuar shkencë moderne dhe, 2. Dominimi i Perëndimit do të shpie deri tek shkatërrimi i kulturës dhe shoqërisë islame, që nënkupton se ata duhet të kultivonin kulturën e tyre autentike që është sinonim për kombin.

Muhamed Abduhu (1849-1905) ishte i bindur se: 1. Islami ishte kompatibil me modernizimin, por se zakoni i taklidit si i korruptuar nuk lenë të vijë në shprehje racionaliteti që përndryshe përmbahet në këtë fe, dhe, 2. Sipas disa autorëve Abduhu nuk ishte shekullaristë dhe as donte ta perëndimozojë sheriatin, por të merret

---

<sup>60</sup> Nga një tabelë përmbledhëse që jep autori në librin e tij, rezulton se nga 2.315.293 frymë mysliman që kishin jetuar në Greqi, Bullgari Jugosllavi (përfshirë Shqipërinë) në vitin 1911 rezulton që deri në vitin 1923, 62% apo 1.445.179 kishin ikur, lëshuar vendin apo kishin vdekur, I bid.

nga Perëndimi ajo që është e nevojshme duke e ruajtur integritetin mysliman.

Reshid Rida (1865-1935), sipas Kulenoviçit, 1. Mund të llogaritet si themelues i republikanizmit islam, ngase u angazhua që të shqyrtoj problemin e sovranitetit dhe raportin e myslimaneve ndaj tij, dhe, 2. Rida, ishte nga ata që besonte se shekullarizimi vetëm mund ta dobësojë ummetin dhe me te e bënte më të lehtë imperializmin perëndimor<sup>61</sup>.

Përskaaj faktit se ne këto i trajtojmë si lëvizje nacionaliste në përpjekje për formimin e kombit, Ernest Gellner mendon se bota islame nuk arriti të krijoj shtet shekullarë me te edhe kombin në kuptimin modern në modelin perëndimorë për arsye se,

*“... , bota moderne mbërriti – e imponuar nga jashtë, dhe jo i krijuar nga fuqitë e brendshme – e me atë arriti edhe raporti i ri i forcave që e parapëlqente qendrën urbane, dhe jo bashkësinë rurale, dhe e mundësoj që të mbizotëroj besimi qendrorë”, që të konstatojë, “ Në fund, na mbeti një Umma e suksesshme. Ky është misteri i islamit, e cila nga natyra e vet bën rezistencë ndaj shekullarizimit”<sup>62</sup>.*

#### Ngritja e idesë kombëtare ndër shqiptarët

Pasi kemi bërë një përshkrim të shkurtër të paraqitjeve të feve, veçanërisht atyre monoteiste, me theks krishterimi dhe islami është koha ti kthehemi shekullit të XIX që është vendimtarë për paraqitjen e kombit, trajtuar si krijim socio-kulturorë dhe historikë.

Ky shekull është shekulli më dinamik por edhe më produktiv në procesin e krijimit të identitetit kombëtarë në kuptimin modern të tij. Ndër të tjera për shkak të paraqitjes së një forme të re të organizimit shtetërorë që ndërron në themel konceptin për shtetin, bartësin e sovranitetit, me të edhe mënyrën e qeverisjes. Ideja kombëtare detyrimisht imponon një organizim shoqërorë egalitarë, të ngjeshur me një unifikim të brendshëm siç ishte rasti me fetë. Por, nëse në Perëndim formimi i kombit ecte dorë përdore me industrializimin dhe urbanizimin, në këtë regjion arriti në kushte socio-kulturore e ekonomike shumë më ndryshe. Cilat ishin

---

<sup>61</sup> Tarik, Kulenoviç,(2012), “Islami politik – Konceptet themelore, autorët dhe grupet e një lëvizjeje moderne”, përkthimi shqip, nga Logos A, Shkup, faq. 119-120.

<sup>62</sup> Ernest Gellner, Ernest (2000): Muslim Society, Cambridge: Cambridge University Pres, faq 90-91.

rrethanat në këtë shekull kur ndër shqiptarët filloj të shpërndahej ideja e identitetit kombëtarë dhe shtetit modern?.

Në rastin shqiptarë siç thoshte, Joseph Swire, ekzistojnë tri fe, dy nëndarje racore, dy dialekte dhe dy organizime të ndryshme shoqërore, sërish të ndara nga paragjykimet lokaliste dhe realitetet ndërfinansore për tu ngritur në një subjekt të pavarur, shtet, rruga duhet të ishte edhe më e vështirë. Ata që përpiqeshin të vejnë në jetë idenë kanë kërkuar modele herë në lindje dhe herë në perëndim, varësisht prej konstalacionit të forcave dhe ambienti dominues publik. Në këtë endje lartë pushtë në kërkim të orientimit të tyre, ka pasur disa momente që do të lënë gjurmë përgjithmonë në identitetin kombëtarë edhe sot e kësaj dite. Ska dyshim se ideali i romanistëve ishte shteti kombëtarë me orientim perëndimorë. Me këto bindje për të mobilizuar dhe unifikuar masat, për tu dhënë një kahe dhe një drejtim veprimeve, në momentin kur shihej rrezik për humbjen e tokave dhe rrezikonin të zhbëheshin zbuluan parullën, *“mos shikoni kisha e xhamia, feja e shqiptarit asht Shqiptaria”*. Parulla edhe se në shikim të parë len përshtypjen se është një thirrje për shekullarizim të shoqërisë në esencë nuk mund të kuptohet më tepër se një tendencë që identiteti kombëtarë të ngrihet mbi ato fetare.

Pasi modernia dhe modernizimi ishin në perëndim, kurse ideja duhet të vihej në zbatim ndër shqiptarët që jetonin në shoqëri feudale dhe analfabete<sup>63</sup> dhe nuk e kishte përjetuar iluminizmin që të mund ta përqafoje vizionin e ri, ata u sfiduan me atë që Maks Veberi më herët e kishte potencuar. Ka një dallim të qartë ndërmjet rregullimit shtetërorë, të fuqisë (Staatpolitisch), të kombit dhe të kulturës (Kulturpolitisch)<sup>64</sup>. Pra ata bënë thirrje për të ruajt trojet por e dinin se duhet bërë edhe kombin. Në këtë frymë është kërkesa e Syrja Bej Vlorës kur apelon;

*“.., duke qenë se të gjitha episodet e historisë pesqindëvjeçare të kombit janë të regjistruara në rrjedhën e tyre të natyrshme, nevojitet pastrimi i kësaj nga gojëdhënat e traditat e pabaza nëpërmjet një hulumtimi*

---

<sup>63</sup> Sipas Syrja Bej Vlorës në vitin 1922 në Shqipëri kishte një lice në Korçë, një shkollëpedagogjike në Elbasan dhe një gjimnaz në Shkodër. Shkolla fillore me pesë klasë ka pasë 22 për djem dhe 4 për femra kurse shkolla pas fillore 10 për djem dhe 2 për vajza me gjithsej 472 mësojtore fshati për djem dhe 22 për femra.

<sup>64</sup> Dominique Schnapper, “La communaute des nation, Sur L’idee moderne des citiyen”, përkthim në maqedonisht („Задница на граѓани – кон модерна идеја за нацијата,,),(2003), Слово,Shkup, faq. 29.

*shkencorë, ... duke e futur kështu historinë tonë në një kuadër shkencorë...<sup>65</sup>*

Megjithatë, duhet të dimë se si pikënisje për formimin e kombit nevojiten të plotësohen së paku tre parakushte: (1) "kujtesa" për një të kaluar të përbashkët, shikuar si një "fat" i grupit - ose të paktën e përbërësve të saj kryesore, (2) një numër i lidhjeve gjuhësore ose kulturore, që mundësojnë një shkallë të lartë të komunikimit brenda grupit por edhe përtej tij, dhe, (3) një konceptim i barazisë në mes të gjithë anëtarëve të grupit të organizuar si shoqëri qytetare <sup>66</sup>.

Për më tepër Hroch, Miroslav këtë zhvillim e shef në disa faza. Në fazën e parë (A), aktivistët bëjnë përpjekje për të vendosur bazat e identitetit nacional. Ata studiojnë atributet kulturore, gjuhësore, sociale, bile disa herë edhe të grupeve jo-dominuese me qëllim që të ngrihet vetëdija për rrënjët e përbashkëta – por ata e bëjnë këtë, *"duke mos i shtypur veçanërisht kërkesat kombëtare për të shmangur mangësitë"*. Në fazën e dytë (B), *"Formohet një numër i aktivistëve të rri, që pretendojnë të fitojnë sa është e mundur më tepër përkrahës të grupit etnik për projektin e krijimit të kombit të ardhshëm."*. Kurse në fazën e tretë (C) dhe të fundit, shumica e popullatës formon një lëvizje masive<sup>67</sup>.

Por, përkaj përpjekjeve të elitave për të transferuar kombin në një fazë më të avancuar, të modernizimit, kishte prova të mjaftueshme për të konstatuar se një bindje e tillë nuk kishte arritur të depërtoj në masat popullore. Andej Gustav Le Bon thotë,

*"Nga idetë e ndryshme që udhëheqin qytetërimet, njëra që ka të bëjë me artin e filozofinë ngelet në sferën e lartë, të tjerat, që lidhen me nocionet fetare e politike, zbresin ndonjëherë deri thellë në gjirin e masave. Ato arrin atje zakonisht të shtrembëruara keqas, por kur ata*

---

<sup>65</sup> Avionyalı Süreyya Bey, "Osmanlı Sonrası Arnavutluk, Klasik Yayınlan, İstanbul, 2009. përkthimi shqip, Syrja Bej Vlora, "Shqipëria Pasosmane (1912-1920), Logos-A, Shkup, 2015, faq. 78.

<sup>66</sup> Hroch, Miroslav. "From National Movement to the Fully-formed Nation: The Nation-building Process in Europe," in Balakrishnan, Gopal, ed. Mapping the Nation. New York and London: Verso, 1996: pp. 78-97. See especially p. 79.

<sup>67</sup> Ibid.

*arrijnë të depërtojnë atje, pushteti që ato kanë mbi mendjen primitive e të paaftë për të arsyetuar është kolosale*<sup>68</sup>.

Pse nuk kishte arritur të depërtoj në masat e gjëra kjo ide do të mundohemi përmes disa të dhënave socio-kulturore ta arsyetojmë.

Rrethanat socio-kulturore kur u ngrit ideja e kombit shqiptarë Realiteti në trojet shqiptare, në çerekun e dytë të shekullit XIX me gjithë përparimet që ishin bërë, ajo edhe mëtutje ruante karakterin e një shteti agrar dhe të prapambetur. Shumica e popullatës merrej si edhe më herët me bujqësi e blegtori. Në fshat jetonin ku më shumë e ku më pakë, rreth 87% e banorëve të këtyre viseve <sup>69</sup>. Në bazë të të dhënave që posedojmë, sikurse fshati ashtu edhe qyteti karakterizohej me rritje të ulët të ekonomike dhe nuk ishin shkëputur nga prapambetunia. Shprehur në përqindje, 13% e popullatës jetonte në qytet në fund të viteve 30 të shekullit XIX, edhe atë në qytet më të rëndësishme në trevat e katër vilajeteve siç ishin Manastiri (35000 banorë), Shkodra (25000 banorë), Janina (25000 banorë), Prizreni (20 000 banorë), Shkupi (15000 banorë) si dhe të tjerët me më pakë se 10.000 banorë <sup>70</sup>.

Sa i përket strukturës shoqërore të popullsisë, viset shqiptare ruanin ende tiparet e shoqërisë feudale, ndonëse tashmë nën shturje të shpejtë. Grupimin kryesorë shoqërorë në ekonomi e formonin si edhe më parë feudalët çifligarë së bashku me funksionarët e lartë të aparatit burokratik dhe shtresa e sipërme të klerit të cilët paraqisnin rreth 0.2% të popullsisë së vendit.

Brenda katër vilajeteve, ku bënin pjesë viset shqiptare, kishte vetëm një shkollë të mesme të arsimit të përgjithshëm – gjimnazi greqisht “Zosimea” në Janinë. Si rrjedhim, në vitet 40 të shekullit XIX gati 98% e popullsisë vuante nga analfabetizmi. Madje në shumicën dërmuese të fshatrave nuk gjendej asnjë njeri i shkolluar, qoftë edhe me arsim të ulët<sup>71</sup>.


---

<sup>68</sup> Gustave Le Bon, “The Psykology of Peoples: The Crowd: A Stady of the Popular Mind”, përthare shqip, “Psikologjia e popujve dhe e turmave”, Fan Noli, Tiranë, (nuk ka vit), faq. 100

<sup>69</sup> Aleks Buda, Kristo Frashëri, Hysni Myzyri, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjili, “Historia e Popullit Shqiptarë, Vëllimi i Dytë, Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX-1912”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, faq. 37

<sup>70</sup> Aleks Buda, Kristo Frashëri, Hysni Myzyri, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjili, “Historia e Popullit Shqiptarë, Vëllimi i Dytë, Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX-1912”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, faq. 38.

<sup>71</sup> Aleks Buda, Kristo Frashëri, Hysni Myzyri, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjili, “Historia e Popullit Shqiptarë, Vëllimi i Dytë, Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX-1912”, Botimet Toena, Tiranë, 2002, faq. 39.



Ky ishte realiteti socio-ekonomik shqiptarë në kohën kur në perëndim, industrializimi kishte prodhuar urbanizimin, shtresime më të fuqishme shoqërore por edhe elita intelektuale çdo ditë e më tepër e rrënonte, në mos e kishte shkatërruar në tërësi dominimin kulturorë kishtarë, për llogari të kulturave të reja që paraqiteshin si në ekonomi ashtu edhe në jurisprudencë, artë e shkencë.

Nga ana tjetër bazuar në parametrat e shtruar më lartë, hoqëria shqiptare shumë më tepër sundohej nga ligjet e familjes, fshatit, krahinës dhe fesë dhe jo nga ligji i përbashkët abstrakt që është karakteristik e një kombi të konsoliduar.


Skema 2. Paraqitja skematike e identiteteve brenda shoqërisë shqiptare në kohën kur bëhej përpjekje për ngritjen e idesë së kombit.

Në këso rrethana është e kuptueshme që feja të ketë ndikim në gjitha fushat kulturore, përfshi edhe veprimtaritë më elementare jetësore, për dallim prej atij perëndimorë ku mirëqenie e punëtorëve tanimë nuk varet nga shkaqet natyrore që u përshkruhen fuqive mbinatyrore dhe dirigjohen nga Zoti, por shumë më tepër nga aftësitë njerëzore. Arsyeja pse kjo klasë e ulët nuk largohet nga Zoti, por lidhet me Te, është se pjesa dërmuese e tyre është rurale, bujqësore, jeta e tyre varet nga kushtet atmosferike, që janë kapricioze dhe nuk janë të lidhura me njeriun, por për atë kohë kishin një sqarim hyjnorë<sup>72</sup>.

Për dallim prej këtij realiteti shqiptarë, gjendje në vendet tanimë të industrializuara të perëndimit kishte sjellë në dobësimin e ndikimit –

<sup>72</sup> Nga ana tjetër nëse i referohemi Genller-it dhe ndarjes që bën ai për besimtarët, ata duhet të jenë shumë më tepër besimtarë të kultursë së ultë, më tepër folklorik, ku dominojnë kultet dhe hierarkitë lokale religjioze që udhëheqin me ta sesa ajo skriptuale, univerzale. (Bertrand Russel, 2010:28-29).

së paku të atij drejtpërsëdrejti – të fesë mbi fushat kulturore. Si pasojë e profesionalizimit, lëmit kulturore largoheshin prej tërësisë së kulturës dhe fesë. Ky fakt shprehet përmes termit botërorizim apo shekullarizim (Säkularisierung). Në gjuhën latine saeculum do të thotë “shekull”, “kohë”. termi saeculum në gjuhën e teologëve të vjetër të krishterë është përdorur në kuptimin “kundër kishës”.



Sipas Genller-it, “në Evropë, kontrasti ndërmjet bashkësisë (mendohet ato fetare jashtë strukturës hierarkikale) dhe shoqërisë është i njëjti si ai ndërmjet të kaluarës dhe të tashmes: kalojmë nga bashkësia në shoqëri. Në islam, këto dyjat janë përherë në të tashmen, dhe janë të njëkohshme: bashkësia (ato fetare jashtë qendrës) ndodhet në margjina, kurse shoqërorja graviton nga qendra”.

Një bashkësi e tillë ku dominonin më tepër identitete, pjesa më e madhe si të përgjithshme, jo lokale e hierarkikale kishte kushte për formimin e kombit i liruar nga kthetrat e lokalizmave, autoriteteve kishtarë e familjare për të përqafuar një vëllazëri më të gjerë të quajtur komb.

Skema nr. 3. Paraqitja skematike e identiteti kombëtarë i çliruar nga preokupimet e ligjeve të familjes, fisit, religjionit dhe krijimi i një identiteti të shumëfishtë kombëtarë

#### Nevoja për këndellje intelektuale

Nëse ambienti ku duhej promovuar ideja e kombit si krijesë sociokulturore mbi parimin perëndimorë dallonte shumë nga ai në Perëndim, promotorët e idesë kishin nevojë për një këndellje. Ata kishin nevojë për një kritikë të ashpër sa u përket bindjeve se një shkëputje nga traditat është e thjeshtë dhe se mund të arrihet me kopjim të një modeli që ka sukses dhe ka arritur fazën finale diku në Perëndim, pa marrë parasysh rrethanat objektivat dhe veçoritë vendore të një populli.

Thjesht, ata duhej ta kuptonin se shqiptari i asaj kohe nuk ishte një “njeri i modular” si parakusht që si i tillë të jetë një nationalist. Ai në atë kohë ishte shumë më tepër një njeri i Dirkemit jo-modular, që i takon një kulture të cilën e ka përthithur me vlerat dhe parakushtet e

saja, apo: *“ishte si një pjesë e mobiljes që qartë identifikohet me një stil të caktuar”*. Që këtë njeri ta transferoni të jetoj në një shoqëri moderne, përmes një marrëveshje lokjane, nevojitej një proces i “modulimit”, ngase vetëm një njeri “modular” sipas Gellner-it do të ishte i gatshëm për një transformim aq të madh shoqërorë. Shqiptari modern, për të ndërtuar kombin dhe shtetin mbi parimin e marrëveshjes së Lokut, duhej të transformohej nga njeriu antro-pofisnor, apo antro-pofetar, apo edhe antropokosmik në antropocentrik, që do të thotë kishte nevojë të përthithë një kulturë të re. Kultura antropocentrike individin e vendosë në vend të parë si qenie që e ndjek qëllimin e tij personal dhe vlerësimin për mesin që e rrethon e bën me pretendim që ti realizojë qëllimet e veta: andej ai ngrënë institucione sociale si instrumente për këtë arkitekturë të re shoqërore sipas Gellner-it. Se megjithatë ky proces nuk realizohet lehtë shihet nga sugjerimet e autorit, kur thot; duhet shumë zhurmë e shamatë, por shumë më tepër me dramatizim, me dëshmitarë dhe sipas mundësisë me sakrificë. Por mbi gjitha kumbuese do të jetë konstatimi i Gellner-it:

*“Fjala e tij është obligim, vetëm nëse rrjedh gjak përderisa jep premtimin; por bile edhe atëherë duhet të jeni të kujdesshëm”<sup>73</sup>.*

Këto parakushte dhe këto rrethana në mesin e popullit shqiptarë nuk ishin përmbushë, andej ata kishin nevojë për një këndellje, dhe një gjykim më real të rrethanave ekzistuese në të cilat jetonin e vepronin.

Cila ishte zgjidhja?

Në këso rrethana zgjidhja ishte një model autonom dhe autentik për rrethanat e një populli që kishte një etni të përbashkët por në vete kishte ngërthyer tre religjionet, monoteiste dominuese, krishterimin katolik dhe atë ortodoks si dhe islamin si fe monoteiste që i pranonte dy të parat. Për shkak se parakushtet për një model përfundimor të ngritjes së kombit që ishte si rezultat i modernizimit dhe urbanizimit ishin larg për tu plotësuar pothuajse ishte e pamundur të kopjohet. Më së paku ishte i mundshëm modeli i të krishterëve ortodoks të Ballkanit që kishin qenë nën sundimin osman për shkak se bartës i nacionalizmit ishte kisha, që detyrimisht do ta konfrontonte me pjesën tjetër të popullit që kishte përkrah islamin. Modeli i shteteve islame gjithashtu ishte i pamundur, sa për shkak se ai shumë më


---

<sup>73</sup> Ernest Gellner (1994), “Conditions of Liberty: Civil society and its rivals”, përkthimi maqedonisht (2003), “Услови за слобода: Цивилно општество и неговите противници”, Современа Мисла, Магор, Скопје, faq. 78-79

tepër ushtronte një “otopraktizëm” fetarë, që prapë sipas Gllnerit pothuajse pamundësonte shekullarizimin. Me një fjalë, për shkak se njeriu “modular” i Genllerit që duheshte të përthith idenë e kombit nuk ishte profiluar nuk ju mbetej tjetër veçse të ndjekin rrugën e tyre autonome dhe autentike të formimit të “kombit modular”. Për këtë historia u kishte krijuar dy parakushte kryesore. Një, ata kishin ruajtur identitetin etnik përmes gjuhës dhe, dy, kishin një figurë mitike siç ishte Gjergj Kastrioti Skënderbe, që në vete përmban tre identitete, Kastrioti i lindur si i Krishterë Ortodoks, Skenderin si mysliman i edukuar në kazermat e perandorisë osmane, për përhapjen e së cilës fe kishte luftuar dhe fituar name e lavdëri dhe Gjergjin që kurorëzohej në një kishë katolike. Në memorien e këtij populli kishte mbetur shteti i parë i lavdishëm i këtij udhëheqësi shqiptarë bazuar në Besëlidhje, konventë ndërkomunitare.

Fatmirësisht kjo “trntri shqiptare” përthithur në heroin Gjergj Kastriotit Skënderbe u shfrytëzua nga elita intelektuale që kishte për detyrë ta promovonte dhe ngrinte në mitë edhe si trim por edhe si burrështeti, diplomat e mbrojtës i Perëndimit nga Lindja. Kjo figurë dhe modeli i tij i ndërtimit të shtetit mbi parimin e Besëlidhjes u shfrytëzua për bashkimin e krerëve shqiptarë pa dallim feja për çlirimin e tokave dhe formimin e shtetit por më vonë edhe të ngritjes dhe ngjeshjes së kombit tre-religjioz që fliste në dy dialekte dhe shumë të folura lokale e krahinore.

#### **Modeli autonom dhe autentik i kombit dhe shoqërisë modulare shqiptare**



Skema nr. 4. Modeli autonom dhe autentik i formimit të kombit modular mbi parimin e Besëlidhjes.

Nga kjo distancë kohore nëse kemi parasysh rrethanat në të cilët jeton populli shqiptarë i ndarë tre fe dhe dy dialekte, i rrethuar me shumë armiq dhe pretendent për ti vënë nën kontroll, formimi dhe

funksionimi i një kombi të tillë duket mrekulli. Konstatimi ynë është se formimi i kombit do të kishte qenë pothuajse e pamundur sikur të kishin ndjekur cilëndo nga tre modelet serike të formimit të kombit qoftë ai modeli perëndimorë që lindi si rezultat i industrializimit dhe modernizimit, qoftë ai i popujve ortodoks ballkanik ku kisha ishte bartëse e nacionalizmit qoftë ai islamik ku feja mbetej qendra e jetës shoqërore po të mos kishte ndjekur rrugën e vet autonome dhe autentik.

### **Përmbledhje**

Qëllimi i punimit është përmes metodës krahasuese të nxjerr në pah dallimet dhe të përbashkëta e nacionalizmit si promotorë të idesë së kombit dhe shtetit kombëtarë, me theks ati shqiptarë. Duke krahasuar disa parametra socio-kulturorë por edhe religjioz analizohen parakushtet e formimit të kombit “modular” shqiptarë përmes rrugës autentike me ato të Evropës që ishin prodhim i industrializimit dhe modernizmit. Në të njëjtën kohë tërhiqet paralele edhe me paraqitjen e nacionalizmit tek popujt e Ballkanit ku promotorë është kisha ortodokse. Në fund japim vlerësimin për rrugën që ndoqi kombi shqiptar, tre-religjioz dhe me dy dialekte gjuhësore bazuar në mitin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, një “mrekulli” që në vete ngërthen trinitrinë fetare të këtij populli, për të nxjerrë konstatimin se për rrethanat e kohës duket të ishin e vetmja e mundshme.

### **Summary**

The purpose of this paper is to show through the comparative method the differences and commonalities of nationalism as promoters of the idea of nation and nation state, with an emphasis on Albanians. Comparing some socio-cultural but also religious parameters, analyzes the preconditions for the formation of the “modular” Albanian nation through the authentic route to those of Europe that were the product of industrialization and modernity. At the same time it draws parallels with the introduction of nationalism to the people of the Balkans where the Orthodox Church is the promoter. At the end we give an appreciation for the path followed by the three-religious, two-language dialects based on the myth of Gjergj Kastrioti Skanderbeg, a “miracle” that in itself embodies the religious trait of this people, to conclude that from circumstances of the time seem to be the only one possible.

## Literatura:

- Aleks Buda, Kristo Frashëri, Hysni Myzyri, Gazmend Shpuza, Petrika Thëngjili, "Historia e Popullit Shqiptarë, Vëllimi i Dytë, Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX-1912", Botimet Toena, Tiranë, 2002.
- Avioniyali Süreyya Bey, "Osmanli Sonrasi Arnavutluk, Klasik Yayinlan, Istanbul, 2009. përkthimi shqip, Syrja Bej Vlora, "Shqipëria Pasosmane (1912-1920), Logos-A, Shkup, 2015.
- Domenique Schnapper, "La communaute des nation, Sur L'idee moderne des citiyen", përkthim në maqedonisht („Заедница на граѓани – кон модерна идеја за нацијата,,),(2003), Слово,Shkup.
- Ernest Gellner, Ernest (2000): Muslim Society, Cambridge: Cambridge University Pres, faq 90-
- Francis Fukuyama, "Political Order and Political Decay – From the Industrial Revolution to the Globalization of Democracy", (2014), Farrar, Straus and Giroux, New York, USA.
- Gazi bin Muhammad, Ibrahim Kalin, Muhamed Hashim Kamali, "Lufta dhe Paqja në Islam – përdorimi dhe abuzimi me xhihadin", "Miti i Islamit Militant", David Dakake, Logos-A, Shkup, 2015.
- Gustave Le Bon, "The Psykology of Peoples: The Crowd: A Stady of the Popular Mind", përthare shqip, "Psikologjia e popujve dhe e turmave", Fan Noli, Tiranë, (nuk ka vit).
- Hroch, Miroslav. "From National Movement to the Fully-formed Nation: The Nation-building Process in Europe," in Balakrishnan, Gopal, ed. Mapping the Nation. New York and London: Verso, 1996..
- Justin McCarthy, "Death and Rxile – The Ethnic Cleansing off Ottoman Muslim 1821-1922", përkthyer shqip, "Vdekje dhe Dëbim – Spastri etnik i myslimanëve osmanë 1821-1922" (2015), Alsar, Tiranë.)
- Tarik, Kulenoviq,(2012), "Islami politik – Konceptet themelore, autorët dhe grupet e një lëvizjeje moderne", përkthimi shqip, nga Logos A, Shkup.

